

1 E mërkurë, 21 shkurt 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
15 Prokurorisë me numër W04576. Vërej se z. Krasniqi na ndjek
16 përmes videolidhjes sot dhe të akuzuarit e tjerë janë të
17 pranishëm në sallë. Gjykatësi Barthe vijon që të marrë pjesë
18 përmes videolidhjes.

19 Znj. Sekretare, ju lutem shoqëroni dëshmitarin të hyjë në
20 sallë.

21 Do të bëjmë një pushim të shkurtër në orën 10.00, siç
22 vepruam dje, një pushim prej dhjetë minutash.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

24 Sekretare, keni fjalën.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Një sqarim. Dje, tre

1 provat të pranuar për Mbrojtjen e Krasniqi me numër 4D26, 27
2 dhe 28, janë të gjitha të klasifikuara si konfidenciale. Desha
3 ta them këtë për procesverbalin.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nevojitet që
6 të vijojnë të jenë të klasifikuara si konfidenciale? Z. Ellis,
7 dy prej tyre janë provat tuaja.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Së paku dy syresh kanë emër që
9 lidhen me një dëshmitar, prandaj dhe mendova se konfidenciale
10 është më e sigurtë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tjetra është
12 e ZPS-së.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po. Janë dy faqe libri
14 me numrat 043900 deri në faqen përkatëse të cilat janë të
15 shënuara si konfidenciale.

16 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
18 z. Dëshmitar. Faleminderit për praninë tuaj këtu sot.

19 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju rikujtoj
21 se tani do të vazhdojmë me dëshminë tuaj.

22 Ju rikujtoj që t'u përgjigjeni pyetjeve qartë me fjali të
23 shkurtra dhe të qarta. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht
24 mund t'i kërkonit personit që jua bën pyetjen t'jua përsërisë
25 atë ose mjafton të thoni që nuk e kuptoni pyetjen dhe do t'ju

1 sqarohet. Ju lutem, na bëni të ditur se nga i dini faktet apo
2 rrethanat për të cilat do t'ju bëhen pyetje.

3 Ju rikujtoj se jeni ende nën detyrim për të thënë të
4 vërtetën, siç edhe e keni thënë në betimin solemn.

5 Mos harroni, flisni afër mikrofonave dhe prisni pesë
6 sekonda para se t'u përgjigjeni pyetjes në mënyrë që dhe
7 përkthyesit të kenë mundësi t'ju ndjekin.

8 Nëse keni nevojë për pushim, na e bëni të ditur këtë, do
9 t'jua plotësojmë nevojën.

10 Do të vijojmë me pyetjet nga ana e Prokurorisë.

11 Z. Pace, keni fjalën.

12 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Sa për të korigjuar,
13 prova me numër P01014 që unë e parashtrova dje mund të jetë
14 publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 DËSHMITARI: HAJRUSH KURTAJ [Vijon]

17 Pyetje nga z. Pace: [Vazhdim]

18 Z. PACE: [Përkthim]

19 PY. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar.

20 PË. Mirëmëngjes.

21 PY. Dje kur e ndërpreme, po flisnim për zonën e përgjegjësisë
22 të Brigadës 163. Dhe sa i takon kësaj, mund të na thoni se ku
23 ndodhej Kukaj?

24 PË. Kukaj është një lagje e fshatit Bob, po komuna e
25 Kaçanikut.

1 PY. Kukaj bënte pjesë në zonën e përgjegjësisë së Brigadës
2 162 në 1998 apo në 1999, apo në të dyja vitet?

3 PË. Jo, njësitet nuk e kanë pas nën kontroll për shkak se kanë
4 qenë në pjesën malore njësitet e brigadës.

5 PY. Sa larg është Kukaj nga fshati Bob apo nga mali,
6 domethënë, lart ku ndodhet Bobi?

7 PË. Po është lagje e fshatit Bob, dikund 2-3 kilometra nga
8 malet janë mbi lagjen Kukaj.

9 PY. Në vitin 1998 dhe/apo 1999 a kishte njësitet të UÇK-së në
10 Biqec?

11 PË. Në vitin 1998, jo.

12 PY. Po në vitin 1999?

13 PË. Në vitin 1999 kishte një kompani.

14 PY. Kur në vitin 1999 kishte një kompani të UÇK-së në Biqec?

15 PË. Nga fillimi i prillit. Saktë datën nuk po më kujtohet.

16 PY. Dhe kush ishte përgjegjës nga ana e UÇK-së për këtë
17 njësitet në Biqec?

18 PË. Ishte komandanti i kompanisë Nazmi Osmani.

19 PY. Në zonën e përgjegjësisë së Brigadës 162 a bënte pjesë
20 edhe Varoshi?

21 PË. Jo.

22 PY. Varoshi ndodhej në komunën e Ferizajt, apo jo?

23 PË. Po, në komunën e Ferizajt.

24 PY. Brigada 162 a kishte ndonjë zonë përgjegjësie në ndonjë
25 pjesë të komunës së Ferizajt në vitin 1998 apo vitin 1999?

1 PË. Në vitin 1998, jo, nuk ka pas zonë të përgjegjësisë.

2 PY. Po në 1999?

3 PË. As në 1999 në pjesë të Ferizajt nuk ka pas përgjegjësi.

4 PY. Ku ndodhet Jezercë?

5 PËRKTHYESI: Xhezercë e dëgjon përkthyesi.

6 DËSHMITARI: Fshati Jezercë ndodhet në komunën e Ferizajt.

7 Z. PACE: [Përkthim]

8 PY. Sa larg ndodhet Jezercë nga Varoshi?

9 PË. Saktë nuk më kujtohet. Nuk muj me dit saktë. Po me
10 kilometra nuk e di saktë.

11 PY. Ju kujtohet që i keni thënë Prokurorisë kur kemi bërë
12 përgatitjen në seancën përgatitore që ndodhej 12 apo 13
13 kilometra nga Varoshi, a është e saktë kjo distancë?

14 PË. Mundet me qenë përafërsisht, po saktë nuk jam i sigurt,
15 për shkak se Varoshi është krejt në pjesën në fillim që
16 territorit të komunës së Ferizajt, kurse Varoshi është në
17 mbarim, krejt në anën e kundërt.

18 PY. Ka pasur njësite të UÇK-së të vendosura në Jezercë në një
19 moment kohor të vitit 1999?

20 PË. Cilat njësi, ju lutem?

21 PY. Njësi të UÇK-së në Jezercë në vitin 1999.

22 PË. Jezerci nuk ka qenë kompetencë e imja.

23 PY. Po. Po dua ta dëgjoni pyetjen që ju bëj. A ka pasur
24 njësite të UÇK-së në Jezercë në vitin 1999, me aq sa keni ju
25 dijeni?

1 PË. Ka pas po nuk ka qenë kompetencë e imja. Edhe nuk muj me
2 qenë edhe i saktë në përgjigje për një punë që nuk ka qenë
3 kompetencë e imja.

4 PY. Me aq sa keni ju dijeni, kompetencë e kujt ishin njësitet
5 e UÇK-së në Jezercë?

6 PË. Nuk më kujtohet.

7 PY. Dje, nga fundi i ditës, folëm gjithashtu edhe për Ivajin.
8 A mund të na tregoni se çfarë godinash apo objektesh kishte
9 UÇK-ja, pra, përdorte UÇK-ja në Ivajë në shkurt apo mars të
10 1999?

11 PË. Ka përdor nëpër pjesë, në pjesët malore ku edhe i kanë
12 improvizu shtëpitë.

13 PY. Në lidhje me shtëpitë që ka përdorur UÇK-ja në Ivajë në
14 shkurt dhe mars të 1999, a ju kujtohet kush ishin pronarë të
15 këtyre shtëpive përpara apo qoftë edhe gjatë kohës kur UÇK-ja
16 i përdori këto?

17 PË. Nuk më kujtohet.

18 PY. Tani të flasim për Bobin apo për zonë mbi Bob apo rreth
19 Bobit. Çfarë godinash apo objektesh ka përdorur apo ka
20 shfrytëzuar UÇK-ja atje në shkurt dhe mars të 1999?

21 PË. Ka qenë në pjesën malore të fshatit Bob një shtëpi e
22 vjetër që para shumë vitesh ju ka shërby më shumë për biznese
23 verore, bujqve. Atë shtëpi e ka përdorur UÇK-ja.

24 PY. Dje na thatë se ishte kompania e Feriz Gurit, që ishte e
25 bazuar, pra, në zonën mbi Bob, pra, ishe në këtë shtëpi që

1 ndodhej kjo kompani, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Tani në Biqec mund të na thoni se çfarë godinash apo
4 objektesh përdorte apo shfrytëzonte UÇK-ja në Biqec në 1999?

5 PË. Nuk jam i sigurt se nuk kam qenë asnjëherë në atë shtëpi.
6 Vetëm është si lagja Zharku.

7 PY. Pra, ju thatë në përgjigje që s'keni qenë kurrë në atë
8 shtëpi kur po flisnim për Biqecin. Për cilën shtëpi e keni
9 fjalën?

10 PË. Për atë që pyetët edhe ju. Thashë nuk e di saktë
11 shtëpinë, në cilat shtëpi, por e di se në lagjen Zharku kanë
12 qenë.

13 PY. Që të jem i qartë, Dëshmitar, unë nuk përmenda shtëpi.
14 Unë thashë godina në përgjithësi. Tani e kuptova qartë që UÇK-
15 ja përdorte një shtëpi një shtëpi në mëhallën e Zharkut në
16 Biqec?

17 PË. Jemi keqkuptu. Si godina, si shtëpi e ka të njëjtin
18 kuptim. Por në cilat shtëpi ka qëndru aty nuk e di se nuk kam
19 qenë personalisht në atë as në godina, as shtëpi, cilëndo ta
20 merrni.

21 PY. A keni shku ndonjëherë në Bob apo në zonën malore mbi Bob
22 në vitin 1999?

23 PË. Te kulla e Hasanit, po.

24 PY. Dhe kulla e Hasanit është i njëjti vend ku qëndronte
25 njësitit i Feriz Gurit apo ishte tjetër vend ky?

1 PË. I njëjti vend.

2 PY. Kulla e Hasanit ishte vendi që përdorte njësitin e Feriz
3 Gurit, ju, pra, ky vend që po përmendim, kishit ju ndonjë
4 arsye të veçantë për me shku aty aso kohe?

5 PË. Jo, nuk kisha arsye të veçantë, por isha
6 zëvendëskomandanti edhe në kohën kur -- se aty ishte edhe ku
7 bëhej ushqimi i ushtarëve.

8 PY. Për cilët ushtarë përgatitej ushqimi, gatuhej ushqimi në
9 zonën e Bobit të cilën ju sapo e përmendët?

10 PË. Në kullën e Hasanit përgatitej ushqimi për ushtarët e
11 kompanisë së Feriz Gurit.

12 PY. Ju vetë nuk bënit pjesë në njësitin e Feriz Gurit?

13 PË. Jo.

14 PY. Pra, si ju vetë, a kishe ushtarë të tjerë po që nuk bënin
15 pjesë në njësitin e Feriz Gurit por që gjithashtu shkonin në
16 këtë zonë për me marrë ushqim në vitin 1999?

17 PË. Nuk më kujtohet saktë, por askujt nuk ju ka ndalë
18 ushqimi. Sa ka pas, ka pas për të gjithë.

19 PY. Dëshiroj t'i tregoj dëshmitarit një dokument.

20 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem të nxirrni
21 në ekran dokumentin me numër 036622 deri në 036837. Do të
22 shfaqim faqen e parë të kësaj. Krahas me këtë dhe versionin në
23 shqip që është 077039 deri në 0077258, faqja e parë
24 gjithashtu. Faleminderit, znj. Sekretare.

25 PY. Z. Dëshmitar, i shihni këto dy dokumente në ekran?

1 PË. Po.

2 PY. Shohim në të majtë është në anglisht, në të djathtë është
3 në shqip. E njihni këtë?

4 PË. Po, të dyjat janë librat e mia.

5 PY. Thatë që janë të dy librat e tu. Pra, është e saktë që e
6 keni shkruar ju versionin në shqip?

7 PË. Po.

8 PY. Versioni në të majtë është përkthimi në anglisht i këtij
9 libri që e keni shkruar ju?

10 PË. Po.

11 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, në të djathtë, ju
12 lutem kalojmë në faqen e dytë, 077040. Atë në majtë mund ta
13 lëmë siç është.

14 PY. Z. Dëshmitar, dua t'ju tërheq vëmendjen tani tek
15 materiali në shqip në të djathtë, në fund të faqes shohim
16 Prishtinë, 2012. Në këtë vit e keni botuar këtë libër?

17 PË. Po.

18 PY. Pra, e keni botuar në vitin 2012. A mund të na thoni kur
19 keni filluar ta shkruani këtë libër?

20 PË. Saktë nuk muj me dit, por përafërsisht katër-pesë vite më
21 kanë shku tuj shkru.

22 PY. Me të mbaruar përgatitjen, pra, shkrimin e librit e
23 botuat menjëherë apo pritët sa të kalonte një farë kohe dhe
24 pastaj ta botonit në 2012?

25 PË. Jo, në moment që e kam përgatitur edhe e kam botuar.

1 PY. Ju kujtohet në intervistën me ZPS-në që i keni thënë
2 Prokurorisë që ju janë dashur tre vjet mbasi ta kishit
3 përgatitë librin derisa ta përmbyllnit me botimin?

4 PË. Po unë po them se katër-pesë vite më kanë shku. Sigurisht
5 se edhe ato tri vite hyjnë në këto.

6 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem kalojmë tani
7 në faqen 066234 në anglisht, ndërsa në versionin shqip në
8 faqen 077041. Faleminderit, znj. Sekretare.

9 PY. Z. Dëshmitar, siç e shohim në këtë faqe, a është e
10 vërtetë se Prof. Dr. Selim Daci dhe Gjeneral-Major Shukri Buja
11 ishin redaktorë të këtij libri?

12 PË. Po recezentë të librit.

13 PY. A mund të na thoni shkurtimisht se kush është,
14 shkurtimisht, kush është Prof. Dr. Selim Daci?

15 PË. Profesor Daci është profesor i Universitetit të
16 Prishtinës, degës së historisë.

17 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, kalojmë tash në faqen
18 36637 në versionin anglisht dhe në shqip, 077054.

19 PY. Dëshmitar, kjo është nga hyrja që ju vetë i keni shkruar
20 librit ku thoni:

21 "Falënderoj sidomos të gjithë ata që ishin pjesë e
22 përgatitjes për botim të këtij libri, Dr. Selim Daci dhe
23 Major-Gjeneral Shukri Bujën, të cilët me vlerësimet dhe
24 sugjerimet e tyre ia shtuan vlerën shkencore punimit ndërsa
25 mua më krijuan besimin për punë të mëtejshme".

1 Tani, Dëshmitar, a mund t'ju thoni dëshmitarëve [Sipas
2 përkthimit] se çfarë roli ka luajtur Shukri Buja si redaktor i
3 këtij libri?

4 PË. E ka dhënë mendimin e vet për këtë libër edhe, pse edhe
5 dhe e kam thënë edhe po e përsëris prapë, se në libër i kemi
6 zmadhu gjënat, i kemi zbukuru gjënat dhe i kemi paraqitë ashtu
7 qysh kemi pas dëshirë dhe jo qysh kanë qenë.

8 PY. Dëshmitar, ju thatë që Shukri Buja ka dhënë mendime për
9 librin. Çfarë mendimi ju ka dhënë?

10 PË. Mendimin që është në libër.

11 PY. Ju kujtohet se cili ishte ky mendim i Shukri Bujës?

12 PË. Jo, përmendsh nuk më kujtohet.

13 PY. Ju kujtohet që Shukri Buja ju ka dhënë një mendim, pra,
14 që ju ka thënë që ka ndonjë pasaktësi në libër?

15 PË. Krejt çka e ka thënë Shukri Buja është e shkruar në
16 libër.

17 PY. Po. Po, Dëshmitar, nuk po i përgjigjeni pyetjes time.

18 Pyetja ime është kjo: Kur ju dha mendimin ose të themi kur
19 folët, biseduat bashkë për librin, a ju kujtohet nëse Shukri
20 Buja ju ka thënë që ka diçka në libër që është e pasaktë?

21 PË. Nuk më kujtohet.

22 PY. Nuk ju kujtohet që t'ju ketë thënë, pra, që ka ndonjë
23 pasaktësi apo nuk ju kujtohet që të ketë apo ju kujtohet se ju
24 ka thënë diçka tjetër po thoni?

25 PË. Nuk më kujtohet. Krejt atë çka e ka thënë e ka thënë në

1 libër.

2 PY. Pra, që të jemi të qartë, nuk ju kujtohet që Shukri Buja
3 ju ka thënë, pra, nuk ju kujtohet që t'ju ketë thënë Shukri
4 Buja ndonjëherë që diçka që ju keni shkruar nuk është e saktë,
5 kështu?

6 PË. Nuk më kujtohet.

7 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, kalojmë në anglisht
8 në faqen 036629 dhe në shqip 077047.

9 PY. Dhe po lexoj nga paragrafi i fundit në anglisht dhe
10 paragrafi i parë në shqip. Dëshmitar, këtu shohim disa fjalë
11 të shkruara nga profesor Daci, përfshirë dhe sa vijon.

12 "Autori ka përdorur si burim në këtë monografi shumë
13 dokumente dhe studime të cilat ..."

14 Pra dhe një herë:

15 "Autori ka përdorur si burim dhe si bazë të kësaj
16 monografie shumë dokumente autentike, urdhëresa, raporte,
17 studime, të cilat mbeten të pakategorizuara në arkivën e zonës
18 operative të Nerodimës dhe në arkivën e Kosovës, kryesisht në
19 zonën e UÇK-së.

20 "Këto dokumente të shumta japin një tablo të qartë dhe të
21 ngjarjeve më të rëndësishme të luftës së UÇK-së në zonën
22 operative të Nerodimës. Të dhënat origjinale janë të bollshme,
23 dalin nga faktet, intervistat, memualet, bisedat, kujtimet e
24 udhëheqësve të UÇK-së në zonën operative të UÇK-së. Autori
25 gjithashtu ka përdorur edhe shkrime në media të aso kohe si

1 mjete shtesë për verifikimin e të dhënave, duke e rritur më
2 tej vlerën profesionale dhe shkencore të kësaj monografie”.

3 Pyetja që kam tani është kjo, z. Dëshmitar, nëse
4 informacioni i profesor Dacit këtu në këtë fjalë hyrëse është
5 i saktë?

6 PË. Profesori është bazu në atë që ka parë në libër. Por,
7 prapë e përsëris se ne i kemi zmadhu gjërat, i kemi zbukuru
8 gjërat, këtë duhet ta keni parasysh.

9 PY. Pra, Dëshmitar, që ta sqarojmë edhe një herë. Po gënjente
10 profesori kur ka shkruar për librin tuaj?

11 PË. Asnjëherë nuk ka gënjy profesori. Dhe nuk gënjen
12 profesori. Ju lutem mos e thuni kështu, se e thashë, profesori
13 gjithë vlerësimin e ka dhënë duke u bazu në atë që ka parë në
14 libër. Po ato që i kemi prezantu -- që i kam prezantu unë, unë
15 i kam rrit gjërat, i kam zbukuru gjërat për shkak që të del
16 libri sa më bukur. Ashtu qysh kemi pas
17 dëshirë dhe jo qysh ka qenë.

18 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do të doja të
19 kërkoja të pranoheshin faqet që i kam treguar dëshmitarit nga
20 libri, mund t’ju jap numrat. Janë faqet 036622 dhe në shqip,
21 077039, 077040, 073664 dhe në shqip 077041, 036637 dhe në
22 shqip 077054 dhe 036629 dhe në shqip 077046 dhe 077047.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtojmë. Ne s’e kuptojmë
24 çfarë relevance ka pranimi i tyre sepse nuk është parashtruar
25 asgjë konkrete për këtë librin. Duke marrë parasysh dhe

1 kundërshtimet që bëmë dje, ne duam të dimë çfarë rregullash do
2 zbatohen për pranimin e faqeve përkatëse të librit. Ne duam të
3 kuptojmë një herë fillimisht çfarë qëllimi ka përdorimi i
4 këtij librit dhe më pas të pranohet në tërësinë e vet dhe të
5 japim një mendim përfundimisht për kundërshtimin tonë.

6 Thjesht t'i tregosh titullin e librit e disa komente për
7 vlerën e librit nuk tregon çfarë vlerë provuese apo çfarë
8 relevance ka për ne kjo gjë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
10 çaktivizuar]

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mbështesim të njëjtin parashtrim.

12 Z. TULLY: [Përkthim] Mbështesim të njëjtin parashtrim.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Mbështesim të njëjtin parashtrim.

14 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqet e
16 saponumërtuara pranohen, janë relevante për librin edhe për
17 këtë çështje. Janë autentike, kanë vlerë provuese edhe andaj
18 pranohen. Kështu që i lutem Sekretares së Gjykatës t'u japi
19 numrin e provës materiale.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 faqja 077039, faqja 077040, faqja 077041, 077045 dhe 077046
22 deri në 47, versioni në gjuhën shqipe dhe përkthimi në gjuhën
23 angleze, marrin numrin e provës materiale P01015. Dhe dua po
24 ashtu t'ju informojë që faqet janë marrë nga libri që ka
25 numrin ERN 077039 deri në 077258, ndërsa përkthimi në gjuhën

1 angleze ka numrin 036622 deri në 036837. Dhe klasifikimi i
2 këtij libri është konfidencial.

3 Z. PACE: [Përkthim] Si versioni anglisht dhe versioni në
4 gjuhën shqipe mund të jenë publike.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
6 kundërshtime? A ka kundërshtime për klasifikimin?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim për
9 këtë.

10 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 Atëherë riklasifikohen si versione publike.

15 Vazhdoni, z. Pace.

16 Z. PACE: [Përkthim] Ju faleminderit

17 PY. Dëshmitar, duke marrë parasysh librin që keni përpara, a
18 keni përfshirë në dijeninë tuaj të plotë, a keni përfshirë në
19 këtë libër fakte që ju i dinit që nuk ishin të vërteta?

20 PË. Nuk më kujtohet.

21 PY. Pra, nuk ju kujtohet nëse qëllimisht keni përfshirë aty
22 fakte që ju e dinit që s'ishin të vërteta, kështu po thoni?

23 PË. Nuk më kujtohet. Vetëm e thashë edhe më herët, ka gjëra
24 që i kam rritur, ka gjëra që i kam zbukuruar. Dhe të gjitha
25 ato i kam paraqit në libër ashtu qysh kam pas dëshirë me qenë

1 e jo qysh kanë qenë në realitet, se realiteti ka qenë diçka
2 tjetër. Se kushtet nuk na i kanë leju, kushtet kanë qenë shumë
3 të rënda që ta zhvillojmë gjithë atë luftë ashtu qysh e kam
4 paraqit në libër.

5 PY. A mund të keni shkruar diçka në këtë libër që ju e dinit
6 që s'ishte e vërtetë?

7 PË. Për momentin nuk më kujtohet.

8 PY. Pra, tani s'ju vjen në mendje ndonjë gjë e pavërtetë në
9 atë libër?

10 PË. Nuk më kujtohet.

11 PY. Dua që të jeni më i qartë që të kuptohemi. Nuk ju
12 kujtohet të keni shkruar diçka në atë libër që ishte e
13 pavërtetë, pra, nuk ju kujtohet që në atë libër të keni thënë
14 diçka që s'është e vërtetë për atë kohë, kështu, apo jo?

15 PË. Nuk jam në gjendje tani për tani t'i specifikoj cilat
16 janë ato gjëra. Kështu që për atë nuk kam përgjigje të saktë.

17 PY. Dëshmitar, unë prapë s'po ju kuptoj, do të duhet ta
18 përsëris më vjen keq. Çfarë nuk më thoni dot konkretisht tani?
19 Nuk më thoni dot tani që "jo nuk kam thënë informacione të
20 rreme në këtë libër"?

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kundërshtoj. As unë s'e kuptoj
22 pyetjen, sepse ka dy pjesë mohuese.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet ta
24 riformuloni pyetjen, z. Pace. Pajtohem pyetja nuk është e
25 qartë.

1 Z. PACE: [Përkthim] Po. Mund ta bëj pyetjen dhe ndryshe.
2 Dhe po për këtë do të doja t'ju tregoja një deklaratë të
3 mëparshme të dëshmitarit për t'i rifreskuar kujtesën.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, tërhiqni
5 pyetjen?

6 Z. PACE: [Përkthim] Po. Do ta riformuloj pyetjen në një
7 formë tjetër.

8 I lutem Sekretares së Gjykatës, të vendosë në ekran
9 074301-TR-ET Pjesa 1. Dhe shqipja po ashtu e të njëjtit
10 version. Shkojmë në faqen 17 në anglisht dhe fillojmë me faqen
11 20 tek versioni në gjuhën shqipe.

12 Pjesa 1, faqja 17 tek anglishtja. Po, në rregull. Jo, nuk
13 është faqja e duhur. Faqja 17. Në shqip duhet jetë faqja 20.
14 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj diçka nga deklarata që i keni
15 dhënë ZPS-së në shkurt 2020. Unë do lexoj nga anglishtja po në
16 të djathtë keni dhe shqipen.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thoni në
18 cilin rresht.

19 Z. PACE: [Përkthim] Do lexoj nga rreshti 13 në anglisht.
20 Ndërsa nga shqipja nga rreshti 9 dhe vazhdon në faqen tjetër.

21 PY. "PY. A keni përfshirë me dijëni fakte që e dinit që
22 ishin të pavërteta në këtë libër?

23 "PË. Jo. Mesa di ..."

24 Po ndaloj këtu. Pra, Dëshmitar, a është e vërtetë apo e
25 pavërtetë kjo që keni thënë shkurt të 2020, që keni thënë jo

1 nuk kam përfshirë fakte që të kem pasur dijeni të kenë qenë të
2 pavërteta?

3 PË. E kam thënë. Po prapë po e përsëris se nuk jam i sigurtë
4 në këtë çështje.

5 PY. Po vazhdoj të lexoj përgjigjen tuaj:

6 "Jo, mesa kam dijeni, unë e di që nuk do shkruaja diçka
7 që nuk është e vërtetë".

8 A mund t'i thoni Trupit Gjykues a është e vërtetë kjo që
9 keni thënë këtu?

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Më falni. Duhet të çohem. Do ishte
11 mirë që të lexohej e gjithë përgjigja e dëshmitarit që të ketë
12 --

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
14 Prokurori nuk e lexon të gjithë përgjigjen do sigurohemi ne që
15 ta lexojë, por për momentin t'i japim mundësinë që të bëjë
16 pyetjen.

17 Vazhdoni, z. Pace.

18 Z. PACE: [Përkthim]

19 PY. Dëshmitar, po e përsëris edhe një herë. Ju thatë:

20 "Mesa kam dijeni, unë e di që nuk do të shkruaja diçka që
21 nuk është e vërtetë".

22 Pyetja ime është kjo: Kjo që keni thënë këtu është e
23 vërtetë apo jo?

24 PË. Dëshiroj që të lexohet fjalia e tëra.

25 PY. Dëshmitar, këtu jeni që të t'i përgjigjeni pyetjes sime.

1 Do ua lexoj unë pjesën tjetër të përgjigjes kur të vendos unë.

2 PË. Kështu pjesërisht nuk muj me u përgjigj. Se fjalia nëse
3 shkon fjalë për fjalë e hup kuptimin.

4 PY. Dëshmitar, po në fjalinë që unë ju lexova, ju thoni "jam
5 i vetëdijshëm që nuk do shkruaja diçka që nuk është e
6 vërtetë". Kjo është e vërtetë apo jo? A mund t'i përgjigjesh
7 kësaj pyetjeje?

8 PË. Në cilin numër është? Nuk po e shoh këtu.

9 PY. Besoj se e dëgjuat përkthimin, megjithatë në qoftë se
10 doni ta shikoni tek versioni në shqip e ke në ekran, është
11 faqja 20, rreshti 9 dhe vazhdojmë pastaj tek faqja tjetër, tek
12 rreshti 12. Dëgjoni. Ju lutem dëgjoni dhe njëherë çfarë po
13 them, Dëshmitar. Ju keni thënë në shkurt të 2020 kështu:

14 "Mesa jam unë i vetëdijshëm, unë e di që nuk do shkruaja
15 diçka që nuk është e vërtetë".

16 Tani, a mund t'i thoni Trupit Gjykues kjo që keni thënë
17 është e vërtetë apo jo?

18 PË. Vetëm duhet ta lexojmë fjalinë paraprahe ku kam thënë

19 "Jam mundu --

20 PËRKTHYESJA: Përkthyesi nuk mundi ta përkthente z.

21 Misetic.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
23 prisni një çast.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt duhet ta informoni
25 dëshmitarin që fillon tek rreshti 24 në shqip. Tek rreshti 24.

1 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. E vlerësoj.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
3 dëgjoni dhe një herë pyetjen ju lutem. Dëshmitar, dëgjoni
4 pyetjen që po ju bëjnë dhe përgjigjuni. Mos kërkoni diçka që
5 nuk është në pyetje. Thjesht përgjigjuni pyetjes. Do t'ju
6 jepet mundësia të jepni sqarime të mëtutjeshme, por për
7 momentin ju lutem përgjigjuni pyetjes që po ju bën z. Pace.

8 Vazhdoni, z. Pace. Përsëriteni pyetjen.

9 Z. PACE: [Përkthim]

10 PY. Edhe një herë, Dëshmitar, dëgjoni me kujdes. Ju keni
11 deklaruar në shkurt të 2020, keni thënë kështu:

12 "Mesa jam në dijeni, unë nuk do shkruaja diçka që nuk
13 është e vërtetë".

14 Kjo është e saktë apo jo? Është e vërtetë apo jo?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm me "po"
16 ose me "jo" mund të përgjigjeni. E vërtetë ose e pavërtetë.

17 DËSHMITARI: E saktë është.

18 Z. PACE: [Përkthim] Po vazhdoj të lexoj pjesën tjetër.

19 Pastaj ju thoni:

20 "Ka mundësi, ka mundësi që diçka të mos ketë qenë e
21 vërtetë sepse nuk kam pasur të gjitha dokumentet që t'i
22 mbështesja. Është e mundshme që të kam harruar diçka ose dhe
23 kolegët e mi, bashkëluftëtarët mund të kenë harruar po ashtu
24 diçka".

25 Është e vërtetë, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përpara se të përfundojmë, a mund
3 të dalë në transkript përgjigja e dëshmitarit?

4 Z. PACE: [Përkthim] Nuk është relevante pjesa tjetër. Mua
5 më intereson ajo që ka thënë dëshmitari. Nëse Avokati ka
6 nevojë për sqarime të mëtutjeshme, le ta bëjë me kundërpvetjet
7 e veta.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë pajtohem
9 me Emmerson duhet të jetë e gjithë përgjigja për transkript.

10 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull atëherë. Unë po lexoj të
11 gjithë paragrafin.

12 PY. Fjalja e fundit është kështu:

13 "Por unë vetë si autor i librit do ju këshilloja të mos u
14 bazu shumë tek ky libër duke ditur rëndësinë e këtij procesi".

15 A e keni thënë këtë në shkurt të 2020?

16 PË. Po.

17 PY. Dëshmitar, meqë ky libër është botuar për herë të parë në
18 2012, ju ka informuar ndonjëherë ndonjë person pas botimit të
19 këtij libri që ka gabime, pasaktësi në këtë libër?

20 PË. Nuk më ka njoftu askush. Po edhe unë s'kam pas kohë me u
21 marrë me këtë më detalisht.

22 PY. Pra, në këto 12 vite që prej botimit të librit në gjuhën
23 shqipe askush nuk ju vuri në dukje ndonjë gabim?

24 PË. Mu personalisht nuk mu ka drejtu askush.

25 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës të

1 kthehemi edhe një herë tek libri që mban numrin e provës
2 materiale 036622, 033837 dhe në shqip 07739, 077258. Dhe duhet
3 të shkojmë në faqet 037805 në gjuhën angleze. 036805 në
4 anglisht. Shqip është faqja 077225. Dhe do ju lutesh atë
5 zmadhoheshit fotografitë në të dyja versionet në fund të
6 faqes.

7 PY. Dëshmitar, përpara keni dy faqe të tjera të librit tuaj,
8 në të djathtë në shqip dhe në të majtë në anglisht dhe kemi
9 zmadhuar një fotografi këtu. A e njihni këtë vend në këtë
10 fotografi?

11 PË. Po, ky vend është kulla e Hasanit mbi fshatin Bob.

12 PY. Pra, ky është vendi ku ishte njësitë Feriz Gurit në 1999
13 siç e përmendët ju?

14 PË. Po.

15 PY. Shohim dhe një minutazh apo shohim një datë, më falni, në
16 fotografi. Duket 13-3-99. Mesa keni dijeni ju, e saktë është
17 kjo?

18 PË. Ka mundësi. Po sigurt nuk muj me konfirmu për shkak se
19 kjo është nxjerrë, kjo fotografi është nxjerrë nga incizimet
20 edhe nga një herë datat mujn teknikisht mos me u kanë të
21 sakta.

22 PY. Shohim që këtu thuhet: "Komanda e Brigadës 162 Agim
23 Bajrami në konsultim pune". A mund të na e konfirmoni që është
24 e saktë kjo që është shkruar këtu?

25 PË. Një pjesë e komandës, unë jam me një pjesë.

1 PY. A jeni ju tek kjo fotografia në këtë takim?

2 PË. Po.

3 PY. A ju kujtohet për çfarë ka qenë ky takimi?

4 PË. Saktë nuk e di. Po këtu zakonisht në këtë kullë ku ka
5 qëndru njësia e Feriz Gurit kanë të gjithë vullnetarët e kanë
6 pas si pikë ku ju kanë drejtu dhe ju kanë bashkangjitur Ushtrisë
7 Çlirimtare të Kosovës në Kaçanik. Aty, për shkak se unë kam
8 pas detyrën që t'i përgatiti ushtarët e rinj, t'i përgatiti në
9 përdorimin e armatimit, njohjen e armatimit, t'i përgatiti për
10 detyrat e ushtarëve në luftë, njësive në luftë. Kështu që me
11 siguri se në këtë drejtim ka qenë kjo.

12 PY. A ju kujtohet kush ka marrë pjesë në atë takim?

13 PË. Saktë nuk më kujtohet edhe nga fotografia nuk po muj mi
14 pa saktë cilët janë këta.

15 PY. Më herët thatë që ndonjëherë shkonit tek ky vendi sepse
16 këtu mund të merrnit edhe ushqim. A mund të na sqaroni nëse
17 kuzhina, që përshkruat ju më herët, është në këtë godinën në
18 këtë fotografi?

19 PË. Po, kuzhina ka qenë në këtë objekt.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja që të
21 pranohej ky imazh, por më informuan që tashmë ky imazh është
22 pranuar si provë materiale bashkëshoqëruese me numër 01002 me
23 një dëshmitar tjetër. Kështu që nuk po kërkoj që të pranohet
24 tani, po do ju lutesha të ma konfirmonit nëse është ky rast.

25 Tani do lutesha të shihnim një libër tjetër të këtij

1 dëshmitari. Që ka tjetër ERN. 0439900 deri në 044399. Është
2 libri për të cilin kemi pranuar disa nga faqet. Edhe përkthimi
3 në gjuhën angleze ka numrin 044212, 044216-ET. Faleminderit.
4 Shkojmë tek faqja 044213 në shqip edhe, në fakt edhe
5 anglishtja është me të njëjtin numër. Të zmadhojmë dy
6 fotografitë në fund të faqes tek versioni në shqip dhe
7 diçiturën. Besoj se në anglisht po ashtu është përkthyer.
8 PY. Dëshmitar, ky është nga libri tjetër që e diskutuam dje.
9 Në të djathë shihni shqipen fotografi, diçitura edhe në të
10 majtë është përkthimi në anglisht.

11 A mund të na konfirmoni nëse imazhet në fund në të
12 djathtë po ashtu janë imazhe të njësitit, të vendit ku
13 qëndronte njësitit i Feriz Gurit?

14 PË. Po.

15 PY. A njihni ndonjë nga personat në këtë fotografi qoftë në
16 djathtë qoftë në të majtë?

17 PË. Në fotografi në të majtë jam unë edhe dy vëllezërit e mi
18 dhe dy bashkëluftëtarë tjerë.

19 PY. Vëllezërit e tu dhe bashkëluftëtarët e tjerë ishin po
20 ashtu pjesë e Brigadës 162?

21 PË. Po.

22 PY. Vendi ku ti, vëllezërit dhe dy bashkëluftëtarët jeni
23 është brenda këtu ndërtesës, domethënë, këtu ku jeni ju jeni
24 brenda kësaj ndërtesës që shikojmë në fotografi?

25 PË. Po, mbrenda.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 25

1 PY. Tek imazhi ku thoni që jeni ju edhe të tjerët, shohim
2 disa numra 2-4-99. Ju kujtohet ka qenë 2-4-99 apo 4-2-99, pra,
3 2 prill 1999 apo 4 shkurt 1999?

4 PË. Këtu qysh është paraqitë është 2 prill i 1999. Po prapë e
5 përsëris, siç e përsërita dhe më herët, këto fotografi janë
6 nxjerrë pi incizimeve.

7 PY. E kuptoj.

8 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja të
9 pranoheshin këto dy faqe. Mund t'i bashkëngjiten pjesëve të
10 tjera të librit që tashmë është pranuar si provë materiale.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
12 kundërshtime?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pati
15 kundërshtime nga asnjë prej Ekipeve të Mbrojtjes dhe këto dy
16 faqe pranohen.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, faqet
18 044213 në shqip dhe përkthimi në gjuhën angleze të marra nga
19 libri me numër 034900 deri në 044239 i bashkëngjiten provës
20 materiale P01014.

21 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

22 Sekretare e Gjykatës, do lutesha të shkonim në një provë
23 tjetër materiale. Është me numër SPOE0091385 deri në 0091408

24 RED. Është e rëndësishme që të vendosim në ekran versionin që
25 përfundon me RED.

- 1 Fillimisht shohim faqen që përfundon me 91402.
- 2 Faleminderit. Shkojmë pak më lart. Ku thotë "Fotografia numër
- 3 15".
- 4 PY. Dëshmitar, e njihni këtë vend në ekran përballë?
- 5 PË. Duket që është objekti te kulla e Hasanit, por nuk jam
- 6 shumë i sigurtë se paska ndryshu pak.
- 7 PY. Pra, duket si ai objekti ku ka qenë njësitë i Feriz
- 8 Gurit, kështu?
- 9 PË. Duket ashtu. Po nuk është komplet dhe s'po muj me
- 10 konstatu 100 për qind.
- 11 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretares të shkojmë në
- 12 faqen tjetër tek fotografia numër 16.
- 13 PY. Dëshmitar, e njëjta pyetje, e njihni këtë vendin që është
- 14 në fotografi?
- 15 PË. Prapë nuk është komplet objekti edhe s'po muj me qenë i
- 16 sigurt se është ai objekt.
- 17 PY. Për sqarim, ndërtesa që flisni ju, ju po flisni për
- 18 njësitin ku ishte Feriz Guri, apo jo?
- 19 PË. Po.
- 20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne nuk do
- 21 kërkojmë që të pranohen këto dy faqe. Po thjesht dua të vërej
- 22 që ka një version të paredaktuar i cili tashmë është pranuar.
- 23 Por do të doja të thoja për procesverbal që faqet që i tregova
- 24 këtij dëshmitari kanë redaktime të diçitura sepse janë pranuar
- 25 në version të paredaktuar tashmë.

1 Mund ta heqim nga ekrani këtë dokument.

2 PY. Dëshmitar, a njihni një person me emrin Jonuz Shurdhani?

3 PË. Jonuz. Po.

4 PY. Ka qenë anëtar i UÇK-së?

5 PË. Po, ka qenë nga marsi i 1999.

6 PY. Çfarë roli ka pasur në UÇK nga marsi i 1999?

7 PË. Nuk më kujtohet se detyrat i ka marrë nga komandanti i
8 brigadës, Qamil Ilazi.

9 PY. Pra, ka qenë në Brigadën 162, kështu?

10 PË. Po, ka qenë në Brigadën 162, po çfarë detyrash ka pas nuk
11 më kujtohet për shkak se detyrat i ka marrë nga komandanti i
12 brigadës, Qamil Ilazi.

13 PY. Dëshmitar --

14 Z. PACE: [Përkthim] Në fakt, më falni, shoh orën duhet të
15 bëjmë një pushim të shkurtër tani.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
17 shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë
20 pushimin dhjetë minutash.

21 --- Seanca ndërpritet në orën 9.59

22 --- Seanca rifillon në orën 10.11

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

24 Asistente e Sallës, ju lutem shoqëroni dëshmitarin të hyjë në
25 sallë.

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Prokuror,
3 mund të vazhdoni.

4 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

5 PY. Dëshmitar, Brigada 162 a kishte njësit të policisë
6 ushtarake?

7 PË. Po.

8 PY. Kush ishte përgjegjësi i asaj njësie?

9 PË. Përgjegjësi ka qenë Xhabir Elezi.

10 PY. Xhabir Elezi kur u bë përgjegjës i njësisë së policisë
11 ushtarake të Brigadës 162?

12 PË. Nuk e di se nuk ka qenë kompetencë e imja. Ka qenë
13 kompetencë e komandantit të brigadës.

14 PY. Xhabir Elezi raportonte tek komandanti i brigadës?

15 PË. Te komandanti i brigadës.

16 PY. Na rikujtoni pak Qamil Ilazi kur u bë komandant brigade?

17 PË. Qamil Ilazi ka marrë detyrën e komandantit të brigadës
18 nga rënia heroike e komandantit në parë të UÇK-së për Kaçanik
19 Agim Bajramit më 10 gusht 1998. Pastaj ka vazhdu komandimin e
20 brigadës Qamil Ilazi.

21 PY. Ju kujtohet nëse Xhabir Elezi ishte përgjegjës i njësisë
22 së policisë ushtarake ndërkohë që Agim Bajrami ishte ende
23 gjallë dhe komandonte brigadën?

24 PË. Nuk më kujtohet. Këto kanë qenë fillat e para dhe nuk kam
25 njohuri për atë periudhë.

1 PY. Kur morët ju detyrën si komandant në detyrë i brigadës në
2 maj të 1999, Brigadës 162, Xhabir Elezi a ishte ende
3 përgjegjësi i njësisë së policisë ushtarake të Brigadës 162?

4 PË. Po.

5 PY. Ju kujtohet, pak a shumë, sesa kohë kishte ai që ishte
6 përgjegjës i asaj njësie kur ju u bëtë komandant në detyrë i
7 Brigadës 162?

8 PË. Edhe një herë e përsëritni pyetjen?

9 PY. Pra, ju u bëtë komandant në detyrë në maj të 1999. Sa
10 muaj i kishte, nëse ju kujtohet, Xhabir Elezi si komandant i
11 njësisë së policisë ushtarake?

12 PË. Nuk e di. Dhe nuk kam pas, nuk kemi pas kohë gjatë luftës
13 që të mirrna me ata se nga kur është në këtë detyrë. Nuk e kam
14 pyet asnjëherë.

15 PY. E keni takuar ndonjëherë vetë Xhabir Elezin në 1998 a
16 1999?

17 PË. Në 1999 pas 15 majit, po.

18 PY. Po përpara 15 majit 1999 a keni takuar ndonjëherë?

19 PË. Jo.

20 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, dëshiroj që të
21 tregojmë një faqe nga 043900 deri në 044239, kjo është shqip.
22 Në anglisht është 044174 deri në 044186-ET. Do të tregoj një
23 tjetër faqe nga libri, nga pjesa që është pranuar tashmë si
24 014. Dhe faqet ku dua të shikojmë janë të dyja faqet 044138.
25 Faleminderit, znj. Sekretare.

1 PY. Dëshmitar, edhe një herë janë dy faqe në ekran, siç e
2 patë, janë nga libri juaj "Flakë e pashuar". Në të djathtë
3 është një dokument, pra, një faqe në gjuhën shqipe, në të
4 majtë është një përkthim që kemi bërë ne në anglisht. Siç e
5 shihni ka të bëjë me strukturën operative të policisë
6 ushtarake, autor i kësaj është Xhabir Elezi komandanti i
7 policisë ushtarake.

8 Ju lutem shihni informacionin në këtë dokument dhe na
9 thoni nëse ky informacion, me aq sa sini ju, është apo jo i
10 saktë?

11 PË. Po vetë bukurshkrimi dhe shkrimi dhe rregullimi i kësaj
12 tregon se ky dokument është përgatitë pas luftës. Dhe unë
13 gjatë luftës nuk e kam pas këtë dokument, po pas luftës e kam
14 marr.

15 Dhe këtu shihet zbulimi nga bukurshkrimi që është bërë.
16 Se s'besoj se në luftë nuk kemi pas kohë të shkruajmë aq bukur
17 e t'i rregullojmë gjërat ashtu qysh po shihet këtu.

18 PY. E kam kuptuar saktë se ju po thoni që ju vetë e keni
19 shkruar këtë dokument pas lufte?

20 PË. Jo, unë nuk e kam shkruar. Se edhe këtë bukurshkrim nuk e
21 kam unë.

22 PY. Çfarë ju shtyn që të thoni se kjo është shkruar pas
23 lufte?

24 PË. Më shtyn ajo se unë gjatë luftës nuk e kam parë këtë
25 dokument.

1 PY. Mund të na thoni kur e keni marrë për herë të parë këtë
2 dokument?

3 PË. Po, pas luftës. Saktë nuk muj tani saktë me thanë në
4 cillën kohë. Po pas luftës kur kam fillu përgatitjen e librit.

5 PY. Nga e keni marrë këtë dokument?

6 PË. Dokumentin e kam marrë nga bashkëluftëtari im, Xhabir
7 Elezi.

8 PY. Kur e morët nga Xhabir Elezi, bashkëluftëtari juaj, a ju
9 tha ndonjë gjë në veçanti lidhur me këtë?

10 PË. Nuk më kujtohet a kemi bisedu për gjëra tjera.

11 PY. Dokumenti duket se Xhabir Elezi, sipas këtij dokumenti,
12 ka pasur një nofkë apo pseudonim Sharri. Këtë pseudonim ka
13 pasur vërtetë?

14 PË. Realisht nuk më kujtohet se gjatë luftës asnjëherë nuk e
15 kam dit për këtë pseudonim. Unë gjatë luftës e kam njoft me
16 emër dhe mbiemër qysh më ka njoftë edhe ai mu.

17 PY. Shohim në këtë dokument, aty sipër, shohim emrat "Jonuz
18 Shurdhani - Ndihmëskomandant për Sigurinë". Ju pyeta më
19 përpara nëse ka pasur vërtet këtë rol brenda brigadës, pra, në
20 njësinë e policisë ushtarake?

21 PË. Nuk kam njohuri për këtë.

22 PY. Në pjesën e poshtme të dokumentit lexojmë si vijon.

23 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem të tregojmë dhe pjesën e
24 poshtme të dokumentit si në anglisht dhe në shqip.

25 Faleminderit, znj. Sekretare.

1 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj dhe ju mund ta ndiqni në ekran
2 ose nga përkthimi me gojë:

3 "Më 9 prill, tek vendi i quajtur 'Kroni i Çakocit' në
4 Kaçanik kanë rënë dëshmor Fadil Çaka, Nehat Çaka, Ilir Zharku,
5 Muhamet Zeneli dhe Faruk Dogani: Rustem Dema u plagos".

6 Dëshmitar, ju kujtohet nëse është e vërtetë që në datën 9
7 prill personat, emrat e të cilëve thuhet këtu, kanë rënë në
8 luftim dhe personi tjetër është plagosur?

9 PË. Po. Më 9 prill 1999 ka pas luftime të ashpra në lagjen
10 Rakoc dhe Lagjen të Re të Kaçanikut, ku atë ditë janë vra 28
11 dëshmorë e 32 qytetarë të Kaçanikut në paarmatosur nga forcat
12 serbe. Në mesin e tyre kanë ra edhe këta bashkëluftëtarë që i
13 lexuat ju pak më poshtë.

14 PY. Ju kujtohet gjithashtu që është plagosur Rustem Dema në
15 luftime, pra, në luftimet e 9 prillit?

16 PË. Po.

17 PY. Për të qenë të qartë, flasim për 9 prillin e 1999?

18 PË. Po. Për 9 prill. Më 9 prill gjatë luftimeve ka ndodhë
19 kjo.

20 PY. Po të shohim dokumentin poshtë djathtas ku është lista e
21 Skuadrës 4, shohim disa emra, disa prej të cilëve i kam lexuar
22 tashmë. Kemi, për shembull, Fadil Çakën, Rustem Demën, Nehat
23 Çakën, Ilir Zharkun, Muhamet Zenelin. Dhe mesa keni ju dijeni,
24 Dëshmitar, këta persona vërtet kanë bërë pjesë në një skuadër
25 të policisë ushtarake përpara se të vriteshin apo të

1 plagoseshin më 9 prill 1999?

2 PË. Po.

3 PY. Po të shohim listën për Skuadrën I, diçka më lartë

4 majtas, një prej emrave që shohim aty është Nuhi Provoliu. Ju

5 kujtohet nëse është vërtet e saktë që Nuhi Provoliu ka qenë

6 anëtar i policisë ushtarake të Brigadës 162?

7 PË. Tani një nga një muj dhe mos, mund edhe mos të më

8 kujtohen, por kjo shihet, shihet kjo listë që është bërë nga

9 përgjegjësi që ka qenë për atë njësi. Edhe nuk kisha lëshu unë

10 një nga një se muj edhe me gabu se nuk ka qenë përgjegjësi e

11 imja.

12 PY. Dhe duke harruar një herë këto çfarë thuhet aty në listë,

13 ju a e dini kush është Nuhi Provoliu?

14 PË. Nuhi Provoliun e njoh se komuna e Kaçanikut është një

15 komunë e vogël edhe gati se njihemi që të gjithë. E njoh si

16 çdo qytetar të Kaçanikut.

17 PY. Ju kujtohet nëse Nuhi Provoliu ka qenë anëtar i UÇK-së në

18 1998 apo 1999?

19 PË. Po, ka qenë.

20 PY. Në cilën brigadë apo batalion?

21 PË. Gjithherë po flas unë për Brigadën 162 Agim Bajrami, në

22 Kaçanik.

23 PY. Ju kujtohet nëse ka bërë pjesë në njësinë e policisë

24 ushtarake të 162 apo në ndonjë njësi tjetër të saj?

25 PË. Në bazë të këtij dokument po shihet që ka bërë pjesë. Po

1 unë edhe muj me gabu. Se nuk i njoh të gjithë ushtarët edhe të
2 gjitha njësitë nuk kam mundësi me i njoft.

3 PY. Majtas poshtë të këtij dokumenti, shohim që përmendet
4 Kulla e Hasanit, ky është i njëjti vend që keni përmendur pak
5 më përpara në fshatin Bob ku ndodhej njësia e Feriz Gurit, apo
6 jo?

7 PË. Po, është e saktë. Vetëm dokumenti si dokument duhet ta
8 keni parasysh që është shkru me këtë bukurshkrim, është
9 elaboru, po në fund nuk ka nënshkrim, nuk ka datë. Kështu që
10 do ta keni parasysh kur e kam thënë disa herë që zbukurimet,
11 rregullimet, kështu që nuk është dokument që mundet me i
12 shërby edhe aq shumë këtij procesi kaq të rëndësishëm.

13 PY. Mund t'ju thoni Gjykatëseve se për cilat zbukurime e
14 rregullime e keni fjalën në këtë dokument?

15 PË. Qe, për shembull, është bukurshkrimi. Janë rendit njësitë
16 sipas skuadrave. Janë dhënë dy data, në fund është shkru Kulla
17 e Hasanit. Nuk ka kurrkund datë. Në fund thuhet komandanti
18 Xhabir Elezi edhe këtu s'ka nënshkrim. Kështu që, vetë fakti
19 shihet se sa mundet me qenë valid ky dokument.

20 PY. Shohim se në fund të dokumentit përmendet që Sadik Guri
21 është vrarë në fshatin e Biqecit në 25 maj të 1999. A ju
22 kujtohet a është vërtet e saktë që ky person është vrarë në
23 atë datë në fshat?

24 PË. Po, por nuk është vra vetëm Sadik Guri aty, më 25 maj
25 1999 ka pas luftime të ashpra në komunën e Kaçanikut nga

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 35

1 fshati Bob, nga Gryka e Kaçanikut, fshati Bob, Kovaqec, Biqec,
2 Dubravë dhe në atë pjesë kanë ra disa dëshmorë të lirisë. Dhe
3 gjithashtu edhe kanë bë forcat serbe kanë masakru popullatën
4 civile, mbi 13 qytetarë të kësaj pjese i kanë masakru forcat
5 serbe.

6 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
7 pranohet kjo faqe në provat gjyqësore si në anglisht dhe në
8 shqip, si pjesë e faqeve P1014.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
10 kundërshtime?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duke qenë se
13 nuk ka kundërshtime, dokumenti pranohet në prova gjyqësore.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
15 faqja me numër 044183 në shqip dhe përkthimi i asaj në
16 anglisht nxjerrë nga libri me numër 043900 deri në 044239
17 marrin numrin e provës materiale P0104, do t'i shtohet, pra,
18 provës P0104. Me klasifikimin publik, duke qenë se është
19 klasifikuar publike.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Pace, mund të vazhdoni.

22 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

23 Të heqim këtë dokument, kalojmë në librin tjetër, që
24 është 036622 deri 036837, kjo është në anglisht. Në shqip
25 është 077039-077358. Dhe faqet që janë pranuar prej kësaj janë

1 pranuar me numrin P0105. Në anglisht, kalojmë në faqen 036645
2 e në shqip, në të djathtë, në faqen 077063, ju lutem.
3 PY. Do të lexoj nga anglishtja nga paragrafi i tretë dhe në
4 shqip është paragrafi i parë i faqes.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne sërish kemi kundërshtimin që i
6 duhet paraqitur, duhet bërë pyetje dëshmitarit në aspektin
7 moral çfarë di për këtë çështje. Sepse, siç e citova edhe dje,
8 kjo lidhet me jurisprudencën e Tribunalit Penal Ndërkombëtar
9 të Ruandës, në çështjen përkatëse, ku Prokurori mund të
10 paraqesë material nëse ka nevojë të bëjë pyetje lidhur me
11 diçka që është thënë më përpara gjatë një procesi gjyqësor.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet si
13 kundërshtim.

14 Mund të vazhdoni.

15 Z. PACE: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, do ta lexoj edhe një herë siç e thashë. Në
17 paragrafin e parë e keni në shqip aty. Edhe një herë nga
18 teksti është:

19 "Me urdhër të shtabit të UÇK-së Shukri Buja u kthye në
20 Kaçanik dhe njoftoi vendimin e shtabit për të emëruar Agim
21 Bajramin komandant të njësisë së Kaçanikut".

22 Ky është fundi i këtij citimi.

23 Pastaj ka një poshtëshënim me numër 21 dhe po të shkojmë
24 në fund të faqes e shohim që përmend një intervistë me Major-
25 Gjeneral Shukri Bujën, Lipjan, më 23 maj 2007. Dëshmitar,

1 pyetja ime është nëse kjo do të thotë se është Shukri Buja ai
2 që jua ka dhënë këtë informacion që sapo jua lexova në 2007?

3 PË. Nuk -- edhe një herë pyetjen ju lutem ma përsëritni?

4 PY. Patjetër. Pra, ju lexova një pjesë nga libri dhe ju thoni
5 diçka në shënimin poshtë faqes, ku thuhet se ky informacion
6 është marrë nga një intervistë me Shukri Bujën në 2007. Pyetja
7 që kam kjo është: Kjo do të thotë se Shukri buja është ai që
8 ua ka dhënë këtë informacion që unë jua lexova dhe ua ka thënë
9 në 2007?

10 PË. Shukri Buja, është e vërtetë që kam bisedu me Shukri
11 Bujën. Por, këtu prapë ka shumë gjëra që i kam rregulluar dhe
12 i kam zmadhuar që nuk janë ato që edhe m'i ka thënë Shukri
13 Buja. Dhe që i kam pa unë që jam bazu në këtë, nuk kam
14 dokumente të bazume.

15 PY. Edhe një herë, Dëshmitar, do ta lexoj edhe një herë
16 fjalinë dhe dua që të tregoni vëmendje sepse pas kësaj dua që
17 t'i thoni Gjykatësve konkretisht se çfarë keni zbukuruar dhe
18 rregulluar. Fjalja thotë:

19 "Me urdhër të shtabit të UÇK-së, Shukri Buja u kthye në
20 Kaçanik dhe njoftoi vendimin e shtabit për të emëruar Agim
21 Bajramin si komandant të njësisë së Kaçanikut".

22 Kaq.

23 Tani mund t'i shpjegoni Gjykatësve se çfarë i keni
24 rregulluar apo zbukuruar?

25 PË. E para nuk e kam parë asnjë urdhër të Shtabit të

1 Përgjithshëm për këtë emërim. E dyta, edhe Shukri Buja nuk më
2 ka thënë ashtu qysh e kam shkru, por ka thënë se e kam caktu
3 Agim Bajramin për komandant të njësitit të Kaçanikut. Këto
4 janë ato që pastaj unë i kam rregulluar në libër ashtu qysh
5 kemi pas dëshirë me qenë.

6 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj të kërkoj që të pranohen
7 këto faqe me numrat përkatës në anglisht dhe në shqip në prova
8 gjyqësore.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne e kundërshtojmë sepse është e
10 papranueshme në bazë të rregullës 143(2((c) dhe të
11 papranueshme në bazë të rregullës 138. Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokument
13 pranohet në prova gjyqësore.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
15 faqja me numër ERN 077063, versioni në shqip, nxjerrë nga
16 libri me numër ERN 077039 deri në 077238 dhe versioni në
17 anglisht me numër ERN 036645, nxjerrë nga dokumenti me ERN
18 036622 deri në 036837, i shtohet provës me numër P01015, me
19 klasifikim publik.

20 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Të kalojmë tani tek njëjti dokument, në anglisht majtas
22 në faqen 036669 dhe në shqip në faqen 077088. Në anglisht do
23 të filloj të lexoj diku nga fundi i faqes, e njëjta vlen edhe
24 në shqip. Duke kaluar dhe faqen tjetër.

25 PY. Dëshmitar edhe një herë, në ekran, keni në të djathtë

1 versionin në shqip, majtas është anglisht, të librit për të
2 cilin sapo kemi folur. Do lexoj diçka që ju e keni shkruar
3 këtu dhe pastaj kam një pyetje për këtë. Po citoj nga libri:
4 "Shtabi i UÇK-së formuloi një strategji më të gjerë për
5 çlirimin e Kosovës (Zona 1), ndryshoi emrin e nënzonës
6 operative për të reflektuar ndryshimin e tyre sipas zonës 1
7 (Kosovë) me emrin e kodifikuar Kosova dhe e përcaktoi si
8 qëllim kryesor çlirimin e saj. Nënzonat u bënë zona që
9 mbulonin të njëjta krahina si më parë dhe ruajtën strukturën e
10 tyre ekzistuese. Pas përgatitjeve të nëntorit 1998 dhe siç u
11 tha edhe siç ishte përcaktuar dhe në planin e shtabit të
12 operacioneve komanda e zonës së Nerodimës vendosi që të
13 krijonte dy brigada. Brigada 161 do të vepronte në regjionin e
14 Jezercit, ndërsa Brigada 162 do të operonte, do vepronin pra,
15 në regjionin e Kaçanikut. Pas këtyre përgatitjeve, komandanti
16 i zonës dërgoi ftesë Shukri Bujës, Qamil Ilazit dhe Hajrush
17 Kurtajt në 27 nëntor 1999, duke u kërkuar atyre që të shkonin
18 nga Kaçaniku në shtabin e zonës në Mollopolc. Ata mbërritën në
19 orën 23.00 dhe pas një pushimi të shkurtër u takuan me
20 komandantin e zonës. Pjesëmarrësit në këtë takim ishin: Shukri
21 Buja, Imri Ilazi, Qamil Ilazi dhe Hajrush Kurtaj. Shukri Buja
22 informoi pjesëmarrësit se pas organizimit dhe ristrukturimit
23 të UÇK-së kishin nevojë që të zgjidhnin një emër për brigadën.
24 Menjëherë, komandant Qazim Ilazi propozoi që, pra, propozoi
25 emërtimin përkatës.

1 "Nënzonat operative transformohen në zona operative,
2 kurse njësitet e UÇK-së transformohen në brigada. Komandanti i
3 zonës kërkoi që shtabi i Brigadës 162 për komandant të
4 Brigadës 162 të jetë Qamil Ilazi dhe për zëvendëskomandant i
5 Brigadës 162 do të jetë Hajrush Kurtaj. Ku dhe kërkoi që të
6 bëhej plotësimi i shtabit me anëtarë të rinj, propozoi
7 komandantë batalioni, togjeve dhe skuadrave. Të formohej një
8 tog i policisë ushtarake dhe të forcojnë njësitë e
9 furnizimit".

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Kemi kundërshtim.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
12 kundërshtimi.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse mund të kërkojmë sqarim për
14 atë që do të arrijë z. Pace, përndryshe unë do të vazhdoj që
15 të bëjë këto kundërshtime që të jenë në procesverbal.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndërmend
17 që të bëni, të keni një kundërshtim të përhershëm lidhur me
18 këtë?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Për sa kohë nuk është sqaruar
20 ende se ku kërkon të dalë Prokurori.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Z. PACE: [Përkthim]

23 PY. Ky informacion nga libri që unë jua lexova a është i
24 saktë?

25 PË. Jo, për këtë. Ky takim nuk ka ndodhë asnjëherë. Unë

1 personalisht nuk kam qenë në atë takim. Edhe këtu ma së miri
2 shihet ata që e thamë, s'e di për të sajten herë, që i kam
3 zbukuru. Domethënë, nuk kam marrë pjesë unë në atë takim. A ka
4 marrë pjesë komandanti i brigadës nuk e di, nuk kam njohuri.
5 Kështu që në libër e kam paraqitur se jemi taku, janë emëru,
6 që realisht unë nuk kam qenë në atë takim.

7 PY. Pra, kur e keni shkruar dhe botuar këtë në këtë libër që
8 keni marrë pjesë në takim në nëntor të 1998, kjo ka qenë një
9 trillim nga fillimi në fund?

10 PË. Jo, trillim, po një zbulim që e kam paraqit qysh është
11 dashtë me qenë, qysh kemi pas dëshirë me qenë.

12 PY. Dëshmitar, me sa e kuptoj unë zbulimin është që ka
13 ndodhur diçka po i shton disa hollësira. Në qoftë se thua që
14 është zbulim, a mund të na thoni konkretisht çfarë ka
15 ndodhur? I heqim aksesoret, zbulimet. Na thoni çfarë ka
16 ndodhur? Çfarë është relevante, çfarë ka ndodhur në këtë takim
17 në nëntor të 1998?

18 PË. Konkretisht unë nuk kam marrë pjesë në atë takim. Se a ka
19 marrë pjesë komandanti i brigadës në atë takim nuk kam
20 njohuri. Këtu e kam paraqitë ashtu qysh kemi pas dëshirë me
21 qenë.

22 PY. Po kthehem edhe një herë sepse paragrafi ka qenë shumë i
23 gjatë, unë do e zbërthej dhe do ju bëj pyetje më konkrete.

24 Do filloj nga fillimi:

25 "Shtabi i UÇK-së formuloi një strategji më të gjerë për

1 lirimin e Kosovës, ndryshoi emrin e nënzona për të
2 reflektuar këto ndryshime si zona 1 (Kosovë) edhe bëri si
3 qëllim kryesor lirimin e vendit”.

4 Tani, Dëshmitar, kjo është e saktë apo s’është e saktë
5 kjo që sapo lexova?

6 PË. Edhe kjo ka qenë një dëshirë për shkak se të gjitha
7 trojet shqiptare kanë qenë të okupuara më shumë se 100 vite
8 nga Serbia dhe ka qenë dëshirë e jona për çlirimin e të
9 gjitha, a në realitet ne kemi luftu për çlirimin e Kosovës.

10 PY. Të fokusohemi tek ndryshimi i emrit nga nënzona, pra, nga
11 nënzona kthehet në zona 1, ju po thoni që nuk ka ndodhur,
12 Kosova nuk u njoh si zona 1 nga UÇK, këtë po thoni?

13 PË. Nuk e thashë që nuk ka qenë Kosova. Thashë dëshira e jonë
14 ka qenë çlirimi i të gjitha trojeve të shqiptarëve që kanë
15 qenë të okupuara. Por realiteti ka qenë se ne kemi luftu për
16 çlirimin e Kosovës.

17 PY. Po Kosova është njohur ndonjëherë si zona 1, është thënë
18 ndonjëherë për Kosovën zona 1, 1 në UÇK?

19 PË. Nuk e kam pasur atë njohuri dhe asnjë dokument të asaj
20 fushe nuk kam parë unë.

21 PY. Fjalja tjetër thua:

22 “Nënzonat u bënë zona që mbulonin të njëjta territore si
23 më përpara dhe ruajtën strukturën e tyre fillestare”.

24 Kështu?

25 PË. Ne kemi fillu si ushtri vullnetare nëpër njësi të vogla,

1 grupe, njësi të vogla, nënzona, pastaj dhe zona. Kështu që nuk
2 kam njohuri në këtë drejtim më shumë.

3 PY. Dëshmitar, nuk ju përgjigje. Pyetja është kjo: Kjo që u
4 lexova a është e saktë? Ju keni thënë:

5 "Nënzonat u bënë zona me të njëjtën strukturë dhe
6 mbulonin të njëjtin territor si më përpara".

7 Kjo a është e saktë?

8 PË. Po e përsëris prap. Atë çka e shkru këtu ka qenë dëshirë
9 e imja, jo realitet. Se të kish qenë realitet u është dashtun
10 të kem edhe që këta çka shkru ta mbështesim me dokumentacion.
11 Dokumente të tilla nuk kam pas për këto zona që i kam shkru.

12 PY. Dëshmitar, këtu flisni dhe thoni nënzonat u bënë zona. E
13 ndryshojmë për një çast, flasim për nënzonat dhe u bënë zona,
14 po kjo a ka ndodhur ndonjëherë në UÇK që nënzonat u bënë zona
15 apo kjo nuk ka ndodhur me sa keni ju dijeni?

16 PË. Nuk më kujtohet saktë.

17 PY. Fokusohemi tek zona, nënzona e Nerodimës. Po nënzona e
18 Nerodimës u bë ndonjëherë zona operative e Nerodimës dhe nuk
19 quhej më nënzona?

20 PË. Po.

21 PY. Kur ka ndodhur ky ndryshim dhe kur ka ndodhur ky ndryshim
22 zona që mbulonte Nerodima ishte i njëjti regjion? Pra,
23 mbulonte të njëjtin territor që kishte mbuluar më përpara ajo
24 që quhej nënzona e Nerodimës, kur u bë dhe ky ndryshim?

25 PË. Kur ka ndodhë saktë nuk e di, por që ka pas zonën e

1 përgjegjesisë të njëjtë, po.

2 PY. Pra, kishte, mbulonte të njëjtën zonë përgjegjësie?

3 PË. Se si në nënzonën operative të Nerodimës, si në zonën
4 operative përgjegjësia e Brigadës 162 ka qenë Kaçaniku me
5 rrethinat. Kjo ishte përgjegjësia e Brigadës 162 Agim Bajrami.

6 PY. Sa i takon strukturës, me sa keni ju dijeni, pati ndonjë
7 ndryshim të konsiderueshëm kur u ndryshua emërtimi nga nënzonë
8 në zonë të Nerodimës? Nga pikëpamja strukturore pati ndonjë
9 ndryshim të madh?

10 PË. Nuk kam njohuri se zona nuk ka qenë kompetencë e imja.

11 PY. Ju keni qenë pjesë e Brigadës 162 si zëvendëskomandant
12 ose komandant në detyrë i kësaj brigade. Kur bëri ky ndryshimi
13 nga nënzonë në zonë, ty tu duk sikur pati ndonjë ndryshim për
14 ty vetë në zonën tënde?

15 PË. Jo, se nuk ka qenë përgjegjësi e imja. Përgjegjësi e
16 komandantit të brigadës ka qenë. Unë kam pas detyra të tjera.

17 PY. Por ju ishit pjesë e Brigadës 162, si zëvendëskomandant
18 dhe komandant në detyrë? Ju ishit, po punonit si pjesë e një
19 brigade, apo jo?

20 PË. Sigurisht se punoja si pjesë e brigadës, isha
21 zëvendëskomandant për operacione luftarake në vijën e frontit.
22 Detyrat e mia ishin që t'i përgatis ushtarët, njësitë për
23 ballafaqim në vijën e frontit të luftës. Edhe sa i përket
24 luftimeve, sa i përket vijës të frontit të luftës jam i
25 gatshëm çdo pyetje që ma bëni atë shka e di e them.

1 PY. Fjalja tjetër ishte kjo:

2 "Pas përgatitjeve të bëra në muajin nëntor të 1998 dhe në
3 bazë të planit të Shtabit të Përgjithshëm, komanda e zonës së
4 Nerodimës merr vendim që të formohen dy brigada".

5 A mund t'i thoni Gjykatësve është e vërtetë kjo, apo jo?

6 PË. Prapë, prapë e përsëris, i kemi rregullu ashtu qysh kemi
7 pas --

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
9 pyetja është kaq. Është e saktë apo e pasaktë kjo që sapo u
10 lexua? Na e shpjeguat. Na e shpjeguat disa herë këtë gjë.
11 Thjesht përgjigjuni pyetjes.

12 DËSHMITARI: Atëhere po ma cungoni të drejtën me thanë
13 taman atë shka du me thënë edhe atë shka di. Sa i përket kësaj
14 nuk është e saktë sipas meje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, unë po ju
16 them, unë po ju them t'i përgjigjeni pyetjes së Prokurorit.

17 DËSHMITARI: Përgjigja ime është: Nuk është e saktë.

18 Z. PACE: [Përkthim]

19 PY. Dëshmitar, po ua lexoj edhe një herë fjalinë dhe t'i
20 thoni Trupit Gjykues çfarë nuk është e saktë në këtë fjali.
21 Fjalja është kjo:

22 "Pas përgatitjeve të bëra gjatë muajit nëntor 1998 dhe në
23 bazë të planit të Shtabit të Përgjithshëm, komanda e zonës së
24 Nerodimës merr vendim që të formohen dy brigada."

25 Dëshmitar, thuaji Trupit Gjykues çfarë nuk është e

1 vërtetë në fjalinë që sapo ju lexova?

2 PË. Nuk është e vërtetë se nuk kam pa asnjë plan të Shtabit
3 të Përgjithshëm, nuk kam pa asnjë plan të komandës së zonës se
4 nuk ka qenë kompetencë e imja as Shtabi i Përgjithshëm, as
5 komanda e zonës, as komanda e brigadës. Unë vetëm kam qenë
6 zëvendëskomandant për operacionet luftarake në vijën e
7 frontit. Edhe në pyetjen që nuk ka qenë kompetencë e imja, nuk
8 mundem saktë me ju përgjigj.

9 PY. Dëshmitar, ju sapo thatë që nuk keni parë ndonjë plan të
10 Shtabit të Përgjithshëm. Por ama keni dëgjuar gjë, a keni
11 mësuar që të ketë pasur ndonjë plan të tillë prej ndonjë
12 personi apo në ndonjë formë tjetër?

13 PË. Vetëm unë nuk jam këtu me të flas çka kam dëgjuar. Vetëm
14 atë shka e kam parë vetë edhe shka kam punu muj me u përgjigj
15 Se shka kam dëgju, shka s'kam ngëgju nuk muj me u përgjigj.

16 PY. Dëshmitar, që të jemi të qartë, këtu jeni t'u përgjigjeni
17 pyetjeve që unë ju bëj me përjashtim të rasteve kur s'e lejon
18 Gjykatësi. Kështu që kur ju pyes unë "a keni dëgjuar diçka për
19 këtë" e keni për detyrë të përgjigjeni me përjashtim të
20 rasteve kur s'ma lejon Gjykatësi një pyetje të tillë.

21 Edhe një herë, ju thatë që nuk e keni parë vetë një plan
22 të tillë të Shtabit të Përgjithshëm. Tani, a mund t'i thoni
23 Trupit Gjykues a keni dëgjuar që të ketë pasur një plan të
24 tillë apo a keni mësuar që të ketë pasur një plan tillë përmes
25 formave të tjera?

1 PË. Në kohën e luftës, jo.

2 PY. Po a keni mësuar apo dëgjuar për këtë plan pas lufte?

3 PË. Jo.

4 PY. A ju kujtohet ndonjëherë t'i keni thënë Prokurorisë se
5 keni marrë informata për një plan të tillë nga komandant Qamil
6 Ilazi?

7 PË. Për momentin nuk më kujtohet.

8 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, meqë nuk i
9 kujtohet dëshmitarit do të doja t'i tregoja një nga deklaratat
10 e mëparshme me lejen tuaj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

12 Z. PACE: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, bëhet fjalë për
13 deklaratën me numër 074301-TR-ET Pjesa 4 edhe e njëjta gjë për
14 shqipen po përfundon me -AT në fund. Do të filloj të lexoj në
15 faqen 6, rreshti 13 në anglisht dhe në shqip faqja 6, rreshti
16 24. Faqja 6, rreshti 9, më duket se është në shqip.

17 PY. Dëshmitar, sikurse ju thashë, kjo është deklarata që keni
18 dhënë ju në shkurt të 2020, unë do ju lexoj çfarë është
19 zbardhur këtu dhe kam disa pyetje pastaj në lidhje me këtë.
20 Pra, pyetje, Dëshmitar, këtu po flasim, jeni referuar librit
21 dhe të njëjtës faqe që sapo diskutuam bashkë:

22 "PY. Në faqen 36669, ju thoni që:

23 "'Pas përgatitjeve të nëntorit të 1998, siç ishin bazuar
24 në planin operativ të Shtabit të Përgjithshëm, komanda e zonës
25 së Nerodimës vendosi të formonte dy brigada'.

1 "Për cilin plan operativ të Shtabi Përgjithshëm e keni
2 fjalën këtu?

3 "PË. Sepse në fillim ka qenë njësit i Kaçanikut që
4 funksiononte atje. Po pas transformimit dhe rritjes në numër,
5 u kthye në Brigadën 162.

6 "PY. Pra, e kuptoj unë siç duhet që ndryshoi nga njësit
7 në brigadë bazuar në planin operativ të Shtabit të
8 Përgjithshëm që përmendët ju?

9 "PË. Po.

10 "PY. Po si ju vutë ju në dijeni që ekzistonte një plan
11 operativ i Shtabit të Përgjithshëm në atë kohë?

12 "PË. Bazuar në informacionin që mora nga komandanti,
13 Qamil Ilazi.

14 "PY. Pra, e kuptoj unë siç duhet që Shtabi i
15 Përgjithshëm ka përgatitur një plan operativ dhe ia ka
16 komunikuar Qamil Ilazit ose dikujt tjetër që më pas ia
17 përcolli atij dhe më pas ai jua përcolli ju?

18 "PË. Po."

19 Dëshmitar, keni dyshime për përgjigjet që keni dhënë apo
20 i kundërshtoni përgjigjet që keni dhënë në intervistën e
21 shkurtit të 2020?

22 PË. Absolut e kundërshtoj. Se edhe nëse e kam dhënë këtë
23 përgjigje, nuk e kam të bazume se asnjë plan, asnjë urdhër nga
24 Shtabi i Përgjithshëm nuk kam parë, asnjë plan për ndryshime
25 nuk kam parë nga Shtabi i Përgjithshëm. E as që e kam bisedu

1 me komandantin e brigadës.

2 PY. Dëshmitar, po e kuptoj unë tamam, ju tani po i thoni nën
3 betim Gjykatësve që informata që keni dhënë që unë sapo ua
4 lexova ju nuk ka qenë e vërtetë? Ka qenë e rreme?

5 PË. I nderuar Prokuror, disa herë e përmend fjalën "rrenë".
6 Rrenë nuk dëshiroj ta ndëgjoj. Se nëse vazhdojmë, ma herët
7 thatë edhe profesorin se ka rrejt, nëse vazhdoni me këtë
8 komunikim, unë e ndërpres pa e marrë parasysh pasojave, se nuk
9 mërzitna për pasoja absolut. Fjalën "rrenë" heke pi fjalorit.

10 Edhe gjatë hetuesisë e keni përmend, keni thënë se a ka
11 rrejt profesori a keni rrejt ju. Fjalën "rrenë" ju lutem e
12 hiqni ose nga ky moment e ndërpres pa marrë parasysh jam i
13 vetëdijshtëm për pasojat. Jam i vetëdijshtëm që jeni fuqi e mund
14 t'i merrni masat, po për atë punë nuk mërzitna, vetëm nuk
15 toleroj që të përdoret fjala "rrenë" as për mu, as për
16 profesorin, as për kërr kënd, as për një qytetar të Republikës
17 së Kosovës.

18 Z. PACE: [Përkthim] Shoh që është ora 11.00, është
19 momenti për pushimin, megjithatë para se të bëj pushimin do i
20 lutesha Gjykatësve të udhëzojnë dëshmitarin që t'u përgjigjet
21 pyetjeve.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do ta
23 bëjmë këtë pas pushimit.

24 Ju lutem shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit.

25 Dëshmitar, mos flisni me askënd për dëshminë që keni

1 dhënë në sallën e gjyqit. Do bëjmë gjysmë ore pushim tani, siç
2 është zakonisht e planifikuar.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në
5 orën 11.30.

6 --- Pauza fillon në orën 11.01

7 --- Seanca rifillon në orën 11.30

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

9 Asistente e Sallës, mund të shoqëroni dëshmitarin të hyjë në
10 sallë.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar.

13 Dëshmitar, dua që të flas shumë qartë me ju. Këtu sot, edhe
14 dje, dhe me shumë gjasë edhe nesër, jeni që të dëshmoni si
15 dëshmitar. Detyrimi që keni këtu është ky, t'u përgjigjeni
16 pyetjeve të cilat jua bëjnë, dhe të thoni të vërtetën. Asnjë
17 detyrim tjetër nuk keni. Nuk e vendosni ju se si duhet të jetë
18 gjuha e pyetjeve apo çfarë pyetjesh duhet t'ju bëjnë.

19 Nëse jeni dëshmitar [Sipas përkthimit] ju apo dikush
20 tjetër, këtë nuk e përcakton Prokuroria, nuk e përcakton
21 Mbrojtja, nuk e përcaktoni as ju. Vetëm Trupi Gjykes mund ta
22 përcaktojë nëse dikush po gënjen ose jo. Dhe ju siguroj që ne
23 do të bëjmë një vlerësim të kujdesshëm për të bërë këtë
24 përcaktim për dëshminë tuaj dhe dëshminë e gjithë të tjerëve
25 në këtë çështje gjyqësore. Por ju nuk mund të kundërshtoni

1 pyetjet që jua bëjnë. I vetmi detyrim që keni është që t'u
2 përgjigjeni. Thujse gjithmonë mund të mjaftojë dhe një
3 përgjigje "po" ose "jo", "saktë", ose "jo". Vetëm nëse ndonjë
4 prej atyre që jua bëjnë pyetjet ju kërkojnë shpjegime, mund të
5 shpjegoni më shumë.

6 Këtë e kuptoni, po ose jo?

7 DËSHMITARI: E qartë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dua që të jem
9 shumë i qartë, ky është detyrimi që e keni, edhe nëse nuk e
10 respektoni këtë detyrim mund të ketë pasoja, dhe nuk duam që
11 të shkojmë deri aty. Por këtu jeni vetëm për këtë qëllim, për
12 qëllimin që t'u përgjigjeni pyetjeve, e kuptuat? Më kuptoni
13 çfarë po them?

14 DËSHMITARI: Po, po.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të donim
16 që ta përfundonim dëshminë tuaj brenda një afati të arsyeshëm,
17 nëse ju jepni përgjigje të gjata ose evazive, nuk na ndihmon
18 që t'i japim fund dëshmisë tuaj herët.

19 Z. Prokuror, mund të vazhdoni.

20 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

21 Znj. Sekretare, ju lutem nxirrni të njëjtat faqe që
22 kishim nga një deklaratë e mëparshme që është 074301-TR-ET
23 Pjesa 4, edhe në shqip. Nga anglishtja, faqja 6, rreshti 13,
24 në shqip në faqen 6, diku nga fundi i faqes.

25 PY. Dëshmitar, ngaqë bëmë një pushim dua që t'ju lexoj

1 pikërisht atë që keni thënë nga intervista me ZPS-në, e 2020,
2 dhe dua t'ju pyes nëse është e saktë kjo, a është e vërtetë
3 kjo apo jo, sepse nuk m'u përgjigjët pyetjes.

4 "PY. Në faqen 36669, thoni se:

5 "'Pas përgatitjeve të nëntorit të vitit 1998 dhe siç u
6 tha në planin e përgatitjeve të shtabit, komanda e zonës së
7 Nerodimes vendosi që të krijonte dy brigada.'

8 "Çfarë, për cilin plan operacionesh të shtabit e keni
9 fjalën?

10 Përgjigja juaj është:

11 "PË. Sepse në fillim, fillimisht ishte njësia e
12 Kaçanikut që vepronte. Kështu që pas transformimit dhe rritjes
13 në numër, u shndërrua në Brigadën 162.

14 "PY. E kam kuptuar qartë që kjo e ndryshoi, pra, nga
15 njësi në brigadë... dhe", pyes "nga e dini këtë?"

16 "PË. Në bazë të informacionit që e kam marrë nga
17 komandanti Qamil Ilazi.

18 "PY. Pra e kam kuptuar saktë se Shtabi i Përgjithshëm ka
19 përgatitur një plan operacionesh dhe i ka komunikuar këtë
20 Qamil Ilazit dhe -- apo dikujt me të cilin ju keni komunikuar
21 dhe pastaj ai juve?

22 "PË. Po.

23 Pra, pyetja ime është: Kjo këtu është e vërtetë apo jo?

24 PY. E thashë ma herët, po e përsëris prapë. Plan nga Shtabi i
25 Përgjithshëm nuk kam parë asnjëherë. Dhe njësia e Kaçanikut u

1 shndërru në brigadë, kjo është e vërtetë. Por plan nga Shtabi
2 i Përgjithshëm nuk kam pa.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo nuk ishte
4 pyetja. Dëgjojeni dhe një herë pyetjen, vetëm pyetjen në fund
5 dhe përgjigjuni pyetjes.

6 Z. PACE: [Përkthim] Do ta lexoj dhe një herë pjesën dhe
7 do ta bëj prapë pyetjen.

8 PY. Dëshmitar, do ta lexoj edhe një herë, besoj për herë të
9 tretë. Dhe po jua them edhe një herë. Pyetja, mbasi të mbaroj
10 leximin është vetëm kjo. Informacioni që keni dhënë, është i
11 saktë apo jo? Mbajeni parasysht këtë pyetje.

12 "PY. Në faqen 36669, thoni se:

13 "'Pas përgatitjeve të nëntorit në 1998 dhe siç
14 parashtrohet në planin e operacioneve të shtabit, komanda e
15 zonës së Nerodimes vendosi që të krijonte dy brigada.'

16 "Çfarë plani operacionesh të shtabit i referoheni ju
17 këtu?

18 "PË. Për shkak se fillimisht kanë funksionuar si njësitë
19 i Kaçanikut. Pastaj pas një transformimi që ka ndodhur,
20 rritjes, u shndërrua në Brigadën 162.

21 "PY. E kam kuptuar saktë se themi që ajo u kthye nga
22 njësi në brigadë në bazë të planit të operacioneve të cilin ju
23 e keni përmendur këtu?"

24 "PË. Po.

25 "PY. Nga e mësuat ju që ekzistonte një plan operacionesh

1 të shtabit asokohe?

2 "PË. Në bazë të informacionit që e kam marrë nga
3 komandanti Qamil Ilazi.

4 "PY. Pra, e kam kuptuar saktë se Shtabi i Përgjithshëm
5 përgatiti një plan operacionesh dhe ia ka komunikuar Qamil
6 Ilazit apo dikujt tjetër që ia ka komunikuar atij dhe pastaj
7 ai jua ka komunikuar juve?

8 "PË. Po.

9 Kaq. Kaq doja të lexoja. Pyetja që kam për ju është: Nëse
10 ky informacion që ju keni dhënë është i saktë apo jo?

11 PË. Nuk më kujtohet.

12 PY. Pra, që të jem i qartë. Nuk ju kujtohet nëse informacioni
13 që keni dhënë në intervistën e 2020 është i saktë apo jo, apo
14 diçka tjetër?

15 PË. Nuk më kujtohet për shkak se nuk po më lejohet me dhanë
16 sqarimin. Më keni kufizu veç me thanë "po" e "jo". Nëse
17 dëshironi me thanë "po" e "jo", atëherë thoni çka po doni,
18 edhe... Se unë nuk muj me u përgjigj atë çka ju doni. Unë
19 vetëm përgjigjna çka di e çka nuk di. Çka kam pa, e çka kam
20 bo.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
22 edhe një herë, këtu jeni për t'iu përgjigjur pyetjes. Nëse
23 Prokurori do diçka tjetër që ta shtojmë si sqarim, ai do ta
24 kërkojë këtë sqarim, nëse nuk kërkon ai këtë sqarim, mbase e
25 kërkon Avokati i Mbrojtjes. Por ju e keni për detyrë që t'u

1 përgjigjeni pyetjes siç ju është bërë pyetja.

2 Pra, a është e saktë apo është e pasaktë kjo këtu?

3 DËSHMITARI: Nuk mundem me thanë as që është e saktë, as e
4 pasaktë pasi nuk po më lejohet me dhanë sqarimin.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka nevojë
6 për sqarim. Ka nevojë vetëm për një përgjigje.

7 DËSHMITARI: Atëherë, nuk është e saktë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
9 Pace.

10 Z. PACE: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, a mund t'i shpjegoni Gjykatësve se ç'pjesë e
12 kësaj që unë lexova tani nuk është e saktë?

13 PË. Nuk është e saktë ajo që po thirret pas përgatitjeve në,
14 që pashë, planin e operacioneve të Shtabit të Përgjithshëm. E
15 thashë edhe ma herët nuk kam pa asnjë plan të Shtabit të
16 Përgjithshëm. As nuk kam parë, as nuk ma ka komunikuar
17 komandanti i brigadës, Qamil Ilazi.

18 PY. Pra, Dëshmitar, ju sapo thatë se plani i Shtabit të
19 Përgjithshëm nuk ju është komunikuar nga komandanti i
20 brigadës. Por, siç më dëgjuat që lexova nga deklarata juaj e
21 mëparshme, kur ju kanë pyetur pyetjen:

22 "PY. Pra, e kam kuptuar saktë se Shtabi i Përgjithshëm
23 ka përgatitur një plan operacionesh dhe e ka komunikuar Qamil
24 Ilazit apo dikujt tjetër që ia ka komunikuar këtij, dhe pastaj
25 ky jua ka komunikuar juve?

1 Ju jeni përgjigjur:

2 "PË. Po."

3 A mund t'u shpjegoni Gjykatësve se pse në shkurt të vitit
4 2020 ju jeni përgjigjur "po", që Qamil Ilazi ka marrë
5 informacion për këtë plan nga Shtabi i Përgjithshëm dhe jua ka
6 komunikuar juve, ndërsa tani thoni që kjo nuk është e saktë?

7 PË. Po me siguri atëherë ose ka qenë një lëshim i imi ose ka
8 qenë një keqkuptim ndaj përkthimit, por kjo qëndron, atë çka e
9 thashë që nuk kam pa plan të Shtabit të Përgjithshëm.

10 PY. A ju kujtohet, Dëshmitar, në seancën përgatitore që iu
11 është dhënë mundësia për të shqyrtuar për të parë, pra,
12 deklaratat tuaja të mëparshme dhe ju është dhënë mundësia që
13 të bëni ndonjë sqarim ose korrigjim?

14 PË. Nuk e kam kuptuar drejt. Kam menduar, veç kam kuptuar që
15 duhet të bëhen vetëm ndonjë, ku nuk është kuptu, apo ndonjë
16 përmirësim teknik, kështu që nuk kam, nuk e kam kuptuar që muj
17 të bëj ndryshime edhe ma të përgjithshme.

18 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në këtë fazë
19 kërkoj që të pranohen faqet nga libri që i kam lexuar
20 dëshmitarit dhe janë faqet nga anglishtja 36669 deri në 36670,
21 dhe nga shqipja, 077088 deri në faqen në vijim që është faqja
22 9. Këto do t'i shtohen provës P01015.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Vërejmë kundërshtimin tonë për
24 pranimin e faqeve të këtij libri. Së pari, se nuk jepen sipas
25 rregullës 143(2)(c). Pra çdo gjë që nuk përputhet me atë që ka

1 thënë dëshmitari, por që është aty në libër, nuk mund të
2 përdoren. Dhe ky është, qëndrimi ynë juridik është që shkel
3 nenin 141(4)(a) [Sipas përkthimit] të Ligjit, nenin 6(1) të
4 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sa i takon
5 proceseve gjyqësore, prandaj edhe ne argumentojmë që nuk mund
6 të pranohen si të vërteta.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dëshiroj gjithashtu që ta bëj të
8 qartë, se ne nuk e kemi bërë deri tani, por për
9 procesverbalin, që kemi një kundërshtim të përhershëm dhe
10 parashtrimet përkatëse që janë bërë deri tashti ndiqen edhe
11 nga Mbrojtja e Veselit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe ne mbajmë të njëjtin qëndrim.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe Mbrojtja e Krasniqit mban të
15 njëjtin qëndrim.

16 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për të sqaruar
17 shkurtimisht nuk kemi dëgjuar asgjë nga Avokatët që do të
18 binte ndesh me vendimin e mëparshëm për këtë çështje, prandaj
19 ky kundërshtim duket se nuk është i bazuar.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, nëse mund
21 të përgjigjem. Siç mund ta keni kuptuar, ne po e ruajmë për
22 procesverbal, po i themi këto për procesverbal, që të jenë
23 edhe për, edhe në fazë apelimi. Kjo ka lidhje me përdorimin e
24 këtij libri.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Ka diçka tjetër? Keni mbaruar me pyetjet, Prokurori Pace?

2 Z. PACE: [Përkthim] Jo, asgjë tjetër për këtë çështje. Po
3 prisja për vendimin përkatës nga ana juaj për këto faqe.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të mbajmë
5 pezull këtë deri në fund.

6 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

7 Znj. Sekretare, nga i njëjti libër, ju lutem, me numër
8 036622 deri në 036837, në shqip është 077039 deri në 077258,
9 ju lutem. Në anglisht dua të kaloj në faqen 036727 [Sipas
10 përkthimit] deri në -- me faqen përkatëse në shqip. Të
11 shikojmë pjesën e sipërme të faqes, në dokumentin.

12 Faleminderit, znj. Sekretare.

13 PY. Dëshmitar, edhe një herë në ekran në të majtë është
14 anglishtja, në të djathtë shqipja, dy faqe -- kemi faqe nga
15 libri juaj pra, ishte libri "Lufta e UÇK-së në ZON" dhe dua të
16 flasim për dokumentin në pjesën e sipërme të faqes, që
17 Sekretarja po e zmadhon tani. Pra, në të majtë, është titulli
18 i faqes në anglisht, pastaj në të djathtë është në shqip.

19 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem.

20 PY. Të shikojmë që thuhet pra, shpjegimi se çfarë është ky
21 dokument. "Vendim nga SHP i UÇK-së për ndryshimin e nënzonave
22 në zonë operative", pra për shpalljen e nënzonave në zona
23 operative. Mund të shikojmë që ky dokument mban datën 19
24 nëntor 1998, Prishtinë. E thotë vetë dokumenti këtë.

25 E shihni këtë, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 PY. E shihni gjithashtu diku nga mesi i dokumentit fjalën

3 "Vendim", që siç më kanë shpjeguar do të thotë "vendim"?

4 PË. Po.

5 PY. Shohim dhe një vulë në fund të dokumentit, e njihni këtë

6 vulë?

7 PË. Vula. Po.

8 PY. Çfarë vule është kjo?

9 PË. Vula që po, në brendi ka shqiponjën, e ka UÇK, Ushtria
10 Çlirimtare e Kosovës, dhe kjo.

11 PY. Dëshmitar, ku e keni marrë këtë dokument?

12 PË. Këtë dokument pas luftës e kam marrë, në komandën e Zonës
13 6 të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

14 PY. Dëshmitar, me aq sa dini ju, ky dokument a është
15 autentik?

16 PË. E kam thanë edhe gjatë hetuesisë, në kohë lufte nuk e kam
17 pranuar këtë dokument. Sikurse të m'u kish afër në kohë lufte,
18 nuk e kisha pranuar, vetëm me nënshkrim, se për mu është e
19 pakuptueshme kush e ka nënshkruar. Derisa dokumenti nuk ka emër-
20 mbiemër, edhe nënshkrimin, për mu është i papranueshëm. Por as
21 në kohë lufte nuk e kam parë, vetëm pas lufte.

22 PY. Më thatë që e keni marrë këtë dokument nga komanda e
23 Njesisë 6 të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës. A keni ndonjë
24 arsye të besoni se dokumentet që mbante ajo komandë, apo ajo
25 njësi mund të kenë qenë dokumente të pavërteta?

1 PË. Nuk i kam hi një studimi në detal.

2 PY. Keni ndonjë arsye për të besuar se ky dokument që ju e
3 keni përfshirë në librin tuaj ka qenë i pavërtetë?

4 PË. Nuk kam ndonjë arsye, por megjithatë derisa nuk ka emër-
5 mbiemër, por ka vetëm nënshkrim, për mu nuk tregon shumë.

6 PY. Dëshmitar, a e lexoni dot tekstin në shqip, pra jeni në
7 gjendje ta lexoni tekstin në shqip që është aty te ky
8 dokumenti, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Mund të na thoni se çfarë thotë aty tek teksti, poshtë
11 fjalës "Vendim"?

12 PË. "Nënzonat Operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
13 shpallen zona operative".

14 PY. A jeni në gjendje që të lexoni sipër fjalës "Vendim" apo
15 nuk është e lexueshme qartë?

16 PË. Lart nuk po e shoh mirë.

17 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem ta mbajmë
18 versionin në të majtë të ekranit. Por në anën e djathtë, a
19 mundet që të nxirrni dokumentin SPOE00228818 deri në
20 SPOE00228818.

21 PY. Tani, Dëshmitar, a shihni që një dokument i ri shfaqet në
22 anën e djathtë në ekran, por kemi mbajtur të njëjtin dokument
23 në të majtë.

24 Këtë dokument që është në të djathtë të ekranit, a e
25 njihni?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 61

1 PË. Nuk e njoh, se nuk e kam parë. Edhe nuk po e shoh në fund
2 kush e ka lëshu këtë dokument. Derisa nuk e di se kush e ka
3 lëshu dokumentin, nuk ka mundësi me njoftë.

4 PY. Thjesht që t'i vendosim gjërat në perspektivë. Dokumenti
5 në të majtë është ai për të cilin e kemi folur, që është marrë
6 nga libri juaj. Ky në të djathtë është një dokument tjetër.
7 Këto dy dokumente, a do të pajtoheshit me mua që janë të
8 ngjashme?

9 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem tregoni dhe
10 pjesën e poshtme që të shikojmë.

11 DËSHMITARI: Duket se po.

12 Z. PACE: [Përkthim]

13 PY. Dhe, për shembull shohim fjalën "Vendim", në të dyja dhe
14 shohim që është e lexueshme. Teksti që lexuat ju pak më
15 përpara, për shembull, vendimi që nënzonat operative të
16 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës shpallen zona operative, apo
17 jo?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe ngjashëm, edhe vula për të cilën folëm përpara duket
20 se është e njëjtë, apo jo?

21 PË. Ashtu duket.

22 PY. Dhe të dy këto dokumente janë të nënshkruar, si majtas
23 dhe djathtas. A e njihni emrin dhe nënshkrimin?

24 PË. Emri nuk po ekziston. Nënshkrimin nuk e njoh.

25 PY. Dhe shihni majtas, se këto dokumentet përmendin vendin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 62

1 Prishtinë dhe datën 19 nëntor 1998.

2 PË. Po.

3 PY. Po të shohim pjesën e sipërme të dokumentit, mbi fjalën
4 "Vendim" --

5 Z. PACE: [Përkthim] Dhe, znj. Sekretare, ju lutem hiqeni
6 dokumentin në të majtë dhe në vend të kësaj nxirrni
7 dokumentin, pra përkthimin në anglisht të këtij materiali në
8 të djathtë që është SPOE00228818-ET.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
10 lexojeni dhe një herë numrin e provës elektronike.

11 Z. PACE: [Përkthim] Patjetër. SPOE00228818 deri në
12 SPOE00228818-ET.

13 PY. Dëshmitar, për të kuptuar se çfarë po ndodh. Është i
14 njëjti dokument në të djathtë, por në të majtë kam kërkuar që
15 të nxirret përkthimi në anglisht. Se ju pak më përpara thatë
16 që ju nuk e lexoni dot tekstin mbi fjalën "Vendim", dhe po e
17 lexoj unë tani. Thuhet:

18 "Shtabi i Përgjithshëm në mbledhjen e mbajtur më
19 12.11.1998, mbështetur në nevojën e riorganizimit,
20 ristrukturimit dhe ngritjes së komandimit, nxjerr këtë
21 vendim".

22 Dhe është fjala "Vendim".

23 Dëshmitar, keni dëgjuar ndonjëherë nga dikush lidhur me
24 këtë mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm të zhvilluar më 12
25 nëntor 1998 që ka çuar pastaj në marrjen e vendimit që kemi

1 përpara?

2 PË. Gjatë luftës asnjëherë nuk kam dëgjuar.

3 PY. Keni dëgjuar për këtë pas luftës?

4 PË. Mbas vitit, gjatë përgatitjes së librit kur
5 bashkëpunëtorët e mi m'i kanë afru dhe i kemi vendos në libër.

6 PY. Mund t'u thoni Gjykatësve se kush jua ka dhënë këtë
7 informacion për këtë mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm të
8 zhvilluar më 12 nëntor 1998?

9 PË. Pasi e kam pa këtë dokument, mbas, 10 vite pas luftës.

10 PY. Po, vazhdoni, mbasi e patë këtë dokument dhjetë vite mbas
11 luftës?

12 Mbase nuk e kuptuat pyetjen, Dëshmitar, po e përsëris
13 prapë. U thoni Gjykatësve nëse jua ka dhënë dikush këtë
14 informacion dhe kush ka qenë ai lidhur me mbledhjen e Shtabit
15 të Përgjithshëm të zhvilluar në nëntor, 12 nëntor 1998?

16 PË. Këtë informacion e kam pa në dokumentat në komandë të
17 Zonës 6 pas dhjetë vite.

18 PY. Dëshmitar, para pak çastesh ju pyeta nëse e keni dëgjuar
19 për këtë pas lufte, pra, për mbledhjen e Shtabit të
20 Përgjithshëm në nëntor 1998, dhe ju u përgjigjët që:

21 "Ndërkohë që po përgatitesha për librin, një prej
22 bashkëpunëtorëve ma ka dhënë këtë informacion dhe ky
23 informacion pasqyrohet në libër".

24 Dhe unë ju sqaroj që informacioni në fjalë është ky
25 dokument, apo dikush ju ka folur, ju ka thënë për këtë

1 mbledhje të zhvilluar nga Shtabi i Përgjithshëm në nëntor të
2 1998?

3 PË. Jo, askush nuk më ka thënë, por e kam parë këtë dokument.

4 PY. Kush janë këta bashkëpunëtorë për të cilët ju e kishit
5 fjalë kur iu përgjigjët pyetjes time pak më parë?

6 PË. Bashkëpunëtorët për librin janë recensentë të tjerë,
7 lektori, kryeredaktori e kështu me radhë. Fotografisti, të
8 gjithë me radhë.

9 PY. Redaktorët e librit jua kanë dhënë këtë dokument, pra
10 recensentët jua kanë dhënë këtë dokument, apo ju thanë për
11 mbledhjen e nëntorit të 1998?

12 PË. Gjithë ky ka qenë ekipi që më ka ndihmu me përgatit
13 librin.

14 PY. Pyetja ime është kjo: E ekipi jua, ai ekipi ua dha
15 dokumentin apo ndonjë informacion për takimin e nëntorit 1998,
16 pra është ekipi jua i bashkëpunëtorëve që jua dha këtë
17 informacion, apo dokumentin?

18 PË. Dokumentin.

19 PY. Konkretisht, kush ua dha dokumentin?

20 PË. Nuk më kujtohet tash, se kam qenë shefi i komandës së
21 Zonës 6 ku e kam pas, kam pas mundësi edhe të kam mbikëqyrjen
22 drejtpërdrejt aty.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kemi një problematikë me dy
24 versionet në gjuhën shqipe. Do ta diskutoj, por jo në prani të
25 dëshmitarit. Kam një problem në lidhje me versionet në shqip.

1 Duhet bërë një krahasim i dy dokumenteve. Po e them këtë për
2 procesverbal, nëse doni ta dëgjoni tani jam i gatshëm, mund ta
3 bëjmë në prani të dëshmitarit ose pa prani të dëshmitarit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse nuk
5 duhet të jetë i pranishëm dëshmitari...

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Mendoj që është mirë që të mos
7 orientojmë dëshmitarin.

8 Z. PACE: [Përkthim] Nëse bëhet fjalë për krahasimin e
9 dokumentit që është në libër dhe versionit autentik, kam diçka
10 që mund ta diskutojmë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull, mund ta diskutojmë më
12 vonë atëherë parashtrimin tim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
14 Pace.

15 Z. PACE: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, ju thatë që dokumenti që keni futur në libër e
17 keni marrë nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës, pra, nga TMK-ja?

18 PË. Në komandën e zonës 6 të TMK-së ku kam qenë shef i
19 shtabit në atë komandë.

20 PY. Faleminderit.

21 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës të
22 mbajmë dokumentin që është në të djathtë, por të nxjerrim
23 përbri dokumentin me 036767 deri në 036622, 066387 [Sipas
24 përkthimit]. Faleminderit.

25 PY. Dëshmitar, kemi një version nga libri juaj në të majtë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 66

1 dhe versionin që u dhashë unë në të djathtë. Pajtohemi që janë
2 dokumente të ngjashme. Por a pajtoheni që ka një dallim që tek
3 versioni tek libri juaj ka një shënim me shkrim dore diku në
4 mes të dokumentit, kështu?

5 PË. Po, ka.

6 PY. Me sa shoh unë është 01/89, dhe poshtë 08.10.01. A mund
7 të na shpjegoni çfarë është ky shënimi këtu?

8 PË. Edhe gjatë hetuesisë ju kam thanë që nuk e di, edhe sot
9 nuk e di.

10 PY. Faleminderit.

11 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që të
12 pranohet faqja e librit që përmban këtë dokument, që
13 diskutuam, që në anglisht mban numrin 036767, dhe në shqip
14 077187, si dhe versionin që i kemi treguar dëshmitarit që mban
15 numrin SPOE00228818 deri në SPOE00228818 dhe me përkthimin e
16 tyre në gjuhën angleze.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do ta bëj kundërshtimin. Ne
18 themi që nuk është i njëjti dokument, dhe unë mund t'ju
19 paraqes arsyet. Po të doni, në daç tani, në daç pa praninë e
20 dëshmitarit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
22 shoqërojeni dëshmitarin jashtë sallës.

23 Z. PACE: [Përkthim] Para se të dalë dëshmitari, a mund të
24 them diçka? Dhe do të them diçka që nuk do të ketë ndikim tek
25 dëshmitari.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, prisni
2 për një çast ju lutem.

3 Dëshmitar, duhet të dilni pak nga salla, për pak minuta.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
6 Pace. Donit të shpjegonit diçka fillimisht?

7 Z. PACE: [Përkthim] Po. Doja të thoja që fakti që mund të
8 ketë dallime mes këtyre dy versioneve, versionit origjinal dhe
9 atij që ka përfshirë dëshmitari nuk është arsye për
10 mospranueshmërinë e këtij dokumenti. Kështu që nuk shoh bazën
11 çfarë -- të këtij kundërshtimi. Unë mendoj që rëndësia është
12 pesha që do t'i vendoset këtij dokumentin nga ana e Trupit
13 Gjykues dhe nuk është problem pranueshmëria apo
14 mospranueshmëria e këtyre dokumenteve.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua ta them këtë sepse po thonë
16 kemi dallime në këto dokumente. Kemi parë dy ndryshime përveç
17 atyre që theksoi z. Pace. Lart majtas është një numër që është
18 /0189 [Sipas përkthimit]. Në të majtë nuk është e lexueshme,
19 por për ne s'është 108.

20 Dhe po të shikoni në fund fare vulën, vula nuk është
21 njësoj. Në të djathtë është gati në mes, dhe ajo në të majtë
22 vula është disi më lart. Vulat nuk janë në të njëjtin vend në
23 dokument.

24 Ne nuk e pranojmë -- ne nuk kemi kundërshtim për faqen në
25 të majtë, le të pranohet ajo për peshën e vet. Por nuk mund të

1 thoni që është i njëjti dokument. Ne këtë e kundërshtojmë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptojmë
3 kundërshtimin tuaj.

4 Z. Ellis.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe ne kundërshtojmë faqen në të
6 djathtë, që të pranohet kjo faqe si provë. Dëshmitari nuk e ka
7 vërtetuar këtë faqe. Thotë që s'e kam parë këtë dokument. Ai
8 thotë që s'ka parë emrin.

9 Dhe veç kësaj ne kemi të njëjtin kundërshtim sa i takon
10 kërkimeve që janë bërë në shtëpinë e z. Krasniqi.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
12 Pace.

13 Z. PACE: [Përkthim] Nuk ka asgjë këtu për pranueshmërinë.
14 Sa i takon pranueshmërisë së këtyre dokumenteve. Ne s'po themi
15 që janë identike këto dokumente. Është e qartë që nuk janë.
16 Dëshmitari na ka thënë nga e ka gjetur këtë dokument që e ka
17 përfshirë në librin e vet. Në pamje të parë dokumentet janë të
18 ngjashme.

19 Unë mund të them që ka dhe një dallim tjetër biles, është
20 edhe nënshkrimi në të dyja dokumentet nuk është njësoj. Ne nuk
21 po themi që janë dokumente identike. Është e qartë që nuk
22 janë, por kjo nuk ka pse të prekë çështjen e pranueshmërisë së
23 këtyre dokumenteve.

24 Sa i takon parashtrimeve të ekipit të Mbrojtjes Krasniqi
25 janë kundërshtuar parashtrimet tuaja më përpara kontrolleve të

1 sekuestrimit. Dhe ne mund t'ju japim informata të mëtutjeshme
2 lidhur me këtë nëse është e nevojshme.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
4 Materiali P07667 [Sipas përkthimit] SPOE00228818 deri në
5 SPOE00228818, pranohen. Kundërshtimi nuk cenon pranueshmërinë
6 e dokumenteve në pikëpamjen e Trupit Gjykses, por ka të bëjë
7 me çështje që nuk janë me rëndësi për ne.

8 Vazhdoni.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kam nevojë për një
10 sqarim. Përkthimi në gjuhën angleze i dokumentit 03667102 --
11 ju kërkoj ndjesë, edhe një herë, përkthimi në gjuhën angleze
12 me ERN 036767 është i vetmi dokument që duhet pranuar. Jo
13 versioni në shqip i librit.

14 Z. PACE: [Përkthim] Jo, të dy versionet. Edhe në
15 anglisht, edhe në shqip. Faqja në shqip është 0771787 [Sipas
16 përkthimit] dhe do të bashkëngjitet dokumentit të pranuar më
17 herët për ZPS-në.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqja në gjuhën shqipe
19 me ERN 077187 dhe përkthimi në gjuhën angleze me ERN 036767 do
20 t'i bashkëngjiten provës materiale P01015.

21 Dhe një dokument tjetër që mban numrin ERN SPOE00228818
22 deri në SPOE00228818 dhe përkthimi në gjuhën angleze do të
23 pranohen dhe të marrin numrin e provës materiale P01016.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
25 Pace.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 70

1 Më falni, të sjellim dëshmitarin fillimisht.

2 Ju lutem, sillni dëshmitarin.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal,
5 dokumenti që u pranua me numrin e provës materiale P01016
6 aktualisht e klasifikuar si konfidencial.

7 Z. PACE: [Përkthim] Mund të ndryshohet klasifikimi si
8 dokument publik.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
10 [Përkthim] Z. Pace, mund të vazhdoni.

11 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

12 Faqja, tek faqja në të majtë, do lutesha të shkonim në
13 fund. Edhe përbri të nxjerrim versionin në shqip të librit që
14 ka numrin 077039-077258, që tashmë është pranuar si provë
15 materiale. 77187, ju lutem.

16 PY. Dëshmitar, po shohim faqet që nga libri juaj që i kemi
17 parë dhe më përpara. I keni edhe në anglisht, edhe në shqip
18 këtu. Do shohim tani këto dy imazhet në fund të dokumentit.

19 Dhe këtu mund të shohim që këtu lexon:

20 "Urdhëresë e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së,
21 nënshkruar nga kolonel Bislir Zyrapi."

22 A mund t'i thoni Trupit Gjykes nga e keni marrë këtë
23 dokument, Dëshmitar?

24 PË. Pas lufte, këtë e kam marrë në komandën e Zonës 6 të TMK-
25 së.

1 PY. Dëshmitar, kur thoni e keni marrë nga komanda 6, e keni
2 fjalën për arkivën, në arkiv e keni marrë apo në ndonjë vend
3 tjetër?

4 PË. Në komandën e Zonës 6 ku ka qëndru një pjesë e
5 dokumentacionit të TMK-së.

6 PY. Faleminderit. Mund të lexoni ndonjë gjë në ekran apo jo?
7 Jeni në gjendje të lexoni?

8 PË. Jo, nuk po shihet mirë.

9 PY. Tek imazhi në të majtë, a pajtoheni me mua që shohim në
10 mes fjalën "Urdhëresë", ju kërkoj ndjesë për shqiptimin.
11 "Urdhëresë", e shihni? Me germa të mëdha.

12 PË. Po.

13 PY. A shihni paragrafët, duket sikur kanë numra, dhe unë në
14 të djathtë të imazhit shoh që ka deri në 10 paragrafë, ky
15 tekst ka deri në 10 paragrafë.

16 Z. PACE: [Përkthim] Shohim tek shqipja, përpiqemi të
17 shohim dhe tek anglishtja.

18 PY. Pra, pajtoheni me mua, Dëshmitar, që paragrafi i fundit
19 në këtë tekst duket të jetë paragrafi me numër 10, kështu?

20 PË. Nuk po shihet mirë.

21 PY. 8 dhe 9 e shihni?

22 PË. Po, po. Ama për afërsisht, jo qartë, nuk po shihet qartë.

23 PY. Faleminderit.

24 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretares të afrojë pak
25 vulën edhe nënshkrimin. Faleminderit.

1 PY. Dëshmitar, ju pyeta dhe më herët, dhe ju bëj të njëjtën
2 pyetje. A e njihni vulën që është në këtë dokument?

3 PË. Vula po shihet, me shqiponjën, me tri shkronjat e
4 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

5 PY. E shihni njësoj si mua emrin "Bislim Zyrapi" dikund mbi -
6 - nënshkrim?

7 PË. Po.

8 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretares të shkojmë në të
9 majtë të të njëjtit imazh. Këtu, po. Ju lutem, njësoj dhe me
10 shqipen.

11 PY. Dëshmitar, unë këtu shoh iniciale SV/VG. A e keni idenë
12 çfarë janë këto iniciale? SV/VG?

13 PË. Nuk e di.

14 Z. PACE: [Përkthim] Shohim faqen tjetër, lart majtas.
15 Faqja tjetër. Do të thoja imazhi tjetër.

16 I lutem Sekretares që të veprojë njësoj dhe me versionin
17 në gjuhën shqipe. Faleminderit.

18 PY. Dëshmitar, këtu në mes të faqes, lart, shihni këtë që
19 është me shkrim dore, duket si me shkrim dore, 01/94. Pastaj
20 është në shtyllë kjo, poshtë ka 08.10.01. E shihni?

21 PË. Po.

22 PY. Poshtë, djathtas, shohim fjalën "Komanda e Zonës
23 Operative", që është e shtypur. Dhe me shkrim dore është
24 shkruajtur një emër. E shihni?

25 PË. Po.

1 PY. A mund ta lexoni për ne fjalën që është me shkrim dore?

2 PË. Me u lexu, nuk u lexojka mirë.

3 PY. A pajtohesh me mua nëse unë them që këtu thuhet "Komanda
4 e Zonës Operative të Nerodimës"?

5 PË. Ka mundësi, edhe pse R-ja është nuk është shkru si R, por
6 është shkru si V, D-ja nuk është shkru, është shkru si T.

7 Kështu që nuk po shihet mirë. Por ka gjasa me qenë ashtu.

8 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës të
9 mbajmë versionin në anglisht në të majtë dhe përbri të
10 vendosni dokumentin SPOE00228807 deri në SPOE00228808. Po,
11 mund ta lini.

12 PY. Dëshmitar, fokusohuni tek ekrani. Imazhi në të majtë
13 është nga libri juaj dhe imazhi në të djathtë nuk është nga
14 libri juaj.

15 A pajtoheni me mua që këto dy dokumente duket të jenë të
16 ngjashme?

17 PË. Për me bo një krahasim, këtë në të majtë nuk po muj me
18 lexu, kështu që nuk muj me dhënë version përfundimtar.

19 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretares që të zmadhojë
20 faqen e parë në të majtë me aq sa të mundet, që të shohim
21 faqen e parë të plotë. Po. Të fokusohemi te kjo.

22 Ju lutem, bëni të njëjtën gjë për imazhin në të djathtë,
23 që të shohim dhe fillimin dhe fundin e faqes. Në rregull.

24 PY. Dëshmitar, a pajtoheni me mua që të paktën në pamje të
25 parë këto dy faqe duken të jenë të ngjashme?

1 PË. Ne, nuk muj me u pajtu për shkak se ka ndryshime njëra me
2 tjetrën, edhe nuk e marr atë përgjegjësi që ta konstatoj se
3 është e njëjta. Kurse nuk është, në bazë të pamjes, nuk është
4 i njëjti dokument.

5 PY. Po, Dëshmitar. Pajtohem me ju që nuk duken, nuk janë
6 identike. Por unë po ju pyes, a ju duken me sy të lirë të jenë
7 të ngjashme, jo identike, por të ngjashme?

8 PË. Të ngjashme muj me qenë, por nuk e kanë substancën apo
9 brumin, qysh me thanë, nuk e kanë dhe nuk muj me marrë
10 papërgjegjësinë me thanë që janë dokumenta të njëjta. Se kemi
11 të bëjmë me një proces shumë serioz.

12 PY. Kur thoni që në thelb jo, a mund të na shpjegoni çfarë
13 doni të thoni me këtë?

14 PË. Përderisa nuk po mundem me lexu këndeje edhe me krahasu
15 leximin e dyanshëm, atëherë nuk muj me thanë 100 për qind se
16 janë të ngjashme apo janë të njëjta.

17 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës që të
18 shkojmë tek faqja tjetër e këtij dokumenti në të djathtë. Edhe
19 te dokumenti në të majtë, po ashtu të fokusohemi tek faqja
20 tjetër. Faleminderit.

21 PY. Dëshmitar, e njëjta pyetje: A pajtoheni me mua që këto dy
22 faqe të dokumentit në të majtë nga libri juaj dhe në të
23 djathtë jo nga libri juaj duket të jenë të ngjashme?

24 PË. Krejt çka muj, çka mundem me thanë, për shkak të emrit
25 Bislime Zyrapi, dhe këtu emri Bislime, këtë, përndryshe tekstin

1 s'po muj me e krahasu. Se nuk po shihet.

2 PY. Të shohim ndonjë gjë që mund të lexohet. Ju u pajtuat me
3 mua më herët që te dokumenti i librit tuaj mund të shihni
4 numrin e paragrafëve. Të paktën patë 8 dhe 9. A e shihni që
5 dhe në këtë faqe tjetër fillon nga 6 deri te 10, si në të
6 majtë, si në të djathtë? Është numri i paragrafëve.

7 PË. Numrin 10 nuk po e shof, s'po kam mundësi me e pa askund
8 në këtë të majtën.

9 PY. Po numrat nga 6 te 9 i sheh?

10 PË. Numrin 9 shumë i -- shumë vështirë identifikohet që është
11 9.

12 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkojmë që të
13 pranohen këto faqe. Në fakt faqja e librit është pranuar
14 tashmë, sepse ishte pjesë e dokumentit që i treguam përpara,
15 por do të doja që të pranohej dhe versioni tjetër që nuk na ka
16 dhënë dëshmitari. Dhe që ka numrin SPOE00228807 deri në
17 SPOE00228808 dhe përkthimi në gjuhën angleze që përfundon me
18 ET në fund.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Kundërshtimi është njësoj si
20 kundërshtimi i mëparshëm për dokumentin tjetër. Por e theksoj
21 dhe më shumë këtë. Dëshmitari nuk ka bërë asnjë përpjekje për
22 ta autentikuar dokumentin në të djathtë.

23 T'i tregojë thjesht një dokument një dëshmitari që u
24 thotë s'e lexoj dot, dhe t'i kërkosh të spekulojë, është një
25 kundërshtim. Dhe kjo është baza që ne paraqesim për

1 kundërshtimin tonë.

2 Z. PACE: [Përkthim] A mund të kundërpërgjigjem
3 shkurtimisht? Sigurisht që ne jemi përpjekur të nxjerrim nga
4 dëshmitari elementë që ai mund të shohë, por dëshmitari ka
5 dhënë dëshmi për autenticitetin e dokumentit në të majtë sepse
6 është i përfshirë në librin e tij. Dhe sipas nesh dokumenti në
7 të djathtë është i ngjashëm dhe është marrë dikund tjetër.
8 Sigurisht që dëshmitari nuk mund të flasë për përmbajtjen e
9 dokumentit tjetër, por pikësëpari ne bëjmë mocion jогоjor që
10 ky është një dokument relevant dhe parashtrimet e Avokatit
11 lidhen me pranueshmërinë dhe jo me peshën që do t'i vendoset
12 në thelb këtë dokumenti.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po pse po
14 kërkoni të pranohet ky dokument? Ky dokument që s'mund ta
15 lexojë askush? Ne mund të lexojmë dokumentin në të djathtë,
16 por s'e krahasojmë dot me dokumentin në të majtë.

17 Z. PACE: [Përkthim] Ne mendojmë që në pamje të parë janë
18 dokumente të ngjashme. Të paktën numri i paragrafëve, mënyra
19 se si është shkruar. Dhe fjalë të caktuara që mund t'i
20 lexojmë. Dhe dëshmitari na ka thënë që e ka marrë këtë nga
21 TMK-ja. Ndërsa dokumenti tjetër e kemi marrë nga burime që unë
22 do ta jap më vonë, s'ka qenë nga TMK-ja. Dokumenti tjetër për
23 ne është një dokument i ngjashëm me atë në të majtë. Kjo është
24 relevanca dhe prandaj po kërkojmë që të pranohet. Sa i takon
25 përmbajtjes --

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
2 çaktivizuar]

3 Çfarë vlere provuese ka ky dokument?

4 Z. PACE: [Përkthim] Ai thotë që është një urdhër që është
5 nënshkruar nga Bislim Zyrapi, edhe e njëjta gjë është edhe në
6 dokumentin tjetër. Data është 18 dhjetor 1998. I referohet
7 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rregullores. Ka një
8 urdhëresë, urdhëresë të detajuar për zonat, dhe është
9 nënshkruar nga Shtabi -- shefi i SHP i UÇK-së, kolonel Bislim
10 Zyrapi.

11 Ne kërkojmë të pranohet sikurse janë pranuar në mënyrë të
12 ngjashme dokumenta të tillë përmes mocioneve jogojore.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do të doja, ju lutem, të nderuar
14 Gjykatës, sa i takon vlerës provuese, të diskutojmë pak më
15 tej. Si e tha z. Misetiç për dokumentin e fundit dhe z. Pace u
16 pajtua, dokumentat s'janë identikë. Edhe vulat nuk janë në të
17 njëjtin vend.

18 Duke marrë parasysh që ky duhet të paraqitet si një
19 urdhëresë, unë dua të di tani nga Prokuroria, cili nga këto
20 versione është autentike? Njëri do jetë origjinali, njëri
21 patjetër është origjinali, njëri është kopje. Prokuroria të na
22 thotë kush është dokumenti origjinal.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të shtoj dhe unë diçka. Sa i
24 takon pyetjes suaj, i nderuar Kryegjykatës, dhe vlerës
25 provuese, ne nuk jemi të qartë çfarë vlere provuese ka të kesh

1 dy versione të ngjashme të të njëjtit dokument dhe këto të
2 pranohen njësoj si prova.

3 Z. PACE: [Përkthim] Shkurtimisht.

4 Unë mund të bëj parashtrime edhe më të thelluara.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, mos i
6 bëj.

7 Z. PACE: [Përkthim] Vetëm për t'iu kundërpërgjigjur
8 ekipit të z. Veseli. Ne nuk po themi që janë identike, po
9 themi që janë dokumente të ngjashme. Një nga dokumentet që ka
10 thënë dhe dëshmitari, versioni në librin e tij ka një shënim
11 me shkrim dore që lexon "mund të jetë Nerodimë", ndërsa
12 versioni i Prokurorisë nuk e ka këtë shënim dore.

13 Por nëse shohim nënshkrimin, madje as nënshkrimi nuk
14 është në të njëjtin vend. Pra, nuk po themi që janë dokumente
15 identike. Ne po e paraqesim përmes këtij dëshmitari dhe jo
16 përmes mocioneve jogojore, se mund ta ndiqnim procedurën e
17 mocioneve jogojore, por këtë e thamë se dëshmitari mund të
18 japë një element shtesë të autenticitetit të një dokumenti të
19 ngjashëm.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
21 pranojmë dokumentin, por është shumë i vagullt. Ka një vlerë
22 shumë të vogël provuese. Dhe do të përcaktohet pesha e këtij
23 dokumenti më vonë, edhe ka të ngjarë që të mos marrë asnjë
24 peshë si dokument. Sidoqoftë, ne po e pranojmë. Është i
25 pranueshëm për qëllimet që ju parashtruat, por për qëllime

1 krahasimi është i dyshimtë.

2 Ju lutem, jepini numrin e provës.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me ERN
4 SPOE00228807 deri në SPOE00228808 dhe përkthimet në gjuhën
5 angleze pranohen dhe marrin numrin e provës materiale P01017.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. PACE: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, me sa keni ju dijeni, anëtarët e Shtabit të
9 Përgjithshëm të UÇK-së a kanë kryer ndonjëherë ndonjë vizitë
10 apo a kanë qenë të pranishëm ndonjëherë në zonën e
11 përgjegjësisë së Brigadës 162?

12 PË. Unë nuk kam pasur njohuri për këtë vizitë.

13 PY. Ju thatë "kjo vizitë", për kë vizitë e keni fjalën?

14 PË. Për pyetjen që e bëtë ju.

15 PY. Po e bëj ndryshe pyetjen. Dëshmitar, a mund t'i thoni
16 Trupit Gjykues nëse keni dëgjuar ndonjëherë që anëtarë të
17 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të kenë shkuar në zonën e
18 përgjegjësisë së Brigadës 162?

19 PË. Nuk kam dëgjuar asnjëherë.

20 PY. A ju kujtohet ta keni përmendur një vizitë të këtillë në
21 intervistën që keni dhënë për ZPS-në në shkurt të 2020?

22 PË. Edhe nëse e kam përmend, nuk besoj që e kam përmend, por
23 nëse e kam përmend, ka qenë një lëshim i imi. Përndryshe nuk
24 kam pasur njohuri për atë -- për asnjë vizitë.

25 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duke qenë se

1 duket se nuk i kujtohet dëshmitarit që e ka thënë këtë gjë, me
2 lejen tuaj dëshiroj që të kalojmë në deklaratën e mëparshme
3 074301-TR-ET Pjesa 2. Që është nga faqja 18 në anglisht. Në
4 shqip -- sa ta gjej, ju lutem. Në përkthimin në shqip është
5 faqja 20 [Sipas përkthimit].

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Për të sqaruar, është thjesht për
7 të rifreskuar kujtesën?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu duket.

9 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dëshmitari tha që
10 nuk i kujtohet ta ketë dhënë këtë informacion.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, kështu
12 thatë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë nuk kemi kundërshtim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
15 vazhdoni, z. Pace.

16 Z. PACE: [Përkthim] Po pres sa të shfaqen faqet në ekran.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, ju
18 rikujtoj se tani keni arritur katër orë e gjysmë, që është
19 koha që e kishit në dispozicion.

20 Z. PACE: [Përkthim] Po, besoj se kam pesë orë gjithsej.
21 Shpresoj ta përfundoj dhe në këtë gjysmë ore që ka mbetur. Por
22 mund t'ju kërkoj mbase leje për ta zgjatur pak më shumë për
23 shkak dhe të zgjatjeve.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund edhe mos
25 t'jua japim këtë leje, kështu që keni parasysh. Megjithatë

1 bëmë një gjysmë ore -- vetëm 10 minuta pushim ishte.

2 Z. PACE: [Përkthim] Po, por edhe mungesa e bashkëpunimit
3 nga dëshmitari më ka kushtuar shumë kohë.

4 PY. Dëshmitar, keni përpara jush intervistën që keni bërë me
5 ZPS-në në shkurt 2020. Do lexoj diçka prej saj dhe pastaj kam
6 ca pyetje.

7 "PY. Çfarë lloj vizitash ndodhnin në zonën e Brigadës
8 162? Kush vinte për vizitë?

9 "PË. Nuk mund të them sa ka pasur të tilla vizita, se
10 s'e kishim luksin me bë vizita asokohe. Asokohe po zhvillohej
11 konferenca e Rambujesë dhe udhëheqja ishte detyruar të kalonte
12 kufirin më këmbë në atë zonë.

13 "PY. Kur flisni për udhëheqje, për cilën e keni fjalën
14 këtu?

15 "PË. Ishte përgjegjësia e komandantit që merrej me këtë,
16 kështu që nuk mundem -- ka kaluar kaq shumë kohë, kështu që
17 s'di me thënë tani. Por të gjithë e dinin se kush ka kaluar
18 apo pjesë e delegacionit ka kaluar në atë zonë.

19 "PY. Po kush?

20 "PË. Ishte përgjegjësia e komandantit të brigadës që të
21 merrej me këtë. Asokohe thjesht më thanë përgatit një njësit i
22 cili do të kryente detyrën e shoqërimit. Dhe unë nuk kisha,
23 nuk, informacione të tjera. Nuk më ka informu njeri.

24 "PY. Por, për udhëheqjen, e keni fjalën për Shtabin e
25 Përgjithshëm të UÇK-së apo për dikënd tjetër?

1 "PË. Po dihet publikisht kush kanë qenë, kush kanë qenë
2 anëtarët e delegacionit të Rambujesë. Nuk mund t'i cek emrat
3 se mund të kem mësuar më vonë për këtë, a të kem lexuar,
4 kështu që nuk mund të them që asokohe e dija se kush ishte.
5 Mund ta kem mësuar më mbrapa se kush kanë qenë."

6 Dëshmitar, informacioni që keni dhënë në këtë pjesë që
7 sapo jua lexova, pra informacioni që ju keni thënë, është i
8 saktë apo jo?

9 PË. Është i saktë, se nuk, është shumë e vërtetë se nuk ka
10 qenë kompetencë e imja dhe nuk kam pas njohuri rreth lëvizjeve
11 në atë kohë.

12 PY. Po pjesa që unë ju lexova thoni se:

13 "Asokohe po zhvillohej Konferenca e Rambujesë. Dhe
14 udhëheqësia ishte detyruar që ta kalonte kufirin më këmbë në
15 atë zonë."

16 Pra është gjithashtu e vërtetë që udhëheqësia, anëtarët e
17 udhëheqjes, pra, ishin të detyruar që ta kalonin kufirin në
18 këmbë në atë zonë kur po ndodhte Konferenca e Rambujesë?

19 PË. Kjo ka mund me qenë një supozim i imi që në atë kohë nuk
20 e kam ditur. Por pas luftës, pas luftës kemi mësuar se
21 delegacionin kush e ka udhëheqë në Rambuje.

22 PY. Nuk po i përgjigjeni tamam pyetjes faktikisht, po mbase
23 do ta them ndryshe pyetjen. Gjatë luftës, ose mbas lufte, a
24 mësuar që anëtarë të UÇK-së të cilët morën pjesë në
25 Konferencën e Rambujesë, e kanë vizitu ose kanë kalu nëpër

1 zonën e përgjegjësisë së Brigadës 162?

2 PË. Saktë nuk e di.

3 PY. A dini ndonjë gjë që ka pasur anëtarë të UÇK-së që kanë
4 shkuar në Rambuje që kanë kaluar në zonën e përgjegjësisë së
5 Brigadës 162?

6 PË. Sa i përket Brigadës 162, nuk e di, se ka qenë kompetencë
7 e komandantit të brigadës Qamil Ilazi. Sa i përket udhëheqjes
8 së Konferencës në Rambuje, delegacionin e Kosovës krejt bota e
9 di që e ka udhëheqë Hashim Thaçi.

10 PY. Dhe me aq sa keni ju dijeni, Hashim Thaçi vetë e ka
11 vizitu ndonjëherë apo ka qenë i pranishëm ndonjëherë në zonën
12 e përgjegjësisë së Brigadës 162?

13 PË. Unë e kam thanë atëherë edhe prapë e them. Nuk kam
14 njohuri rreth vizitave të tilla.

15 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem nxirrni në
16 ekran librin që tani është, pra pjesë të saj, pjesë e provës
17 1015, pra 036622 deri në 036837 në anglisht. Dhe në shqip
18 077359 [Sipas përkthimit] deri në 077358 [Sipas përkthimit].
19 Në anglisht dëshiroj t'i kthehem faqes 036818, në shqip është
20 077238. Pra në anglisht 036818 dhe në shqip 077238 [Sipas
21 përkthimit]. Dëshiroj që të fokusohemi tek imazhi në mes
22 majtas.

23 PY. Dëshmitar, edhe një herë, këto janë faqe nga libri juaj
24 për të cilin keni diskutuar, për të cilin kemi folur goxha
25 sot. Dhe në lidhje me fotografinë dhe përshkrimin e

1 fotografisë të cilën po e zmadhon Sekretarja, do ta lexoj
2 përshkrimin në anglisht, thuhet:

3 "Shtëpia e Reshat Bunjakut, ku ka qëndruar delegacioni i
4 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së gjatë qëndrimit në Brigadën
5 162 'Agim Bajrami', në Biçec."

6 A është i saktë ky përshkrim, Dëshmitar?

7 PË. Po, ky është, ky shkrim është i saktë, por sipas, qysh e
8 ka, ma kanë dhanë fotografinë të tjerët. Në atë kohë nuk kam
9 pas njohuri unë për këtë shtëpi.

10 PY. Kush është ose kush janë këta të tjerë të cilët jua kanë
11 dhënë këtë fotografi dhe këtë informacion të cilin ju e keni
12 përshirë në përshkrimin e fotografisë? Ju lutem ia thoni
13 Gjykatësve.

14 PË. Tani unë nuk e di kush ma ka dhanë fotografinë. Edhe e
15 thashë edhe ma herët, edhe mund të mos me qenë kështu, pasi që
16 i kemi, librin, e thashë edhe ma herët, në sesionet e
17 mëparshme, se në libër edhe i kemi rritë gjërat. Ka mundësi që
18 nuk ka qëndru asnjë delegacion këtu mbasi vetë nuk e kam pa.
19 Edhe nuk kam pas njohuri gjatë luftës, nuk muj me konfirmu që
20 është e saktë.

21 PY. Dëshmitar, a mund t'u shpjegoni Gjykatësve përse, apo më
22 saktë, çfarë keni zbuluar në këto fotografi në libër kur
23 përshkruani që kjo është shtëpia ku ka qëndruar delegacioni i
24 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, çfarë, për çfarë qëllim
25 duhej bërë ky?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 85

1 PË. Po qëllimi ka qenë t'i rritet vlera librit. Por derisa
2 unë personalisht nuk e kam pa atë delegacion, as nuk kam pas
3 njohuri gjatë luftës për atë delegacion, sot nuk muj me
4 konfirmu që është e saktë.

5 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem në të
6 njëjtën, majtas, faqen 036807 dhe në të djathtë 077227.

7 PY. Dëshmitar, i njihni këto fotografi nga libri juaj?

8 PË. Sigurisht se po.

9 PY. Si i njihni, domethënë çfarë dini për këto?

10 PË. Këto fotografi janë marrë pas lufte.

11 PY. Nga i keni marrë?

12 PË. Nga incizimet që i kemi pas në komandën, në brigadë.

13 PY. Po të shohim përshkrimin e fotografisë sipër majtas,
14 shohim që thotë:

15 "Drejtori i Drejtorisë Politike të UÇK-së z. Hashim Thaçi
16 gjatë vizitës në komandën e Brigadës 162 'Agim Bajrami'".

17 E shihni, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. Duke qenë tani që e patë këtë, dëshironi të sqaroni që
20 është e saktë, është i saktë informacioni që i dhatë

21 Gjykatësve pak më përpara se nuk ishit informuar asnjëherë që
22 Hashim Thaçi ishte në zonën e përgjegjesisë së Brigadës 169
23 [Sipas përkthimit]?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet

1 kundërshtimi.

2 Z. PACE: [Përkthim]

3 PY. Keni nevojë t'jua përsëris pyetjen.

4 PË. Pyetjen edhe një herë, ju lutem.

5 PY. Patjetër. Pra, në përshkrimin e fotografisë, që është me
6 këtë fotografi, thuhet:

7 "Drejtori i Drejtorisë Politike të UÇK-së z. Hashim Thaçi
8 gjatë vizitës në komandën e Brigadës 162 'Agim Bajrami'".

9 Dhe pyetja që kam është, nëse dëshironi ta korrigjoni apo
10 ta sqaroni atë që jua thatë pak më përpara Gjykatësve, që ju
11 nuk kishit asnjë informacion që Hashim Thaçi kishte qenë
12 ndonjëherë në zonën e përgjegjësisë së Brigadës 162.

13 PË. Përsëri, e konfirmoj se nuk kam pas njohuri që
14 delegacioni i Shtabit të Përgjithshëm ka qëndru në brigadën
15 162. Këto fotografi janë mbas lufte, edhe nuk muj me thjesht
16 saktë me vërtetu se kjo fotografi është me një mal të Kosovës
17 dhe nuk po shkrun kurrkund se përveç i kemi zbukuru, i kemi
18 zmadhu, me ia dhanë vlerën, dhe e kemi qitë se në brigadën --
19 nuk do me thënë që ka qenë këtu. Derisa e thanë këta se vetë
20 nuk kanë pas njohuri rreth kësaj vizite, nuk i kam taku, as
21 nuk i -- derisa nuk i kam pa vetë, nuk muj me konfirmu që
22 është e saktë. Për libër, e kam thanë, se mo u bo edhe e
23 tepërt me e përsëritë, jam mundu me ia rritë vlerën dhe kemi
24 shti gjëra edhe të paqena apo gjëra që kemi dashtë me kanë.

25 PY. Dëshmitar, kur i futët këto fotografi në libër, dhe kur

1 keni përfshirë edhe këtë shpjegim, a kishit ndonjë dyshim që
2 ky informacion mund të ishte i pasaktë, pra kjo që thuhet në
3 këtë përshkrim të kësaj fotografie?

4 PË. Atëherë nuk jam lëshu në atë studim.

5 PY. Dëshmitar, përmendët më përpara që keni zbukuruar, keni
6 bërë zbukurime pjesë të librit tuaj, për arsyet tuaja, për
7 qëllime të caktuara. Mund t'u shpjegoni Gjykatësve, po
8 ç'qëllim do t'i shërbente shtimi i një shpjegimi këtu që
9 Hashim Thaçi, drejtor i Drejtorisë Politike të UÇK-së, Hashim
10 Thaçi pra, ishte për vizitë në komandën e Brigadës 162?

11 PË. Qëllimi im ka qenë se e gjithë, i gjithë opinionimi, e
12 gjithë bota, e në veçanti qytetarët e Kosovës e njohin Hashim
13 Thaçin si themelues të shtetit të Kosovës edhe si lexues i
14 deklaratës së pavarësisë së shtetit të Kosovës. Me këtë kemi
15 dashtë me ia rritë vlerën librit.

16 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës kërkoj që të
17 pranohen këto faqe nga ky libri, 036807 në anglisht dhe 077227
18 në shqip.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Ky është diskreditim i
20 dëshmisë së dëshmitarit përmes librit. Pikësëpari, Prokurori
21 nuk ka kërkuar leje në bazë të rregullës 143 për ta bërë një
22 gjë të tillë. Trupi Gjykues nuk e ka vendimmarrjen për të
23 lejuar që në mënyrë të njëanshme ta diskreditojë dëshmitarin e
24 vet dhe për këtë ne citojmë edhe një vendim nga Dhoma e Apelit
25 të TPNJ-së sa i takon Diskreditimit të Dëshmitarit nga Pala

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 88

1 Thirrëse, e 1 shkurtit 2008, paragrafi 2028 [Sipas
2 përkthimit]. Pra nuk mund të bëhet një gjë e tillë.

3 Prandaj edhe kjo është e papranueshme në bazë të
4 rregullës 143(2)(c).

5 Nuk mund të përdoret për vërtetësinë e çështjes së
6 përcaktuar dje për arsyet e shprehura më herët sot, që është,
7 sepse është në shkelje të nenit 21(4)(a) të ligjit për Dhomat
8 e Specializuara dhe neni 6(1) për të drejtën e procedurave në
9 kundërshtim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se edhe
11 Avokatët e tjerë kanë të njëjtin kundërshtim.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, kjo
15 provë që kërkohet të pranohet, pranohet në provat gjyqësore.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Versioni në anglisht me
17 numër 077227 dhe përkthimi në anglisht me numër ERN-je 036807,
18 pjesë nga libri 077039 deri në 077258, i shtohen provës
19 P01015. Me klasifikimin publik.

20 Nëse mund të sqaroj edhe klasifikimi për provën P01017,
21 që me numër SPOE është 00228807 deri në 08, dhe përkthimi në
22 anglisht, është i shënuar si konfidencial.

23 Z. PACE: [Përkthim] Mund të ndryshohet në publik.

24 Faleminderit.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Shoh nga transkripti që nuk e kam

1 cituar emrin e lëndës së Dhomës së Apelit të TPNJ-së. Është
2 Prokurori kundër Popovic, 1 shkurt 2008. Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

5 Znj. Sekretare, në të njëjtin libër mund të më kaloni
6 tashti veçse majtas në versionin anglisht 036806 dhe në atë
7 shqip 077226. Dëshiroj që të zmadhojmë dy fotografitë që janë
8 në fund të faqes.

9 PY. Dëshmitar, edhe një herë këto janë fotografi nga libri
10 juaj për të cilin kemi folur sot. Dëshiroj që të shihni në
11 veçanti këto dy fotografi që po zmadhon Sekretarja tani. Në të
12 djathtë ka këtë shpjegim:

13 "Qamil Ilazi, Vehbi Koraci, Ejup Runjeva, Hajrush Kurtaj,
14 Musa Zenuni dhe Azem Guri në shtëpinë e Ramadan Sallahut në
15 Biçec më 11 mars 1998."

16 Dëshmitar, personat që u përmendet emri këtu janë
17 pikërisht personat që janë në fotografi?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe vërej se versionin në anglisht thotë 03/11/1998.

20 Ndërsa në anglisht [Sipas përkthimit] siç duket është 11 mars
21 1998. A mund ta sqaroni se cila është data e saktë e kësaj
22 fotografie?

23 PË. Këtu po shkruan 11 mars 1998.

24 PY. Me sa ju kujtohet ju, e vërtetë është që vërtet kjo
25 fotografi është bërë më 11 mars 1998?

1 PË. Saktë nuk muj me konfirmu, po megjithatë pas betejës së 8
2 marsit në Ivajë që është zhvillu, jemi tërhekë dhe jemi
3 vendosë në këtë shtëpi. Kjo është e saktë.

4 PY. Dhe për të sqaruar, beteja e Ivajës është më 8 mars të
5 1999, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Keni shkuar në Biçec menjëherë mbas 8 marsit të 1999?

8 PË. Në mbrëmje, në orët e vona të mbrëmjes së 8 marsit jemi
9 tërhekë. Vetëm më kujtohet se një ditë për qeta dhe nuk jam i
10 sigurt rreth datës që mund me qenë saktë. Se vetëm një natë
11 aty kemi ndejtë, dhe prapë jam, jemi kthyer te kulla e
12 Hasanit.

13 PY. Pra, nëse e kam kuptuar saktë që ju vetë dhe disa ose të
14 gjithë personat në këtë fotografi ishin në Ivajë deri në 8
15 mars 1999 dhe pastaj në Biçec për një periudhë të shkurtër.
16 Pastaj kanë lëviz prej andej?

17 PË. Po. Periudha e shkurtër është vetëm një natë e një ditë.

18 PY. Dëshmitar, u thoni Gjykatësve se përgjegjësi e kujt ishte
19 për të disiplinuar ushtarët në Brigadën 162?

20 PË. Përgjegjësia e komandant të brigadës, Qamil Ilazit.

21 PY. Dhe gjatë kohës tuaj në Brigadën 162, me postet e
22 ndryshme që keni pasur aty, në vitin 1998 dhe 1999, keni
23 dëgjuar ndonjëherë për një ushtar të kësaj brigade që të jetë
24 ndëshkuar, në një mënyrë ose një tjetër për mënyrën se si mund
25 të kenë trajtu të tjerët?

1 PË. Asnjë rast nuk ka pas të tillë kur dihet se ushtarët e
2 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës iu kanë përgjigj vullnetarisht
3 dhe nuk ka pasë raste të tilla.

4 PY. A keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë ushtar që në ndonjë
5 brigadë apo batalion tjetër brenda zonës operative të
6 Nerodimës të jetë ndëshkuar ndonjëherë për mënyrën si mund të
7 kenë trajtuar ndonjëherë të tjerët?

8 PË. Nuk kam dëgjuar asnjëherë.

9 PY. Kemi folur për policinë ushtarake më herët. Pyetja që kam
10 është kjo, keni dëgjuar ndonjëherë në ndonjë rast që ndonjë
11 anëtar i policisë ushtarake të çfarëdolloj niveli brenda zonës
12 operative të Nerodimës, apo në brigadë, të jetë ndëshkuar në
13 ndonjë mënyrë për mënyrën se si mund të kenë trajtuar dikënd?

14 PË. Nuk kam dëgjuar asnjëherë.

15 PY. Ju pyeta për ndëshkimin. Tashti do ju pyes për hetime.
16 Keni dëgjuar ndonjëherë të jetë hetuar ndonjë ushtar apo
17 ndonjë anëtar i policisë ushtarake të çfarëdolloj nivel brenda
18 zonës operative të Nerodimës, të jetë hetuar për mënyrën se si
19 mund të kenë trajtuar dikënd?

20 PË. Nuk ka pas kësi raste asnjë.

21 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, në dokumentet që janë
22 në ekran dëshiroj të kaloj tani në faqen majtas 36740 dhe në
23 të djathtë 077160. Në shqip, po, kjo është. Nëse mund të
24 përqendrohemi te dy pamjet në fund të ekranit.

25 PY. Edhe një herë, kemi një dokument që e keni nxjerrë ju në

- 1 librin tuaj, Dëshmitar. E njihni -- sa ta zmadhoj. Pra, i
2 njihni këto dokumente që janë në ekran, pra këto dy
3 fotografitë që janë në pjesën e poshtme të faqes?
4 PË. Po, dokumentet e formacioneve policore, administrative,
5 të forcave okupatore serbe.
6 PY. Nga i keni marrë këto dokumente?
7 PË. Këto dokumente, e kam thanë edhe gjatë hetuesisë, i kam
8 marrë në stacionin e policisë të cilin stacion e kanë
9 kontrollu forcat policore serbe dhe administrata serbe në
10 Kaçanik, ditën e çlirimit të Kaçanikut.
11 PY. Dhe na rikujtoni dhe një herë sa ka qenë data kur i keni
12 marrë këto dokumente?
13 PË. Më 12 qershor -- 1999. Për shkak se Kaçanikun e kemi
14 çliruar më 11 qershor në orët e vona e pastaj herët në mëngjes
15 të 12 qershorit kemi vazhdu me kontrollimin e të gjitha
16 objekteve dhe për t'i kriju kushte që qytetarët e Kaçanikut të
17 kthehen dhe të mos rrezikohen nga pasojat nga minat apo gjëra
18 të tjera që i kanë vendos forcat dhe aparati shtetëror i
19 Serbisë.
20 PY. Ju kujtohet ose e keni parë vetë me sytë tuaj, pra, mund
21 të shikoni me sytë tuaj nëse këto dokumente përmbajnë edhe
22 emra shqiptarësh?
23 PË. Ka edhe nacionalitete, edhe shqiptarë, edhe nacionalitete
24 të ndryshme, por për këto dokumenta unë nuk jam kompetent se
25 janë dokumenta të forcave serbe dhe përgjigje më të saktë ta

1 kishin me dhanun, kishte me i dhanun, adresa dihet, Beogradi,
2 se vetë i ka formu, vetë i ka strukturu. Kështu që unë nuk kam
3 njohuri rreth këtyre ma shumë.

4 PY. Pra, po është e vërtetë që ju vetë i keni marrë këto
5 dokumenta, apo jo?

6 PË. Po, i kam gjet më 12 qershor kur kam hyrë në stacionin e
7 policisë mbasi janë tërheqë forcat e aparatit policor,
8 shtetëror, okupator, serb nga Kaçaniku.

9 PY. Përpara se të gjenit këto dokumente në vendin që thatë, a
10 kishit ndonjë informacion për shqiptarë të cilët ishin në
11 radhët e policisë serbe?

12 PË. Nuk kemi pas ne aq njohuri. Se nuk kemi pas mundësi edhe
13 t'i kemi se Serbia pas suprimimit të autonomisë së Kosovës e
14 ka ndalu edhe mjetet e informimit, edhe televizionin të vetin,
15 televizionin shqip të Prishtinës dhe të gjitha. Kështu që
16 mundësitë janë kanë shumë të kufizume me pas asi informata.

17 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, dua ta mbajmë
18 dokumentin në të majtë në ekran, ndërsa në të djathtë, ju
19 lutem, nxirrni SPOE0093211 deri SPOE0093212.

20 PY. Dëshmitar, edhe një herë në të majtë. Janë fotografi nga
21 libri juaj, por djathtas këtu kemi dokumentin që nuk është nga
22 libri juaj. Por a pajtoheni me mua që faqja në të djathtë të
23 ekranit tuaj duket e ngjashme me faqen e parë të fotografisë
24 që është në të majtë, pra që është nga libri juaj?

25 PË. Ashtu duket. Dokumenti i aparatit shtetëror serb,

1 okupues.

2 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, në dokumentin në të
3 djathtë, ju lutem, të kalojmë në faqen e dytë, 212.

4 PY. Dëshmitar, e njëjta pyetje. Do pajtoheshit me mua që kjo
5 duket e ngjashme me dokumentin në të majtë të ekranit, faqen e
6 dytë?

7 PË. Po, edhe e nënshkrum nga kryetari i komunës së Kaçanikut,
8 kryetari i forcave okupatore serbe.

9 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, dokumenti në të majtë
10 të ekranit tani dua të kalojmë në faqen 36706 [Sipas
11 përkthimit], ju lutem. Dhe në të djathtë versionin në anglisht
12 077039-077258, faqja 077123.

13 Të nderuar Gjykatës, vërej dhe orën. Mbase më duhen mbase
14 edhe dy minuta për këtë pikë. Dhe mbas pushimit maksimumi 15
15 minuta do më duhen, kështu që besoj është brenda afatit.
16 Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Do mbarojmë këtë pastaj
17 vazhdojmë pas pushimit.

18 Faleminderit znj. Sekretare. Po, në shqip është 077123,
19 ju lutem.

20 PY. Do të lexoj një copëz nga kjo faqe, Dëshmitar. Mund të më
21 ndiqni ose përkthimin me gojë, ose mund ta ndiqni në faqe. Për
22 kontekstin këtu, e keni fjalën për masakrën e Kotlinës të
23 marsit të 1999. Dhe thoni kështu që:

24 "Vlen të përmendet këtu se disa policë shqiptarë lokalë
25 morën pjesë në masakër. Dhe këtu përfshini në listën zyrtare

1 numrin 49 [Sipas përkthimit]. Ato janë udhëhequr, pra kanë
2 vepruar, nën udhëheqjen e kryetarit të asaj zone. Në listën
3 serbe përfshihen..."

4 Dhe pastaj, Dëshmitar, në libër listiten emrat përkatës
5 që janë edhe në faqen -- Kaçanik --

6 PËRKTHYESI: Shënimi i përkthyesit: Kërkon ndjesë, nuk i
7 dëgjoi të gjithë, nuk i kuptoi të gjithë emrat.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ajo që e kisha me shqetësim është
9 që faqja në anglisht përkatëse nuk është në ekran.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] As unë nuk e
11 gjeta.

12 Z. PACE: [Përkthim] Atëherë, mbase është më mirë që ta
13 bëjmë këtë pas pushimit të drekës..

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, kështu
15 është. Do të bëjmë tashti pushimin e drekës, do të rikthehemi
16 në orën 14.30.

17 Dëshmitar, do të bëjmë tani pushimin e drekës. Do t'ju
18 nxjerrim nga salla, do të kthehemi këtu mbas një ore e gjysmë.
19 Mos flisni me askënd për dëshminë tuaj jashtë kësaj salle
20 gjyqi. Do t'ju shoqërojë Asistentja e Sallës tani që t'ju
21 nxjerrë nga salla.

22 DËSHMITARI: E qartë.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Diçka për aspektin organizator.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 96

1 Konferenca për Ecurinë e Çështjes që kemi, kam një konflikt të
2 pashmangshëm, duhet të jem diku, kështu nuk është problemi në
3 vetvete sepse do jenë bashkëmbrojtësit e mi.

4 Nuk e di nëse mund të më, në momentin e duhur, mund të më
5 kushtoni një pesë minutësh për të shprehur disa qëndrime
6 qartë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

8 Dhe më rikujtoni se unë edhe mund të harroj.

9 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.05

10 --- Seanca rifillon në orën 14.30

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente, ju
12 lutem sillni dëshmitarin në sallë.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
15 Dëshmitar. Jemi gati që të vazhdojmë. Prokuroria ka ende disa
16 pyetje për ju.

17 Z. Pace, fjala është për ju.

18 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

19 PY. Dëshmitar, përpara pushimit, nëse ju kujtohet, po shihnim
20 dy fotografi të librit tuaj që ju i kishit shënuar që ishte
21 një listë e policisë lokale serbe në Kaçanik. Unë i lexova dhe
22 një fragment të librit tuaj, por meqë patëm pushimin do ta
23 lexoj edhe një herë.

24 Z. PACE: [Përkthim] Prandaj i lutem Sekretares së
25 Gjykatës të nxjerrë sërish në ekran dy dokumentet që pamë para

1 pushimit. Konkretisht bëhet fjalë për materialet me numër
2 03662 [Sipas përkthimit] dhe 063837 [sipas përkthimit]. Do të
3 fillojmë të lexojmë në faqen 036703 dhe më gjegjësisht do
4 filloj në dy rreshtat e fundit të kësaj faqe dhe do kalojmë në
5 faqen tjetër.

6 PY. E kisha fjalën për anglishten këtu, ndërsa për shqipen
7 ose ndiqe në ekran ose dëgjoni përkthimin me gojë. Po filloj
8 nga rreshti i tretë në faqe.

9 Dëshmitar, sikurse ju kujtova dhe më herët në këtë
10 fragment ju flisni për masakrën e 24 marsit 1999 dhe thoni si
11 në vijim:

12 "Ia vlen të ceket se disa policë shqiptarë serbë [Sipas
13 përkthimit] ishin pjesë e masakrës dhe të gjithë të tjerët në
14 komunën e Kaçanikut, po ashtu të përfshirë në listën zyrtare"
15 - shohim tek anglishtja "numër 41 e 98 në Kaçanik, e 29
16 dhjetorit 1998 të udhëhequr dhe të urdhëruar nga kryetari i
17 dhunshëm i komunës së Kaçanikut Ognjenović Radosllav. Në këtë
18 listë zyrtare serbe janë...".

19 Jua thashë edhe më herët, Dëshmitar, keni një listë me
20 emra. Unë po përmend vetëm disa syresh. Kemi Agim Idrizin,
21 Rrahim Elezin, Nezir Topojanin (Soponica), Rizah Kika (Gajre),
22 Sejfullah Mulaku (Ivaja), Isak Luta (Ivaja) përsëri dhe
23 Bashkim Loku në (Kotlinë).

24 Dhe më pas ju rendisni dhe persona të tjerë dhe po filloj
25 në paragrafin e dytë. Ju thoni si në vijim:

1 "Këta të gjorë me apo pa vetëdije ishin vënë në shërbim
2 të okupatorit e në dëm të popullit shqiptar".

3 Tani, Dëshmitar, pyetja ime është kjo: Çfarë informatash
4 kishe ti kur ke shkruar këtë. Këtë, pra, që personat emrat e
5 të cilëve ua lexova unë pak më herët kishin dëmtuar popullin
6 shqiptar? Mbi ç'informata e keni thënë këtë?

7 PË. U bazova në dokumentin zyrtar në dokumentat serbe të
8 forcave shtetërore dhe aparatit shtetëror okupues serb të
9 cilët i kanë angazhu në strukturat e veta. Më shumë nuk di për
10 të. Jam i vetëdijshëm se të gjitha forcat policore, ushtarake,
11 paramilitare, njësi lokale të cilat kanë qenë të organizuara
12 nga shteti, nga aparati shtetëror i Serbisë okupatore kanë bë
13 edhe masakrën e Kotlinës me 24 mars 1999. Atë ditë 27 qytetarë
14 të Kotlinës janë vra. Ajo çka duhet ta veçoj nga ata 22
15 qytetarë të Kotlinës janë masakru; janë zënë të gjallë nga
16 forcat shtetërore serbe; janë rrahur me mjete të rënda me
17 shkopinj deri në alivanosje dhe i kanë gjujt në dy puset që
18 kanë qenë puset mbi fshatin Kotlinë në Malin Shula. Dhe pastaj
19 i kanë minu të gjithë pjesa dërrmuese e tyre mund të kenë qenë
20 edhe të gjallë kur i kanë fut në puset në dy puset në Kotlinë
21 dhe i kanë minu. Pastaj këtë e kanë pa edhe ekipet e
22 Tribunalit të Hagës kur e kanë bë rivarrimin e tyre që asnjë
23 prej këtyre 22 qytetarëve të Kotlinës nuk ka mund trupi t'ju
24 nxirret komplet nga aty dy puse.

25 PY. Dëshmitar, në përgjigjen tuaj ju thatë që e keni bazuar

1 në dokumentet e forcave serbe dhe aparatit okupator serb. E
2 keni fjalën për dokumentin që pamë para pushimit apo kishit
3 fjalën për ndonjë dokument tjetër?

4 PË. Ai dokument që e pamë para pushimit.

5 PY. Dëshmitar, sa i takon këtij dokumenti, përpara pushimit
6 ju na thatë që e keni marrë në qershor të '99 këtë dokument,
7 kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Pra...

10 PË. Qershor '99.

11 PY. Pra, Dëshmitar, a mund t'i shpjegoni Trupit Gjykues si e
12 morët këtë dokument më 12 qershor të '99? Se ju po thoni që e
13 keni përdorur si bazë për të pretenduar që personat që
14 përmenda unë kanë qenë të përrshirë në masakrën e 24 marsit
15 1999.

16 PË. E përsëris prapë: Dokumentin e kam marrë ditën e
17 çlirimit, më 12 qershor 1999 në Kaçanik, në stacionin në cilin
18 kanë vepru forcat serbe. Dhe në atë dokument kanë figuru edhe
19 këta persona që i lexuat më herët. Kjo tregon, domethënë, që
20 të gjitha forcat e strukturave serbe qoftë ushtarake,
21 policore, paramilitare, lokale ato kanë marrë pjesë në këtë
22 masakër edhe në shumë masakra të tjera të Kaçanikut, por edhe
23 në Kosovë.

24 PY. A ju kujtohet që para pushimit, po ashtu thatë që përpara
25 se ta gjenit këtë dokument në qershor të '99 nuk kishit

1 informata për shqiptarë të përshirë në strukturat serbe. A ju
2 kujtohet që thatë diçka të tillë?

3 PË. Po. Derisa nuk e kam parë dokumentin edhe nuk e kam dit
4 se cilat, cilat forca kanë marrë pjesë në luftimet në Kaçanik.

5 PY. Të jemi të sigurt që u kuptuam. Personat që keni renditur
6 ju këtu, si persona të përfshirë në masakrën e Kaçanikut në
7 mars, ju në libër këtë pretendim e keni bërë bazuar në
8 dokumentin që keni gjetur në '99, kështu?

9 PË. E aparatit shtetëror serb.

10 PY. Atë që pamë para pushimit apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Dëshmitar, ne kemi informacione që personat që unë
13 përmenda, emrat që ua lexova dhe mund t'i përsëris, kanë qenë
14 të mbajtur të ndaluar në vende ku përshihet Bobi, Ivaja, Bicec
15 rreth marsit të '99. Keni ndonjë dijeni lidhur me këtë?

16 PË. Po s' nuk kam pas këtë dijeni. Asnjë informatë në këtë
17 drejtim.

18 PY. A keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë person të jetë
19 mbajtur i ndaluar apo të jetë hequr liria rreth zonave të
20 Bobit, Ivajës, Bicecit në rrethinat e këtyre vendeve në
21 periudhën e marsit '99 ose për afërsisht në këtë periudhë?

22 PË. Asnjëherë nuk kam dëgjuar edhe nuk ka pas raste të tilla.

23 PY. Që të jemi i qartë tamam, Dëshmitar, kur thoni nuk keni
24 dëgjuar ju nuk e keni dëgjuar gjatë luftës apo e keni fjalën
25 që s'keni dëgjuar as pas luftës?

1 PË. As gjatë luftës as pas luftës se nuk më ka interesu
2 thjesht për forcat serbe.

3 PY. S'jam i sigurt përse i përmende forcat serbe. Unë po ju
4 them, informacioni që kemi ne është ky, që personat që unë
5 përmenda janë mbajtur të ndaluar nga anëtarët e UÇK-së, që të
6 jemi të qartë për këtë.

7 PË. Unë këtë informacion nuk e kam ni asnjëherë dhe nuk e kam
8 pasur.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për ndërprerjen.
10 Dua të bëj një pyetje për relevancën tani. Lista që iu tregua
11 dëshmitarit është listë e autoriteteve serbe, forcat e
12 armatosura serbe. A kanë qenë me kombësi shqiptare apo jo nuk
13 ka rëndësi fare kjo. Ata ishin luftëtarë.

14 Unë tani dua të di pse po kërkon tashmë prova për
15 masakrat e pretenduara serbe që nuk lidhen në mënyrë të
16 drejtpërdrejtë me aktakuzën tonë. Dua të di ku, në ç'drejtim
17 po, në çfarë drejtimi po ndjek Prokurori.

18 Z. PACE: [Përkthim] Do kundërpërgjigjem. Emrat që lexova
19 unë me zë janë relevante për të gjithë ne në sallën e gjyqit.
20 Të paktën për ne disa prej këtyre emrave janë të rëndësishme
21 dhe kanë relevancën përkatëse.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

23 Z. PACE: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, emrat që unë lexova Agim Idrizi, Rrahim Elezi,
25 Nezir [Sipas përkthimit] Rizah Kiki, Sejfullah Mulaku, [Sipas

1 përkthimit] Bashkim Loku etj., ju po thoni që për këta emra
2 nuk keni dëgjuar asgjë; nuk keni dëgjuar që këtyre personave
3 t'iu jetë hequr liria apo të jenë mbajtur të ndaluar dhe këtë
4 s'e keni dëgjuar as pas luftës, asnjë s'keni dëgjuar diçka të
5 tillë?

6 PË. Asnjëherë nuk kam dëgjuar.

7 PY. Dëshmitar, keni ndonjë dijeni për anëtarët të UÇK-së që
8 janë gjykuar në Kosovë për krime lufte, pretendimet, lidhur me
9 pretendimet për krime lufte në vende ku përfshihej Bobi, Ivaja
10 në shkurt dhe mars të 2003?

11 PË. Nuk kam njohuri se nuk më ka interesu për proceset që i
12 ka zhvillu UNMIK-u se nuk iu kam besu asnjëherë.

13 PY. Po ama e dini që UNMIK-u ka pasur procese, ama e dini që
14 janë mbajtur procese gjyqësore nga ana e UNMIK-ut për anëtarët
15 e UÇK-së për krime në Bob dhe Ivajë apo jo?

16 PË. Nuk kam njohuri se nuk kam dashtë të merrem me ato punë.

17 PY. Dëshmitar, që të jemi të qartë, të paktën të jem unë i
18 qartë. Ju po thoni që ju nuk e dini fare që ka pasur gjyqe të
19 tilla; ju nuk e dini a janë mbajtur apo s'janë mbajtur fare
20 gjykime të tilla? Këtë po thoni?

21 PË. Nuk kam njohuri se nuk më ka interesu ato punë. Thashë,
22 proceset e montuara nga UNMIK-u nuk më kanë interesu
23 asnjëherë. Edhe nuk jam marrë me ato punë.

24 PY. E kemi fjalën, ju thatë për proceset e UNMIK-it, po
25 atëherë kur thoni procese të UNMIK-ut për cilat procese e keni

1 fjalën?

2 PË. Për gjithë...

3 PY. Të montuara, kur thoni të montuara, cilat janë këto
4 procese të montuara?

5 PË. Për të gjitha ato procese që edhe ju po i thoni që unë
6 nuk kam njohuri rreth tyre se s'kam dashtë me u marrë me to
7 edhe s'ka qenë kompetencë e imja me u marrë me to.

8 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj të
9 pranohet faqet që përdora me pyetjet e fundit. Nga libri bëhet
10 fjalë për faqet 036743 dhe 077123, si dhe 036740 dhe në shqip
11 077160. Këto janë faqet që kanë ato fotografitë që diskutuam
12 dhe listën e policisë serbe si dhe paragrafët që i lexova
13 dëshmitarit lidhur me sulmin e marsit të 99.

14 Po ashtu kërkojmë që të pranohet si provë versioni që
15 dëshmitari tha se është i ngjashëm me atë në librin e tij. Atë
16 që ai shpjegoi, ai e përshkroi si lista e policisë lokale
17 serbe dhe që përkatësisht ka numrin SPOE00093211. Kam dhe disa
18 pyetje dhe me pyetjet e fundit që kam mbyll edhe pyetjet e mia
19 për këtë dëshmitar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
21 çaktivizuar]

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime që të
23 pranohen si prova dokumentet nga libri, por kundërshtojmë
24 fragmentet që u lexuan, sepse mendojmë që s'ka relevancë, nuk
25 ka vlerë provuese. Këto janë thjesht opinionet që ka pasur ai

1 në 2012 kur ka shkruar këtë libër. Dëshmitari tha që s'ka
2 pasur dijeni fare çfarë ka ndodhur konkretisht për periudhën e
3 përshirë në aktakuzë. Pra, relevanca, vlera provuese edhe për
4 arsyet që kam artikuluar disa herë tashmë paradite. Unë,
5 mendojmë që Prokuroria nuk mund ta dorëzojë këtë materialin në
6 bazë të rregullës 143 dhe arsyet i kam parashtruar disa herë.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dua të them diçka edhe për
8 konsistencën e vendimeve dhe procedurave sa u takon përdorimit
9 të dokumenteve. Siç tha dhe Misetic nuk kam asnjë kundërshtim
10 që t'i tregojmë fotografi dëshmitarit apo të bëjmë pyetje në
11 lidhje me këto. Sepse sigurisht shërbejnë për t'i dhënë
12 kontekst.

13 Por ka qenë praktikë e kësaj Gjykate, e këtij Trupi
14 Gjykues deri kohët e fundit që kur një dëshmitari i bëjmë një
15 kundërpyetje dokumenti nuk pranohet si provë, dëshmitari jep
16 dëshminë dhe dëshmia e dëshmitarit në rastin tonë është
17 konsideruar si e mjaftueshme. Dhe Mbrojtja ka kërkuar disa
18 herë që të pranohet dokumente në këtë formë dhe na e kanë
19 thënë që jo, mbështetuni në transkript dhe tani kemi rastin z.
20 Pace i lexoj fragment dhe fragmenti që lexoi ishin komente të
21 dëshmitarit edhe ne nuk e kuptojmë tani pse në këtë raste u
22 lejoka që të pranohet dhe në rastin tonë nuk është lejuar.

23 Dhe në rastin tonë është thënë që prova është transkripti
24 për ju. Unë mendoj që rregulla duhet zbatohet njësoj për të
25 gjitha palët dhe të zbatohet në mënyrë konsistente.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E marrim
2 parasysh parashtrimin tuaj.

3 Z. Pace, a mund të na e thonë pak më ngadalë dhe me radhë
4 numrat dhe ju lutem bëni një pauzë pasi përfundoni me numra.

5 Z. PACE: [Përkthim] Po, fillojmë: 036703 deri në 036704
6 anglishtja; shqipja 077123.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
8 kundërshtime, ne jse kundërshtimet në fakt i dhatë ju, por kjo
9 do të pranohet. Vazhdoni me numrat.

10 Sekretare, vazhdoni me numrat.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqet me ERN 077123 në
12 shqip dhe përkthimi në gjuhën angleze me ERN 036703 deri në
13 036704 i bashkëngjitet provës materiale P0115 [Sipas
14 përkthimit] dhe klasifikimi është publik.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. PACE: [Përkthim] Faqja tjetër është në anglisht me
17 numër 036740, ndërsa në shqip 077160.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
19 çaktivizuar]

20 Cila provë materiale është kjo?

21 Z. PACE: [Përkthim] Këto janë faqe nga libri i
22 dëshmitarit. Ishin faqet që kishin ato fotografitë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Të dy këto materiale pranohen dhe marrin numrin e provës
25 materiale.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 106

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqet me ERN 077160 në
2 shqip dhe 036740 në anglisht i bashkëngjiten provës materiale
3 P01015.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. PACE: [Përkthim] Materiali i fundit që dua të paraqes,
6 të paktën për momentin është me numër SPOE00093211 deri në
7 00093212. Anglishtja përfundon me -ET në fund. Ky është
8 versioni i imazheve që dërguam nga libri, por është një
9 dokument i ndarë dhe që dëshmitari tha që është i ngjashëm me
10 versionin që ka ai të përfshirë në librin e tij.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
12 Edhe ky dokument pranohet.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me ERN
14 SPOE00093211 deri në SPOE00093212 dhe përkthimin në gjuhën
15 angleze pranohet dhe merr numrin e provës materiale P01018 dhe
16 është i klasifikuar aktualisht si konfidencial.

17 Z. PACE: [Përkthim] Mund të riklasifikohet si dokument
18 publik, faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
20 Riklasifikojeni si dokument publik.

21 Z. PACE: [Përkthim]
22 PY. Dhe shumë pak pyetje kam për ju.

23 Z. PACE: [Përkthim] Më pak se 5 minuta mbase.

24 PY. Dëshmitar, më përpara pamë një fotografi tuajën, nëse ju
25 kujtohet, a mund të na konfirmoni në qoftë se keni qenë në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 107

1 Brigadën - Më falni përkthyesi nuk e kuptoi emrin, mënyra si u
2 shqiptua.

3 Ky person ka qenë në Brigadën 162.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, e
5 kuptuat?

6 DËSHMITARI: Nuk e kam të qartë pyetjen edhe për të cilën
7 fotografi bëhet fjalë.

8 Z. PACE: [Përkthim] Do ta bëj më të thjeshtë.

9 PY. Është një person me emrin besojmë Ejup Runjeva pjesë e
10 Brigadës 162?

11 PË. Fotografinë nuk po e shoh.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
13 fotografi jo, jo. Ishte pyetje, ishte pyetje. Dëgjojeni,
14 dëgjojeni, dëgjoni dhe një herë pyetjen dhe pastaj përgjigjuni
15 ju lutem.

16 DËSHMITARI: I nderuar, më herët më tha se një fotografi.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E ndryshoi
18 pyetjen, e ndryshoi pyetjen për ta bërë më të thjeshtë.

19 Z. Pace, përsëriteni pyetjen.

20 Dëgjojeni pyetjen dhe një herë.

21 Z. PACE: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, Ejup Runjeva, a ka qenë anëtar i Brigadës 162?

23 PË. Po.

24 PY. A ju kujtohet çfarë roli ka pasur në këtë brigadë?

25 PË. Nuk më kujtohet dhe nuk ka qenë kompetencë e imja. Ka

- 1 qenë kompetencë e komandantit të brigadës, Qamil Ilazit.
- 2 PY. Po Bujar Tafilin a e njihni?
- 3 PË. E njoh si qytetar të Kaçanikut, por më shumë nuk e njoh.
- 4 PY. A keni dijeni nëse ka qenë anëtar i UÇK-së?
- 5 PË. Me siguri ka qenë, por gjatë luftës nuk kam pas rast që
- 6 ta shoh vetë.
- 7 PY. A ju kujtohet që keni dhënë informacione gjatë
- 8 intervistës me ZPS-në, e keni thënë që ka qenë pjesë e
- 9 njësitit të Xhabir Elezit?
- 10 PË. Ka mundësi që e kam thënë, por po e them se vetë gjatë
- 11 luftës nuk e kam parë.
- 12 PY. Me sa ju kujtohet, Bujar Tafili a ka qenë pjesë e
- 13 njësitit të Xhabir Elezit? A është kjo e saktë?
- 14 PË. Në bazë, në bazë të atij dokumenti figurojke se po, por
- 15 unë personalisht nuk e kam parë gjatë luftës.
- 16 PY. Po Enver Axhami a ka qenë anëtar i Brigadës 162?
- 17 PË. Po, ka qenë.
- 18 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje të nderuar
- 19 Gjykatës.
- 20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
- 21 çaktivizuar]
- 22 Përpara se të filloni z. Misetic, një çast.
- 23 Dua që të sqarojmë pak më shumë vendimin për këtë libër
- 24 që i është treguar dëshmitari 4576.
- 25 Trupi Gjykses konstaton se pjesët e librit që janë

1 shfaqur dëshmitarit nuk janë deklarata brenda përkufizimit të
2 nocionit që është pjesë e kuadrit të rregulloreve tona dhe nuk
3 janë marrë në kontekstin e hetimit penal apo procesit penal.
4 Përkufizimi është zbatuar në mënyrë konsistente nga Trupi
5 Gjykes si dhe nga dhomat e tjera gjykuese të të njëjtit
6 juridiksion apo juridiksioneve të tjera prej të cilave burojnë
7 edhe rregullat tone.

8 Pranimi i pjesëve të librit, rrjedhimisht rregullohet
9 sipas rregullës 138(1) sikurse dhe provat materiale të ofruara
10 nga ZPS-ja. Trupi Gjykes është i bindur se dokumentet janë
11 relevante, *prima facie* autentike dhe kanë vlerë të qartë
12 provuese.

13 Duke marrë parasysh që Mbrojtja ka pasur mundësi të plotë
14 dhe të drejtë të bëjë kundërpyetje për autorin e librit, Trupi
15 Gjykes është po ashtu i bindur se vlera provuese e këtyre
16 dokumenteve nuk cenohet nga apo nuk preket, nuk ka asnjë efekt
17 cenues.

18 Parashtrimet e tjera të paraqitura nga Mbrojtja, sa i
19 takon pranueshmërisë të përdorimit të këtij libri është diçka
20 që Trupi Gjykes ta diskutojë në momentin që do të bëjë
21 vlerësimin e pjesëve të caktuara. Trupi Gjykes thjesht bën me
22 dijeni se sugjerimi se Trupi Gjykes është i kufizuar në
23 përdorimin e rregullave është i papranueshëm dhe Trupi Gjykes
24 mund të mos mbështetet te këto dokumente për vërtetësinë e
25 përmbajtjes; mund të mos gjejë asnjë vlerë provuese edhe ka të

1 gjitha kompetencat për të marrë, për të bërë shqyrtimin
2 përkatës të dokumenteve.

3 Në veçanti urdhri me gojë që përdori Mbrojtja e z. Thaçi
4 në çështjen Karemera nuk është me vlerë në rastin tonë, sepse
5 bëhej fjalë për një deklaratë të mëparshme. Sa i takon TPNJ-
6 së, TPNJ-ja e ka kufizuar pranimin e deklaratave të mëparshme
7 inkonsistente për besueshmërinë e dëshmitarëve, por jo për
8 vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

9 Ky regjim i tillë është i dallueshëm dhe nuk përputhet me
10 rastin tonë, sepse në rastin tonë Trupi Gjykues është
11 mbështetur në rregullën 143(2) [Sipas përkthimit] edhe kjo
12 lidhet dhe me vendimin në Nsengiyumva mocioni për të pranuar
13 dokumentacione si prova materiale, paragrafi 6 dhe 7 i
14 shkurtit 2007 [sipas përkthimit].

15 Trupi Gjykues prandaj është i bindur se pjesë të librit
16 që janë shfaqur dhe diskutuar mund të merren parasysh si për
17 vërtetësinë e përmbajtjes por dhe për të vlerësuar
18 besueshmërinë e këtij dëshmitari edhe mbështetshmërinë e
19 dëshmisë së tij në këtë sallë gjyqi.

20 Tani mund të filloni me kundërpyetjet z. Misetiç.

21 Z. PACE: [Përkthim] A mund të them dy aspekte sa u takon
22 provave?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
24 çaktivizuar]

25 Z. PACE: [Përkthim] Së pari dua të them që kemi ende dy

1 faqe të librit që nuk janë pranuar nga ana juaj. Janë faqja
2 03669 [Sipas përkthimit] deri në 036670 në anglisht. Dhe në
3 shqip ishin 077088 deri në 077089. Janë, ju thatë që do të
4 merrni një vendim më vonë në lidhje me këto. Thjesht doja
5 t'jua vendosja në dukje.

6 Kam edhe një dokument tjetër që do të doja të pranohej,
7 ta paraqes për t'u pranuar.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Sa i takon kësaj pike.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
10 çaktivizuar]

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Po shihja dokumentin 3669 [Sipas
12 përkthimit]. Mbaj mend që u lexua pjesërisht ky dokument. Oh
13 më falni. E paskam unë faqen gabim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Atëherë dokumenti 03669 [Sipas përkthimit] deri në 033670
16 [Sipas përkthimit] pranohet.

17 Po, pra, këto janë dy faqe të, po materiali tjetër?

18 Z. PACE: [Përkthim] Këto janë dy faqet në anglisht dhe në
19 shqip përkthimi i këtyre është 077088 deri në 077089.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
21 çaktivizuar] I caktoni një numër.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqet në anglisht me
23 ERN 077088 deri në 077089 dhe përkthimi i tyre në anglisht me
24 numër ERN 036669 deri në 036670 do t'i shtohen provës
25 materiale me numër P001015.

1 Z. PACE: [Përkthim] Dhe i fundit material që kërkoj të
2 pranohet, të paktën deri tani për këtë dëshmitar, në bazë të
3 rregullës 143(2)(c) kërkojmë që të pranohen në provat
4 gjyqësore. Disa pjesë të deklaratës së tij të mëparshme që
5 është me numër 074301 që e kemi përdorur me të.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
7 çaktivizuar]

8 Z. PACE: [Përkthim] Patjetër. Pra, në bazë të rregullës
9 142(2)(c) kërkojmë që pranohet në prova gjyqësore disa pjesë
10 të deklaratës së mëparshme të dëshmitarit që fillon me numër
11 ERN 074301 dhe në këto rrethana kërkojmë vetëm që të pranohen
12 në bazë të rregullit ato pjesë të cilat ia lexuam dëshmitarit
13 gjatë pyetjeve kryesore që i bëmë dhe mund t'i dërgojmë këto
14 pjesë me postë elektronike apo sipas mënyrës që e mendojnë të
15 përshtatshme Gjykatësit.

16 Dhe nëse është e nevojshme citojmë dhe autoritetin për
17 këtë procedurë, mes të tjerash dhe vendimet e këtij Trupi
18 Gjyqësor që mban numrin F01903 e datë 3 nëntor 2023.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
20 kundërshtim lidhur me këtë?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju mund të
23 dorëzoni dokumentet dhe mund të marrim vendim më vonë për
24 këtë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po është i njëjti kundërshtim

1 sipas çështjes Popovic. Ata nuk kërkuar leje. Mbase do duhet
2 të kishin kërkuar leje në bazë të rregullores dhe kam sqaruar
3 enkas këtë, sepse ai po kërkonte që t'i rifreskonte vëmendjen
4 dëshmitarit dhe jo për diskreditim të dëshmisë.

5 Z. PACE: [Përkthim] Po në një moment kur unë po
6 konfirmoja që doja të rifreskoja kujtesën, por në bazë të
7 përgjigjeve të dëshmitarit ai doli që kishte dhënë deklaratë
8 me mospërputhje. Prandaj dhe unë kërkoj që këto të dorëzohen,
9 pra, dhe të pranohen në provat gjyqësore.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse mundet.

11 Ky është pikërisht skenari që kanë marrë në shqyrtim
12 Dhomat e Apelit të TPNJ-së në rastin Popovic dhe ata janë
13 shprehur se duhet marrë leje për të bërë këtë veprim që kërkon
14 Prokuroria tani. Dhe sepse në bazë të asaj që kujton Prokurori
15 asnjëra palë, pra, nuk mundet në mënyrë të njëanshme të
16 diskreditojë dëshmitarin e vet pa marrë lejen e Trupit
17 Gjykues.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Mund t'i bëni pyetjet dëshmitarit të palës tjetër.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Vura re se z. Pace përdori fjalën
21 "materiali i fundit që kërkojmë të pranohet prova gjyqësore
22 për tani". Se nuk e di mbase ata kanë nevojë që apo kanë
23 ndërmend më saktë që të dorëzojmë materiale të tjera për t'u
24 përfshirë në provat gjyqësore.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë nuk, as

1 nuk s'e di se çfarë ka të qartë.

2 Z. PACE: [Përkthim] Po ne nuk kemi, nuk mund të
3 parashikojmë të ardhmen. Mund të dalë gjatë pyetjeve të tjera
4 diçka e cila mund të çojë në nevojën që ne të kërkojmë
5 pranimin e provave gjyqësore të ndonjë materiali.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Mund të vazhdoni z. Misetic.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Ma merr mendja që
9 Trupi Gjykses e lëshoi një urdhër mu përpara çastit kur unë do
10 filloja pyetjet e mia për një arsye të caktuar. Këto
11 kundërpjetje do të mbulojmë pyetjet dhe provat që ka paraqitur
12 Prokuroria. Pra, në përgjithësi do të trajtojmë dëshminë që ka
13 dhënë në sallën e gjyqit dëshmitari. Dhe do të ishim të
14 përgatitur për çdo dëshmi të pranuar sipas rregullores
15 143(2)(c).

16 Sa i takon asaj që mund të nënkuptojë Trupi Gjykses më
17 vonë në vetvete kjo nuk do të jetë objekti i kundërpjetjeve që
18 ne do të bëjmë se sigurisht të akuzuarit kanë të drejtën për
19 t'u informuar dhe nuk mund të spekulojnë, domethënë nuk mund
20 ta marrin me mend se çfarë mund të mendojnë më pas Trupi
21 Gjykses.

22 Besoj se mund të debatojmë më vonë për çështjet juridike
23 që unë kam ngritur sa i takon mundësisë së Trupit Gjykses për
24 të përdorur, për të gjetur të vërtetën çështje të cilat kanë
25 që nuk përputhen me provat e paraqitura nga Prokuroria. Kjo

1 edhe në bazë të nenit 6(1) të Konventës Evropiane, më
2 konkretisht siç citohen në jurisprudencë.

3 Në bazë të kësaj unë do të vijoj tani me pyetjet.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
5 vazhdoni.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Po desha të them që ne nuk pajtohemi
7 me atë që sapo ka thënë Avokati Mbrojtës dhe i kërkojmë Trupit
8 Gjygues që ta rikujtojë Avokatin se nëse ai ka pyetje për t'i
9 bërë këtij dëshmitari sipas lidhjes që kanë me çështjen, këtë
10 duhet ta bëjë pa vendosur asnjë kusht lidhur me këtë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
12 për komentet tuaja.

13 Mund të vazhdoni.

14 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç:

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Më quajnë Luka Misetiç, Avokat
17 Mbrojtës i z. Thaçi. Kam disa pyetje për t'jua bërë sot, por
18 edhe nesër. Dua të filloj me disa pyetje për të shkuarën tuaj.

19 Është e vërtetë që keni shërbyer në ushtrinë jugosllave
20 nga viti '86 deri në vitin '91?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe pas lufte nga shtatori i vitit '99 deri në janar të
23 vitit 2009 kishit gradën e kolonelit me në komandën e zonës 6,
24 kështu është?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe prej vitit 2009 keni punuar në Ministrinë e
2 Mbrojtjes, kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe aktualisht a vazhdoni të jeni në Departamentin
5 Planifikim-Vlerësimit në Ministrinë e Mbrojtjes?

6 PË. Po, aktualisht kryej këtë detyrë.

7 PY. A keni punuar vazhdimisht në Ministrinë e Mbrojtjes prej
8 vitit 2009 e deri tani?

9 PË. Prej vitit 2009 punoj aktualisht edhe vazhdoj edhe sot.

10 PY. A është e vërtetë që e keni marrë këtë post përmes një
11 procesi të prokurimit publik?

12 PË. Këtë pozitë e kam marrë përmes konkursit të hapur që kam
13 apliku në këtë detyrë edhe jam pranë pasi kam plotësuar të
14 gjitha kriteret për këtë punë.

15 PY. Dhe a është e vërtetë që eprorët tuaj nuk janë të
16 emëruar, pra, si poste politike, por janë dhe ata nëpunës
17 civil?

18 PË. E saktë.

19 PY. T'ju pyes tashti për përkatësinë tuaj politike. I keni
20 thënë ZPS-së se përpara se të anëtarësoheni në UÇK në vitin
21 '98 kishit qenë anëtar i LDK-së prej vitit '91, është e saktë?

22 PË. E saktë.

23 PY. Dhe është e vërtetë që e keni mbështetur Ibrahim Rugovën
24 jo vetëm gjatë periudhës përpara lufte '98, edhe pas vitit
25 '98?

- 1 PË. E vërtetë.
- 2 PY. Keni pasur ndonjëherë ndonjë reagim negativ nga ndonjë
3 anëtar i UÇK-së ndaj jush për shkak të mbështetjes që ju
4 kishit për Ibrahim Rugovën?
- 5 PË. Asnjëherë.
- 6 PY. Do të thoshit që kishte një bashkëpunim dhe bashkërendim
7 të rregullt midis përfaqësuesve të LDK-së dhe anëtarëve të
8 UÇK-së në zonën e Ferizajt?
- 9 PË. Të gjitha ka qenë, asnjë problem nuk ka qenë kjo drejtim.
- 10 PY. E dini kush është Fazli Hetemi?
- 11 PË. Fazli Hetemi, jo, nuk e njoh.
- 12 PY. Po Adem Salihu?
- 13 PË. Adem Salihu është vendas i imi, fshati im edhe fshati i
14 tij janë veç një rrugë i ndan.
- 15 PY. Keni bashkëpunuar me Adem Salihun gjatë konfliktit?
- 16 PË. Nuk kam pas rastin të bashkëpunoj për shkak se unë kam
17 qenë në Brigadën 162 në pjesën e Kaçanikut, kështu që nuk kam
18 pas rast as të takohena me të.
- 19 PY. Keni pasur ndonjëherë komunikim me korrierë me LDK-në në
20 Ferizaj gjatë konfliktit - avokati ka përdorur fjalën
21 Urusevac, duhet të jetë Ferizaj?
- 22 PË. Jo, asnjëherë nuk kam pas.
- 23 PY. Është e vërtetë që i keni dhënë fund anëtarësisë suaj në
24 LDK kur jeni kyçur në Forcat e Mbrojtjes së Kosovës, Trupat e
25 Mbrojtjes së Kosovës?

1 PË. Po. Po se nuk kemi pas kohë më të merremi me politikë. I
2 kom përkushtu kësaj detyre në Trupën e Mbrojtjes së Kosovës.

3 PY. A ju është lejuar që të keni përkatësi politike gjatë
4 kohës që keni qenë në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës?

5 PË. Nuk ka qenë me ligje të veçanta e ndaluar, por nuk ka
6 qenë e preferueshme që të merremi edhe me politikë edhe me
7 punën në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës.

8 PY. Kur keni hyrë në politikë pas vitit 2008?

9 PË. Përafërsisht 2015, po sa saktë nuk më kujtohet.

10 PY. Dëshiroj t'ju tregoj diçka që është me numër DHT03714
11 deri në DHT03716 në numrin DHT03715 që vazhdon edhe tek 16.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë më fund të
13 faqes ose jo, të kthehemi në faqen e mëparshme në mënyrë që ta
14 orientojmë dhe dëshmitarin. Dhe të zbresim pak më poshtë.

15 PY. Dëshmitar, e njihni këtë faqe të Facebook-ut?

16 PË. Po, e imja ka qenë kur kam qenë në kandidat për deputet
17 në parlamentin e Republikës së Kosovës.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutemi tani të kalojmë në faqen
19 tjetër. Nëse mund të kalojmë tani në fund të faqes. Po kjo
20 është pjesa e fundit.

21 PY. Ka një pjesë këtu që thotë:

22 "Përvoja në politikë:

23 "Partia Demokratike e Kosovës janar 2009 deri dhjetor
24 2015".

25 Partia Demokratike e Kosovës është PDK-ja apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe këtu thuhet nënkryetar i nëndegës PDK-së në Elezaj
3 nga qershori i 2012, e saktë?

4 PË. E saktë.

5 PY. Anëtar i Këshillit Drejtues të degës së PDK-së të
6 Kaçanikut qershor 2019 [sipas përkthimit]?

7 PË. E saktë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe nëse kalojmë në faqen tjetër.

9 Pika 3 nëse është e lexueshme. Nuk është e lexueshme këtu.

10 PY. Po pika 3 thoshte:

11 "Delegati i asamblesë së PDK-së qershor 2012".

12 Ishte e saktë kjo?

13 PË. 20...?

14 PY. 2012. 2012.

15 PË. E saktë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në fund të
17 dokumentit.

18 Pra, duket aty pak a shumë. "Delegat i asamblesë në PDK
19 në qershor 2012".

20 Dhe jeni kyçur në AAK më vonë apo jo?

21 PË. Më vonë.

22 PY. Faqja juaj në Facebook thotë se jeni kyçur në janar të
23 2016, do ishte e saktë kjo?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Është në faqen tjetër.

25 DËSHMITARI: E saktë.

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Pra, pyetja e parë që kam kjo është që në intervistën me
3 ZPS-së ju është bërë pyetje nga z. Pace, në Pjesën 1, në faqen
4 13, pra, juve ju është pyetur jeni përfshirë pastaj në
5 politikë pas janarit të vitit 2011 dhe jeni përgjigjur që jeni
6 kyçur në AAK që është partia e z. Haradinaj apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Por nuk e keni cekur që keni qenë edhe në partinë e z.
9 Thaçi, partinë PDK për nja afro pesë a gjashtë vjet, është
10 kështu?

11 PË. Ka mundësi që ka qenë një lëshim i imi, a përndryshe në
12 biografinë time ceket në mënyrë detale.

13 PY. Pra, në kohën që keni botuar librin në 2012 ishit anëtar
14 aktiv i partisë së z. Thaçi, e vërtetë?

15 PË. E vërtetë.

16 PY. Po kërkonit poste politike brenda partisë së z. Thaçi, do
17 të ishte e drejtë të thoshim kështu?

18 PË. Qëllimi im ishte që të marr detyra në parti.

19 PY. Kaçaniku, Kaçanik do ishit, do pajtoheshit me mua nëse do
20 thoshim që Kaçaniku është një bazë e fortë e partisë PDK?

21 PË. Pajtohena.

22 PY. Dëshmitar, të flasim për këtë libër. Ju thatë që ju janë
23 dashur shtatë a tetë vjet për ta përgatitur librin, kështu?

24 PË. Përafërsisht kështu.

25 PY. Dhe gjatë përgatitjes së librit jeni mbështetur në burime

1 të ndryshme, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe këtu përfshihen edhe e drejta për të marrë dokumente
4 nga arkivat, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Keni dëshmuar sot se shumë prej dokumenteve që i keni në
7 libër nuk i kishit parë asnjëherë gjatë kohës kur ju vetë
8 ishit në UÇK, kështu është e saktë?

9 PË. E saktë.

10 PY. Për shembull, gjatë intervistës me ZPS-në ju është bërë
11 pyetje për një dokument që pretendohet se e ka nxjerrë Shtabi
12 i Përgjithshëm, mirëpo ju nuk e keni, ju nuk keni parë asnjë
13 dokument të Shtabit të UÇK-së gjatë luftës?

14 PË. Në kohën e luftës, unë personalisht nuk i kam parë ato
15 dokumente.

16 PY. Pra, nuk jeni në gjendje të konfirmoni autenticitetin e
17 një dokumenti të tillë të Shtabit të Përgjithshëm përpos atyre
18 që ju i keni marrë si dokumente nga fundi i viteve 2000,
19 kështu?

20 PË. E saktë. Atë që nuk i kam pasur nuk mujt me i konfirmu që
21 i kam pasur derisa nuk i kam pa gjatë luftës.

22 PY. Sot ju treguan dokumente që pretendohet se ka hartuar
23 Bislim Zyrapi dhe ju thatë që këtë dokument nuk e keni parë
24 asnjëherë gjatë luftës, është e saktë kjo?

25 PË. E saktë.

1 PY. Nuk keni asnjë dijeni vetjake për autenticitetin e një
2 dokumenti të tillë, kështu?

3 Z. PACE: [Përkthim] A mundet të sqarojë avokati se ç'janë
4 "këto dokumente" në mënyrë që ta dimë, t'i përcaktojë?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Mirë. Ta them ndryshe.

6 PY. Gjatë luftës, a keni parë ndonjëherë gjatë luftës ndonjë
7 dokument që mund të thuhet se e ka hartuar Bislim Zyrapi?

8 PË. Nuk e kam parë.

9 PY. Pra, ndonjë dokument, pra, të gjitha dokumentet që janë
10 në librin tuaj dhe që pretendohet se janë hartuar nga Bislim
11 Zyrapi, ju vetë nuk keni dijeni sa i takon autenticitetit të
12 dokumentit në fjalë, kështu?

13 PË. Nuk kam dijeni.

14 PY. Kur keni marrë dokumente nga arkivat, keni bërë ndonjë
15 punë hulumtuese apo verifikuese sa i takon autenticitetit të
16 këtyre dokumenteve vetë ju?

17 PË. Unë kisha me thonë jo prej arkivave, por prej
18 administratës që kam pas qasje në administratën e komandës së
19 zonës 6. I kam parë por nuk jam lëshu në ndonjë studim të
20 veçantë për këto dokumente.

21 PY. Pra, nuk keni provuar asnjëherë që të intervistoni ndonjë
22 prej autorëve që pretendohet se kanë qenë autorët e këtyre
23 dokumenteve që pretendohet se janë dokumente që faktikisht
24 janë hartuar gjatë luftës, kështu është?

25 PË. Ashtu.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 123

1 PY. Dëshmitar, ju vetë keni dëshmuar këtu në sallë, kur iu
2 përgjigjët Prokurorit për dokumente që pretendohet se ju
3 emërojnë juve si komandant dhe dokumenti ka nënshkrimin tuaj.
4 Pra, është një dokument që pretendohet sikur ku ju emëroni
5 veten tuaj. Shikoj Prokurorin.

6 Z. PACE: [Përkthim] Kam një kundërshtim. Nuk më kujtohet
7 që dëshmitari të ketë thënë që ai e ka emëruar veten.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
9 kundërshtimi.

10 Mund t'i përgjigjeni pyetjes.

11 Z. MISETIC: [Përkthim]

12 PY. Është dokumenti i shkruar me dorë ku thuhej që "Në
13 përputhje me një urdhër të Agim Çekut" emërohet filan, pra,
14 emri juaj, emër mbiemër, por ndërkohë që e nënshkruani po ju
15 atë urdhër. Ju kujtohet për çfarë e kam fjalën?

16 PË. Po, atë shkrim e kam bërë unë, e kam rregullu, e kam
17 zbukuru ashtu qysh kam pas dëshirë. Përndryshe emërim edhe
18 urdhër të veçantë nga Agim Çeku nuk kam pas. Por kjo ka qenë e
19 kuptueshme që pas rënies së komandantit Qamil Ilazi në detyrë
20 ta vazhdoj detyrën unë.

21 PY. Pyetja që kam është kjo: Keni zbukuruar ju, kur ju keni
22 zbukuruar vetë dokumentet tuaja, nga mund ta dini ju që s'i ka
23 zbukuruar dhe të tjerët dokumentet e veta?

24 Z. PACE: [Përkthim] Kam një kundërshtim. Ky është një
25 spekulim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë e
2 mbështes këtë, këtë kundërshtim. Është shumë spekuluese. Do të
3 ishte përgjigje spekuluese. Bëni pyetjen ndryshe.

4 Z. MISETIC: [Përkthim]

5 PY. Dokumentet që ju keni botuar në librin tuaj, nga mund ta
6 dini ju që edhe ato nuk janë zbukuruar, rregulluar nga të
7 tjerët?

8 PË. Nuk kam ndonjë informatë rreth kësaj. Nuk e di.

9 PY. A është e mundshme që dokumentet e botuara në librin tuaj
10 të jenë po kështu zbukurime nga njerëz të tjerë?

11 PË. E ka mundësi; ka mundësi por nuk e di saktë.

12 PY. Se mund të thuhet, pra, që ju nuk e keni fare idenë se si
13 kanë përfundu këto dokumente në arkivat ku ju keni kërku?

14 PË. E saktë.

15 PY. Keni ndonjë dijeni ju vetë se si dokumentet e UÇK-së janë
16 mbledhur pas lufte edhe janë arkivuar pas lufte. Për shembull,
17 dokumentet tuaja, në qoftë se ju vetë kishit ndonjë dokument
18 gjatë lufte, çfarë procesi u ndoq mbas lufte, a erdhi dikush e
19 tha, ore ç'keni dokumente ju të luftës duhet t'i dorëzoni apo
20 u lihej në dorë njerëzve, ç'a të doni mund t'i dorëzoni?

21 PË. Nuk e di saktë për shkak se edhe nuk ka qenë kompetencë e
22 imja rreth arkivimit të dokumenteve të UÇK-së.

23 PY. Jo, pikës së pari, a kishit ju vetë ndonjë dokument që e
24 kishit krijuar gjatë lufte të cilën e vazhdonit ta kishit
25 menjëherë mbas lufte?

1 PË. Unë personalisht nuk kam pas ndonjë dokument formë të
2 urdhëresa apo plane. Ato çfarë i kam pas janë në libër.

3 PY. Mbase nuk e bëj unë të qartë pyetjen, po dua të sigurohem
4 që e kam kuptuar qartë. Gjatë luftës nga qershori '98 deri në
5 qershor '99, a keni marrë ju ndonjë dokument si
6 zëvendëskomandant dhe a keni lëshuar po ju vetë ndonjë
7 dokument si zëvendëskomandant apo si komandant në detyrë duke
8 filluar nga maji '99?

9 PË. Unë si zëvendëskomandant asnjë dokument nuk kam pranë,
10 por as vetë nuk kam lëshuar asnjë dokument se nuk ka qenë
11 kompetencë; dokumentet ka mujt me i lëshuar komandanti jo
12 zëvendëskomandanti. Kështu që unë nuk kam lëshuar ndonjë
13 dokument.

14 PY. Po komandanti a nuk do duhej të kishte lëshuar ndonjë
15 dokument me shkrim goftë edhe një të tillë gjatë vitit kur ju
16 ishit zëvendëskomandant, domethënë, komandanti t'jua lëshonte
17 juve?

18 PË. Nuk ka, nuk më kujtohet kjo pasi që edhe rrethanat e
19 luftës kanë qenë aq të vështira që nuk e kemi pas atë
20 komoditet që të lëshojmë, të përgatisim të lëshojmë urdhëresa,
21 dokumenta.

22 PY. Nëse ju kuptova saktë, nuk kishit asnjë dokument për t'i
23 dorëzuar ndonjë arkive pas konfliktit, kështu është?

24 PË. E saktë.

25 PY. Keni ndonjë dijeni pastaj nëse, jo ta them ndryshe. U

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 126

1 bëtë komandant në detyrë në maj. Patët, fjala vjen, dokument
2 të Qamil Ilazit si pasardhës i tij?

3 PË. Edhe një herë pyetjen ju lutem se?

4 PY. Ta them ndryshe. Ju i zutë vendin Qamil Ilazit si
5 komandant i Brigadës 162. Pra, si komandant në detyrë flasim.

6 PË. Po.

7 PY. Dhe si komandant në detyrë kur mori fund konflikti a
8 morët, a e kishit ju detyrën për arkivat, për arkivën e Qamil
9 Ilazit, duke qenë se i kishit zënë vendin atij?

10 PË. Nuk kam gjet asnjë dokument nga komandanti Qamil Ilazi,
11 përveçse mbas lufte e kam parë dokumentin që është lëshuar.
12 Mbase lufte e kam parë në komandën e zonës 6.

13 PY. Të bëj një pyetje tjetër. Po për Agim Bajramin, keni
14 gjetur ndonjë dokument si i treti në zinxhirin e komandimit që
15 ishit ju. Se ju ishit komandanti që i zutë vendin Qamil
16 Ilazit. Ai i kishte, i zuri vendin Agim Bajramit. Ju a gjetët
17 ndonjë dokument të lëshuar nga Agim Bajrami?

18 PË. Nuk kam gjet për shkak se ka qenë fillimi i luftës në
19 kohën e Agim Bajramit edhe nuk e kam gjet asnjë dokument. Edhe
20 vendi ku ka ra në Gabricë të Kaçanikut Agim Bajrami aty është
21 djeg edhe shtëpia edhe të gjitha ato pjesë për të cilat që ka
22 mundësi që janë djeg, edhe nëse ka pas janë djegë të gjitha
23 dokumentet me 10 gusht 1998.

24 PY. Nëse ka dokumente në arkivë të Brigadës 162 në bazë të
25 faktit që ju ishit komandant i fundit gjatë konfliktit, si

1 përfunduan këto në arkivën e UÇK-së? Domethënë, çfarë procesi
2 u ndoq për t'i futur këto në arkivën e UÇK-së?

3 PË. Nuk kam njohuri për këtë për shkak se më 12 qershor e kam
4 dorëzuar detyrën e komandantit dhe nuk kam njohuri pastaj qysh
5 ka vazhdu komandanti pas meje rreth kompletimit të
6 dokumentacionit.

7 PY. Të bëj një pyetje me bazë më të gjerë. A keni ndonjë
8 dijeni ju vetë ose nga përfshirja në luftë apo gjatë punës
9 përgatitore për librin më mbrapa, pas lufte, se si arkiva i
10 mbledhte dokumentet e luftë? Dini gjë?

11 PË. Një pjesë e dokumentacionit të UÇK-së ka qenë e sistemume
12 nëpër komanda të Trupave të Mbrojtjes të Kosovës, por më shumë
13 nuk di rreth atyne gjërave.

14 PY. Po ju thatë që, thoni për Trupat Mbrojtëse të Kosovës. E
15 keni fjalën për luftën, për periudhën mbas konfliktit, pra?

16 PË. Mbas luftës. Mbas shtatorit 1999.

17 PY. Jo, ajo që dua të di unë është se si dokumentet e UÇK-së,
18 pra, se si dokumentet e UÇK-së janë përfshirë në arkivën e
19 TMK-së?

20 PË. Nuk kam njohuri në këtë proces për shkak se më 12 qershor
21 e kam dorëzuar detyrën. Kështu që nuk kam njohuri saktë qysh ka
22 vazhdu ky proces.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetiç,
24 të njëjtën përgjigje po marrim vazhdimisht.

25 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Desha të bëj edhe një pyetje

1 tjetër.

2 PY. Po a ekziston ndonjë person që punon në këtë arkivë që i
3 cili do ta dinte se ç'proces është ndjekur, pra, për të futur
4 dokumentet e UÇK-së në arkivë. Pra, ajo që dua që të kuptoj
5 është kishte ndonjë proces të organizuar, në një mënyrë të
6 organizuar për mbledhjen e dokumenteve apo kushdo që kishte
7 qenë në UÇK mund të paraqitej në arkivë e të dorëzonte
8 dokumentet?

9 PË. Nuk kam njohuri që ka pas ndonjë proces të organizum.

10 PY. Në rregull. Vazhdojmë.

11 Ju thoni që jeni mbështetur dhe në libra të shkruar nga
12 anëtarë të UÇK-së kur keni përgatitur librin tuaj, kështu?

13 PË. Ka raste që jam mbështet edhe në libra; ka raste që jam
14 mbështet edhe në mjetet e informimit, nëpër orë akademi
15 përkujtimore e kështu me radhë.

16 PY. Ju përmendët mjetet e informimit. Do ju bëj një pyetje
17 dhe kjo lidhet me një përgjigje që keni dhënë ju sot.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe kjo është reflektuar në faqen
19 97 dhe, pra, 96, 97 të transkriptit.

20 PY. Në përgjigje të pyetjes së Prokurorit ju përmendët, vetë
21 ju përmendët TPNJ-në, që TPNJ-ja kishte kryer hetime dhe
22 kishte dalë me përfundime për masakrën e Kotlinës. Madje
23 përmendët edhe përfundimet e TPNJ-së sa i takon mënyrës si u
24 gjetën trupat nga ajo masakër. Ju kujtohet përgjigja që dhatë?

25 PË. Ka qenë një masakër që e thashë edhe më herët ku janë vra

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 129

1 nga fshati i Kotlinës 27 qytetarë të Kotlinës, në mesin e
2 atyre 22 janë masakru. Janë zënë të gjallë nga forcat e
3 okupatorit serb dhe janë rrah deri në alivanosje dhe janë
4 gjujt në dy bunarët ku pastaj i kanë minu dhe i kanë mbulu me
5 dhe. Për këtë edhe ekipet e Tribunalit të Hagës i kanë parë
6 kur i kanë nxjerrë që asnjë trup nuk e kanë nxjerrë të plotë.
7 PY. Në rregull. Por unë dua të di nga e dini ju këtë
8 përfundim të ish-Tribunalit të Hagës?

9 PË. Në bazë të mjeteve të informimit edhe kur ka ndodh
10 procesi i rivarrimit kam shku vetë, kam marrë pjesë aty.

11 PY. Në rregull. Pra, ju i keni ndjekur përfundimet e ish-
12 Tribunalit, por këto i keni ndjekur nga media apo jo, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. A e keni ndjekur dëshminë e Shukri Bujës në ish-
15 Tribunalin e Hagës dhe kjo është përcjellë në televizion në
16 Kosovë, e keni ndjek dhe ju?

17 PË. Po, e kam ndjekur, por ka kalu një kohë tashti s... se me
18 e ndjekë e kam ndjekë.

19 PY. Sa ndoqe nga dëshmia e tij? Sa, domethënë, çfarë pjesë të
20 dëshmisë së tij mund të kesh ndjekur?

21 PË. Nuk më kujtohet saktë.

22 PY. E përcolle të gjithën apo pak minuta? Për me për afërsi,
23 sa ndoqe?

24 PË. Nuk kam mundur me përcjellë, por atë çka më ka interesu
25 më së shumti, më ka interesu e kam përcjellë pjesën e masakrës

1 së Reçakut edhe masakrën e Kotlinës edhe masakra të tjera që
2 janë zhvillu në këto qytete.

3 PY. Në rregull. Do t'ju bëj disa pyetje për përmendjen e
4 Shukri Bujës në librin tuaj.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do kërkoja që të vendosen
6 në ekran materiali 03622, 036837, më falni, në anglisht dhe
7 077039 deri në 077258 në shqip. Faqja që më intereson është
8 faqja 036644 në anglisht dhe 077061 në shqip. Shkojmë te
9 poshtëshënimet.

10 PY. Tek poshtëshënimi 21, më falni, 17, poshtëshënimi 17 në
11 librin tuaj. Ju keni cituar një dorëshkrim të Gjeneral Major
12 Shukri Bujës e 23 majit 2007 me titull "Në kujtim të agimit të
13 lirisë". E shihni?

14 PË. Po.

15 PY. A kishit kopje të dorëshkrimit ju nga Shukri Buja kur e
16 shkruat librin tuaj?

17 PË. Nuk kam pasur kopje të dorëshkrimit. Thjesht ka qenë një
18 bisedë me Shukri Bujën edhe pastaj në libër e kam rregullu, e
19 kam zmadhu, e kam zbukuruar ashtu qysh kam pas dëshirë me
20 qenë. Në bazë të bisedës që kemi bisedu, bashkëbisedim.

21 PY. Do t'ju bëj disa pyetje të tjera në vijim të përgjigjes
22 suaj. Kur thoni që e keni zbukuruar, ju keni një titull në
23 dorëshkrimin tuaj, e keni me titull dorëshkrimin këtu "Në
24 kujtim të agimit të lirisë". A ekziston një dorëshkrim i tillë
25 në dijeninë tuaj, Shukri Buja a ka botuar ndonjëherë ndonjë

1 dorëshkrim me këtë titull?

2 PË. Jo, unë nuk kam njohuri për këtë shkrim.

3 PY. Pra, në dëshminë tuaj ju po thoni që ky poshtëshënim
4 është një zbulim, kështu keni thënë ju. Ju madje e keni
5 shpikur një dorëshkrim këtu dhe ia keni atribuuar këtë
6 dorëshkrim Shukri Bujës, kështu?

7 PË. Ashtu, kjo ka qenë vetëm një bisedë që kam pasur me
8 Shukri Bujën.

9 PY. E kuptoj unë këtë, por unë po përpiqem të kuptoj tjetër
10 gjë. Po na thua tani që ju keni përdorur si citim një dokument
11 që në të vërtetë s'ka ekzistuar kurrë? Kështu?

12 PË. Është e saktë kjo.

13 PY. Shohim referencën tjetër. Është në faqen e radhës 036645
14 dhe në anglisht dhe në shqip. Shohim poshtëshënimin numër 21.

15 Këtu keni përmendur një intervistë me Gjeneral Major
16 Shukri Bujën, e shihni? Është e njëjta datë dhe e dorëshkrimit
17 që kishit tek faqja pararendëse.

18 Tani pyetja ime është kjo: Pse ishte nevoja të shpikje
19 një dorëshkrim kur në të vërtetë ju mund të thoshit fare
20 thjesht që unë pata një intervistë në të njëjtën datë siç
21 kishit vendosur për dorëshkrimin. Pse mos të thoshit thjesht
22 një intervistë dhe shpikët një dorëshkrim?

23 PË. Thjesht ka qenë një lëshim nga ana ime, një lëshim
24 teknik, mund ta them, apo i rastit që në vend që ta them
25 intervistë qysh e kam thënë këtu, e kam thënë atje në

1 dorëshkrim, po në dorëshkrim. Ka qenë një lëshim i imi.
2 PY. Në rregull. Unë në fakt do ju pyesja këtë, pse keni
3 përfshirë dhe dorëshkrim dhe intervistë po në të njëjtën datë?
4 Ju po thoni tani që kjo ka ndodhur se s'ka pasur fare
5 dorëshkrim?

6 PË. S'ka pasur. Vetëm ka qenë intervistë, bashkëbisedim me
7 Shukri Bujën, po ka qenë kjo një lëshim i imi.

8 PY. Në rregull. Shohim bibliografinë. Shohim bibliografinë e
9 librit që është në faqen 036827 në anglisht dhe në faqen 770,
10 më falni 77248 [Sipas përkthimit] në shqip. Shkojmë te pjesa
11 C.

12 PY. Tek pjesa C, ju te bibliografia keni përfshirë një listë
13 të intervistave dhe kujtimeve që keni përdorur për librin
14 tuaj.

15 Shohim faqen 831 në anglisht dhe 252 në shqip, paragrafin
16 78 dhe 79. Në bibliografinë tuaj ju keni shënuar intervistat
17 që keni pasur dhe dorëshkrimet. E vetmja gjë që keni përmendur
18 dy herë është një dorëshkrim për Shukri Bujën.

19 Tani në qoftë se keni intervistuar Shukri Bujën në të
20 njëjtën ditë ka dhe dorëshkrimi, këtu në këtë listë pse nuk
21 keni përfshirë intervistën?

22 PË. E thashë edhe më herët, ky është një lëshim i imi,
23 lëshim, ta themi teknik apo i veç sigurisht se është lëshim i
24 imi. Se kjo ka qenë bashkëbisedim apo intervistë me Shukri
25 Bujën.

1 PY. Po unë po ju them, a ka mundësi që ju në fakt të jeni
2 mbështetur në një dorëshkrim të Shukri Bujës dhe në fakt nuk
3 keni pasur një intervistë e prandaj kjo intervistë nuk është e
4 pasqyruar në bibliografi?

5 PË. Jo, nuk ka mundësi që kam pas dorëshkrim tina.

6 PY. Në kohën kur u takuat apo biseduat apo çfarëdo ka ndodhur
7 më 23 maj të 2007 me Shukri Bujën, kjo ka qenë katër vjet pas
8 dëshmisë që e ka dhënë për Tribunalin e Hagës, më falni, tre
9 vjet pas dëshmisë së tij. E dini këtë?

10 PË. Nuk, nuk e kam analizu këtë.

11 PY. Ju keni thënë se libri është përgatitur dhe botuar në
12 kohën kur po përpiqeshit të merrnit pozita në PDK, të merrnit
13 ndonjë pozitë në PDK, kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe po përpiqeshit të ishit udhëheqës i PDK-së në Kaçanik
16 që ishte bastioni i PDK-së?

17 PË. Ky ka qenë qëllimi im.

18 PY. E keni thënë disa herë që keni bërë zbulime, por a
19 është e vërtetë që libri është bërë, ka qenë një formë për të,
20 për t'iu drejtuar elektoratit të PDK-së, për të tërhequr apo
21 jo [e pakuptueshme] elektoratin e PDK-së?

22 PË. Me njëfarë forme, po.

23 PY. Do t'ju bëj disa pyetje të tjera shpejt e shpejt. Në
24 kohën kur u botua libri, z. Thaçi jo vetëm që ishte udhëheqës
25 i PDK-së, por ishte kryeministër apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe ju e keni përmendur disa herë Hashim Thaçin në librin
3 tuaj apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Ju e përmendi ndonëse nuk keni qenë i pranishëm në asnjë
6 takim me z. Thaçi gjatë konfliktit, kështu?

7 PË. Ashtu është.

8 PY. Asnjëherë nuk e keni parë z. Thaçi, as keni dëgjuar gjë
9 për të gjatë konfliktit, kështu?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi një
11 problem me Gjykatësin Barthe? Kemi një shkëputje?

12 Gjykatësi Barthe, na dëgjon?

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, faleminderit, ju
14 dëgjojmë.

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Po e përsëris edhe një herë pyetjen. Pra, asnjëherë s'e
17 keni parë z. Thaçin as nuk keni dëgjuar gjë, nuk keni dëgjuar
18 gjë prej tij gjatë konfliktit, kështu?

19 PË. E kam thënë disa herë dhe prapë e përsëris: Gjatë luftës
20 nuk e kam takuar asnjëherë dhe asnjëherë nuk kam komunikuar.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, meqë z.
22 Emmerson kishte kërkuar disa minuta për parashtrimet e veta.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
24 çaktivizuar]

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

1 PY. Përmendja që i keni bërë në libër një urdhërese nga z.

2 Thaçi për shtrirjen e veprimtarive ushtarake, është e drejtë

3 të themi që ju personalisht nuk keni dijeni për një urdhëresë

4 të tillë, kështu?

5 PË. Ashtu është.

6 PY. Ju nuk keni qenë anëtar i UÇK-së në mars të '99,

7 '98 më falni, kështu?

8 PË. Nuk kam qenë.

9 PY. Ka disa fotografi që janë marrë nga incizimet e z. Thaçi

10 në librin tuaj, disa prej të cilave ua treguan sot, ju

11 kujtohet këto fotografi?

12 PË. Po, mbas lufte.

13 PY. A mund të themi që e vetmja fotografi ku duket qartë një

14 fytyrë është ajo, është fotografia ku është fytyra e z. Thaçi?

15 Z. PACE: [Përkthim] Më falni, unë s'e kuptova pyetjen.

16 Nuk e kuptuam këtë pyetje; nuk e kuptojmë çfarë kërkojnë nga

17 dëshmitari.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Të vetmen fotografi ku duket qartë

19 një fytyrë është Hashim Thaçi. Nejse po e le këtë pyetje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni

21 çaktivizuar]

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk është nevoja të shikojmë

23 librin. Do kaloj te një pyetje tjetër.

24 PY. A kishte ndonjë arsye politike pse vendosët të përfshinin

25 fotografitë e Hashim Thaçit në librin tuaj?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 136

1 PË. Pikërisht ishte arsyeja politike për ta bërë librin më të
2 lexueshëm, më të tuaj e dit që Hashim Thaçi ishte drejtuesi...

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na falni, na
4 falni, Dëshmitar. Ka defekt, ka problem tek transkripti.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Më bënë sabotazh.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetiç, ndërkohë që ju
7 kanë bërë këtë sabotazh, ju na dhatë një referencë pak më
8 herët. A mund të na jepni dhe datën, a mund të na jepni dhe
9 pak datën, sepse kemi frikë se mos në transkript ka dalë gabim
10 referenca, por nuk është nevoja që ta bëni tani këtë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si është puna
13 me transkriptin? Nuk punon.

14 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
15 këshillohen]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson,
17 a është nevoja për transkript për komentet që keni ju?

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Absolutisht jo.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Se mund ta
20 përfundojmë tani seancën dhe t'ju japim ju kohën që ju
21 nevojitet për të bërë parashtrimin tuaj.

22 Z. Misetiç, jeni ju dakord me këtë?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Faleminderit.

25 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës

1 këshillohen]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt sapo
3 na thanë që nuk mund të vazhdojmë pa transkript. Pushojmë për
4 pak. Presim që të rregullohet.

5 Mund ta shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës, Asistente e
6 sallës.

7 Dëshmitar, do shihemi nesër në orën 09.00.

8 DËSHMITARI: Në rregull.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë një
11 pushim të shkurtër sa t'i bëjmë një restart sistemit.

12 --- Seanca ndërpritet në orën 15.49

13 --- Seanca rifillon në orën 16.00

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se
15 t'ju jap fjalën, z. Emmerson, dua të them diçka lidhur me
16 procesin që kemi për sot. Dua që secili të përqendrohet në atë
17 që mund të bëjë ekipi juaj. Nuk më nevojitet, Emmerson, po e
18 përdor thjesht si shembull. Nuk duhet të na jepni mendje se
19 çfarë duhet të bëjë Prokuroria; dua të më thoni çfarë mund të
20 bëni ju, çfarë mund të bëjë ekipi i Thaçit. Këtë procedurë
21 duam të ndjekim, por po ju jap ide fillimisht si dua që të
22 jetë procesi për sot. Dua që të na jepni mendimin tuaj, si
23 mendoni ju që do të funksionojë për ju.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Shkurtimisht para kësaj. Z. Pace
25 donte të bënte një kërkesë për procesverbal përpara se të

1 fillonte Konferenca për Ecurinë e Çështjes Gjyqësore. Mund ta
2 bëjmë tani ose më vonë.

3 Është kërkesë për shtimin e numrit të fjalëve.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Bëhet fjalë për mocionin sipas
6 rregullës 155. Kërkojmë një shtim të numrit të fjalëve me 2
7 000 fjalë për shkak të numrit të dëshmitarëve që janë mbuluar.
8 Kjo është ndarë me Mbrojtjen dhe na kanë thënë që nuk kanë
9 asnjë kundërshtim.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim për
11 këtë për sa kohë ka një efekt reciprok për të gjitha palët.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shkurtimisht. Fillimisht
14 faleminderit që më dhatë një çast që të bëj parashtrimet e
15 mia, sepse më duhet të largohem. Edhe bashkëmbrojtësja ime
16 znj. Kerrie Rowan dhe znj. Annie O'Reilly do të trajtojnë
17 pjesë të tjera të rendit të ditës sipas radhës.

18 Po fillimisht doja t'ju thoja shkurtimisht për ekuilibrin
19 e apo balancën mes transparencës dhe procesit të shpejtë
20 gjyqësor. Këto janë çështje që Trupi Gjyqësor i ka renditur për
21 ditën e sotme dhe kam dhe një pyetje për kalendarin.

22 Së pari, klienti im më ka kërkuar që të them që nuk
23 dëshiron që procesi të sakrifikohet, pra, të mos trajtohen të
24 gjitha provat sa i takon përfshirjes së tij personale, vetëm
25 në kuadër për hir të shpejtësisë së procesit gjyqësor apo

1 transparencës. Duhet të trajtojnë të gjitha elementet që të
2 zbulohet çfarë ka thënë, çfarë ka bërë e çfarë nuk ka bërë.
3 Edhe kjo do që të jetë publike dhe ta dëgjoja gjithë publiku i
4 Kosovës.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për këtë
6 pajtohemi të gjithë. Ky është një koncept që pajtohemi të
7 gjithë.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pas kësaj i mbështesim të gjitha
9 përpjekjet që të kemi sa më shumë transparencë dhe seanca
10 publike, por e kuptojmë që procesi nuk ka qenë ideal në këtë
11 drejtim dhe nuk ka qenë shumë i shpejtë sa i takon redaktimit
12 të transkripteve në mënyrë që t'i jepet mundësia edhe publikut
13 që të na ndjekë. Kështu që çdo propozim që bëhet në këtë
14 drejtim është diçka që ne e mbështesim. Që t'ia komunikojmë
15 edhe publikut këtë që ndodh këtu në sallë gjyqi.

16 Sa i takon kalendarit që është propozuar ne jemi të
17 kënaqur me propozimin që keni bërë ju. Të paktën për
18 propozimin deri në fund të vitit. Ne do donim që të kishim
19 edhe më shumë seanca në fakt. Pikës së pari, fakti që ka
20 filluar gjykimi me vonesë, sepse u nxorën shumë vonë
21 materialet dhe gjatë gjithë procesit ne na u desh të trajtonim
22 materialet me vonesë që na ka kërkuar shumë ngarkesë.

23 Pika e dytë është që z. Thaçi dhe z. Veseli kanë humbur
24 anëtarë kryesorë të ekipit të Mbrojtjes së tyre. Z. Misetic do
25 të flasë vetë për situatën e vet për z. Thaçi, por ne humbën

1 fatkeqësisht z. Strong, që do të thotë humbëm përvojë, humbëm
2 njohuri në çështjen tonë gjyqësore që do të thotë është e
3 vështirë për ne që të ndryshohet kalendari që keni bërë ju për
4 momentin.

5 Mua më duket sikur ju keni ndjekur të njëjtin kalendar që
6 ndoqët në fillim të këtij gjykimi dhe do ju lutesha që sa më
7 shumë të ndjekim këtë ritëm.

8 Dhe së fundi ne e diskutuam çështjen e kohës dhe më
9 përpara qartazi. Nëse ka kufizime kohore për të gjithë, ne
10 duhet t'i kemi parasysh këto kufizime me përjashtim të rasteve
11 që ka ndonjë problematikë që del në një situatë që nuk e
12 parashikojmë dot. Nëse do të veprojmë në këtë mënyrë do doja
13 t'ju bëja dy kërkesa.

14 Së pari, të na keni parasysh kufizimet kohore. Nëse ka
15 dëshmitar, për shembull, që ne themi për këtë dëshmitar na
16 duhet një periudhë e konsiderueshme kohore ne do jua japim, do
17 jua bëjmë kërkesën në kohë ju për këtë.

18 Por gjithashtu e kuptojmë dhe nevojën për të rishikuar
19 ndonjëherë për llogaritjet kohore që kemi bërë, sepse
20 Prokuroria e ka informacionin për sa kohë i nevojitet me një
21 dëshmitar. Por për ne kjo është e vështirë, është vështirë të
22 bëjmë këtë parashikojmë. Për shembull, këta dëshmitarë
23 Prokuroria na tha që donte dy orë, por ama mënyra se si u
24 zhvillua kjo seancë lindi bëri që të lindte nevoja që ne të
25 shtojmë kohën që na nevojitet ne për të bërë pyetjet tona.

1 Kështu që do ju lutesha që përllogaritjet kohore t'i
2 bëjmë sipas rast pas rasti.

3 Sigurisht që duam të respektojmë të gjitha rregullat që
4 nxjerr Trupi Gjykues në mënyrë që të kemi një ekuilibër, por
5 ju thashë që në fillim kjo është në varësi të domosdoshmërisë
6 apo ne kemi prioritet që të trajtohen të gjitha provat ku
7 përfshihet z. Veseli. Ky është prioriteti. Të dalë e gjithë
8 historia; ta marrë vesh publiku të gjithë të vërtetën, publiku
9 i Kosovës, të gjykojë çfarë ka bërë e çfarë s'ka bërë z.
10 Veseli gjatë luftës për çlirim në vitin '98 dhe '99.

11 Këto ishin parashtrimet e mia.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
13 çaktivizuar]

14 Faleminderit, z. Emmerson për kontributin tuaj. E
15 kuptojmë që ju duhet të largoheni. Nuk ka asnjë problem.

16 Megjithatë, sa i takon datës, ditëve që kemi seanca
17 pajtohem edhe ne me ju, por po humbasim dhe shumë ditë. Plani
18 ynë ishte të kishim katër ditë radhë, për shembull, çdo javë.
19 Tre javë katër ditë, por humbasim gjithmonë, sepse ka
20 mirëmbajtje të sallës, bëhet mirëmbajtja e sallës së gjyqit.
21 Kjo është një pengesë, na bezdis kjo gjë. Dhe gjithmonë themi
22 si mund ta bëjmë më mirë punën dhe kjo është një nga gjërat që
23 do ta diskutojmë dhe ju nuk do jeni këtu kur ta diskutojmë,
24 por të jeni i sigurt që ne do ta diskutojmë dhe ju do ta
25 merrni mesazhin këtë nga, mesazhin nga ekipi juaj. Dhe të

1 përpiqemi të gjejmë një zgjidhje të arsyeshme me njësinë e
2 administrimit gjyqësor. Fatkeqësisht dhe ata duhet të kujdesen
3 për këtë godinë shumë miliona dollarëshe për mirëmbajtjen e
4 pajisjeve teknike. Prandaj kjo është një çështje e ndërlikuar.
5 Faleminderit. Faleminderit shumë.

6 Do të vazhdojmë.

7 [Trupi Gjyqësor dhe Juristi këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKËS SMITH: [Përkthim] [REDAKTUAR]

9 Një çast ju lutem në qoftë se mund të afroheni. Ajo çfarë
10 thamë edhe më herët është që ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm
11 për faktin që jemi të interesuar të dimë se çfarë mund të bëni
12 ju vetë dhe ekipet tuaja në mënyrë të tillë që t'i përgjigjeni
13 pyetjeve që kam parashtruar për sot. Një pjesë e tyre janë
14 pyetje të përgjithshme dhe këtë e kuptoj. Megjithatë, ajo
15 çfarë po them dhe një herë tjetër është që është e rëndësishme
16 se çfarë mund të bëni ju. Domethënë, nuk ka vlerë që të thonë
17 që çfarë mund të bëjë ekipi tjetër ose pala tjetër, por duhet
18 të thoni ju për veten tuaj, ekipin tuaj se çfarë duhet të
19 bëni.

20 Dhe dua që të shprehni dhe mendimet tuaja sa i takon
21 periudhës nga 1 shtatori deri në dhjetor të këtij viti.

22 Kështu që më lejoni t'ia jap fjalën Prokurorisë. Ju lutem
23 na thoni se si e shikoni kalendarin.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sigurisht që
25 mund të kaloni te pjesa e planifikimit. E kemi marrë

1 kalendarin. Diskutimi sa i takon planifikimit dhe ditëve të
2 planifikuara këtu është një diskutim shumë i rëndësishëm për
3 ne.

4 Ne propozojmë që të kemi tre javë pune dhe pastaj një
5 javë pushim. Dhe me ç'kuptoq unë, logjika e kalendarit deri
6 tani është që janë tre javë punë, dy javë, tre javë punë
7 pastaj një javë pushim, pastaj tre javë punë dhe dy javë
8 pushim.

9 Pra, nuk e di në qoftë se do të kishte, do të ekzistonte
10 mundësia, do të kishim fleksibilitetin që të shtohet një javë
11 tjetër, sepse mendoj që në qoftë se pushimet do të ishin më të
12 shkurtra do të kishim përdorim më efikas të sallës së gjyqit.

13 Sa i takon të premtëve posaçërisht, e kuptoj që në
14 përgjithësi të premtet nuk mund të përfshihen në kalendar që
15 është diçka që ne do ta preferonim në fakt. Megjithatë do
16 rekomandonim në qoftë se mund të përdoret e premtja në fund të
17 blloqeve në mënyrë të tillë që të dinim që në qoftë se do të
18 planifikonim diçka të kishim një ditë shtesë. Kjo do të na
19 bënte të mundur ne që të planifikonim më shumë dëshmitarë në
20 një bllok të caktuar.

21 Edhe nga ana tjetër do të na ndihmonte shumë neve dhe për
22 shembull, në qoftë se për një dëshmitar na duhej që të kalojmë
23 përtej orës 16.00, atëherë mund të përdorim të premtën në
24 mënyrë që të përfundojmë me atë dëshmitar përpara sesa ai të
25 largohet.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
2 keni ndonjë gjë për të thënë?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa për të plotësuar atë çfarë tha
4 z. Emmerson. Ne jemi të kënaqur me kalendarin që është
5 qarkulluar deri tani. Megjithatë, realiteti nga ekipet e
6 Mbrojtjes, në veçanti realiteti i kohëve të fundit është që
7 është e vështirë për ne që të përgatitemi për dëshmitarët e
8 radhës, për grupet e dëshmitarëve të radhës. Ne e përdorim
9 kohën që kemi të disponueshme jashtë sallës së gjyqit në
10 mënyrë të tillë që të përgatitemi për grupet e dëshmitarëve të
11 tjerë.

12 Kështu që planifikimi tre javë, një javë/dy javë, tre
13 javë/dy javë është një model i cili është i përshtatshëm për
14 neve, sepse na jep mundësinë që të përgatitemi dhe që të bëjmë
15 gjithë punën që kërkohet për dëshmitarët e tjerë. Atëherë
16 thjesht tani po flasim për kalendarin për planifikimin dhe
17 doja të bëja të qartë për procesverbal këtë gjë.

18 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Sikurse e tha edhe z. Emmerson,
19 ne nuk duam që të bëhet ndryshimi i kalendarit të marrë. Neve
20 po mundohemi që të kapim ritmin me provat. E di që është e
21 bezdisur që të dëgjohet kjo. Megjithatë, ky është realiteti.
22 Ne jemi ende në proces përgatitje, përgatitemi si ekip,
23 dëshmitar pas dëshmitari. Fakti që Prokuroria po e kryen, po i
24 paraqet provat e veta jo siç kishte planifikuar na krijon
25 probleme ne. Megjithatë, ne duhet që të vazhdojmë dhe të

1 punojmë në mënyrë të tillë që të sigurojmë respektimin e të
2 drejtave të klientit tonë në mënyrë që ta bëjmë siç duhet
3 punën.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

5 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar
6 përveç atyre që e thanë kolegët. Megjithatë, dua të them që të
7 premtet pas blloqeve të takimeve këtu, të seancave gjyqësore,
8 janë shumë të rëndësishme për neve, sepse në këto ditë ne
9 takohemi me klientët tanë. Në qoftë se në raste përjashtimore
10 Trupi Gjykses do të vlerësojë që të kemi seancë të premten
11 atëherë duhet që të kemi seancë vetëm të premten e fundit
12 përpara sesa të bëhet java pushim ose javët pushim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
14 për këtë. Kemi diskutuar edhe për eventualitetin e mundësisë
15 së kësaj që të ndodhë në të ardhmen gjithashtu.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne të nderuar Gjykatës këtë
17 pozicion kemi. Por në qoftë se na duhet, për shembull, vetëm
18 thjesht një orë të premten në mënyrë të tillë që të
19 përfundojmë me një dëshmitar të caktuar kjo është e
20 pranueshme. Por e premtja na duhet në mënyrë të tillë që mund
21 të vazhdojmë kontaktimet me klientët tanë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe ne na
23 duhet e premtja në mënyrë të tillë që të mund të shqyrtojmë
24 dokumentet që ju na dërgoni. Dhe të premtet janë të
25 rëndësishme për ne ashtu siç janë të rëndësishme edhe javët në

1 të cilët ne nuk kemi seancë këtu në sallën e gjyqit.

2 Kjo është diçka me të cilën merremi me të përditshmen
3 tonë. Megjithatë, unë dua që të trajtoj problemin e humbjes së
4 të enjteve, sepse humbim shumë të enjte për shkak të
5 mirëmbajtjes së gjykatës dhe nuk e di se si mund ta shmangim
6 këtë gjë. Kjo është një ndër gjërat që duhet që ta shqyrtojmë.
7 Ju kemi premtuar që do ta shqyrtojmë këtë çështje dhe
8 shpresojmë që të paktën të enjten t'i kemi.

9 Po ashtu kemi një situatë ku Trupi Gjykues numër II nuk
10 do të jetë, nuk do ta ketë do ta përdorë aq shumë sallën e
11 gjyqit sa që ishte planifikuar paraprakisht. Kështu që kemi
12 hapësirë më tepër në qoftë se do të na duhet që të shtojmë një
13 ditë ose që të përfundojmë me një dëshmitar të caktuar.
14 Domethënë mund të përdorim sallën e gjyqit. Atëherë, Avokati i
15 Viktimave.

16 Z. LAWS: [Përkthim] Përpara se ne të vazhdojmë më tej me
17 temën tjetër me rendin, në rendin e ditës dua që të mbështes
18 lëvizjen për të rritur numrin e ditëve në sallën e gjyqit dhe
19 javëve të punës. Ne e dëgjuam rëndësinë sa i takon aftësinë
20 dhe mundësinë e Trupit Gjykues në mënyrë të tillë që të
21 shqyrtojnë analizojnë numrin e madh të dosjeve që ekzistojnë.
22 Megjithatë, ka mangësi më të mëdhaja sesa mund të prisnim dhe
23 e mbështesim atë çfarë tha z. Halling lidhur me këtë.

24 Megjithatë, sa më shumë ditë të kemi seanca aq më shumë
25 dëshmitarë do të mund të thërrasim dhe aq më të lumtur do të

1 jenë viktimat e kësaj çështjeje gjyqësore. Dhe për këtë arsye
2 më lejoni të them që ka dhe shumë aspekte të tjera të cilat ne
3 dëshironim që t'i thonim në mënyrë të drejtpërdrejtë për
4 procesverbal dhe që janë aspekte të cilat kanë ndikim mbi
5 klientët tanë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Dhe për këtë arsye
6 do t'ju ftonim apo do t'ju parashtronim qëndrimin tonë që
7 dëshirojmë që Gjykata të bëjë sa më shumë seanca të jetë e
8 mundur.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
10 për kontributin.

11 Në qoftë se nuk ka komente të tjera të përgjithshme sa i
12 takon kalendarit të planifikuar do të vazhdojmë me pjesën
13 tjetër.

14 Pjesa tjetër ka të bëjë kryesisht me ZPS-në. Ka kaluar
15 thuajse gati një vit që nga koha kur kemi filluar këtë çështje
16 gjyqësore. Dhe kur filluam nuk e di në qoftë se keni qenë ju
17 z. Halling ose dikush tjetër nga Prokuroria, por ju thatë që
18 vlerësoni që do përfundoni marrjen në pyetje të dëshmitarëve
19 në prill të 2025. A është kjo një ditë, është kjo një datë që
20 planifikoni edhe sot e kësaj dite?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Në fakt kjo pjesë e rendit të
22 ditës ka shumë nënpjesë. A dëshironi që t'i marr nënpikat
23 njëra pas tjetrës apo t'i përgjigjem në mënyrë të përgjithshme
24 kësaj pike të agjendës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më mirë njëra

1 pas tjetrës me pika.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull. Ndoshta diku mund të
3 përgjigjem pak më gjatë dhe në një pikë tjetër që të
4 përgjigjem pak më shkurtër.

5 Sa i takon datës së përfundimit të paraqitjes së lëndës
6 nga Prokuroria do na duhet që ne të bëjmë më tepër harmonizim
7 dhe rakordim nga ana jonë dhe më tepër përshpejtim për sa i
8 takon proceseve gjyqësore.

9 Sa i takon datës që është përcaktuar në datë 15 shkurt
10 2023 ishte e nevojshme që të përcaktohej data e përfundimit të
11 çështjes së Prokurorisë. Pra, atëherë kishte shumë gjëra që
12 nuk diheshin ende dhe sigurisht që kjo e ka komplikuar
13 përcaktimin e kësaj date dhe ka pasur edhe zhvillime të tjera
14 të lidhura me këtë.

15 Më lejoni të bëj të qarta disa gjëra. Së pari, kur është
16 përcaktuar data e synuar prej jush të nderuar Gjykatës, ju e
17 keni planifikuar kalendarin ashtu siç ishte planifikuar
18 organizimi i seancave dhe përdorimi i kohës gjyqësore
19 mbështetur në kalendarin e asaj kohe. Dhe dua të citoj këtu
20 transkriptin:

21 "Planifikimi për sa i takon palëve dhe pjesëmarrësve
22 shkon në më tepër në pak më pak se 600 orë në vitin e parë të
23 gjykimit".

24 Megjithatë, në qoftë se do të shikojmë statistikat mund
25 të themi që gjatë dhjetë muajve të fundit orët që janë

1 përdorur këtu në sallën e gjyqit janë vetëm 308. Dhe
2 pavarësisht kontekstualizimit në fund ka pasur më pak orë në
3 dispozicion ZPS-ja në mënyrë të tillë që të mund të vazhdonte
4 me punën e saj. Kjo ishte pika e parë.

5 Pika e dytë që doja të nxjerrja në faqen fillim fare
6 ishte që momenti kur u përcaktua kjo si datë e synuar lidhej
7 me faktin që llogaritja u bë mbi bazën e vlerësimeve për
8 kundërpjetet e përkohshme të cilat u dhanë për 12 dëshmitarët
9 e parë nga ekipet e Mbrojtjes. Dhe besoj se e mbani mend se
10 cili ka qenë zhvillimi, cilat kanë qenë zhvillimet e mëpasshme
11 ku erdhi si rezultat një vendim, pastaj në mars të vitit 2023
12 ku Trupi Gjykses konstatoi se tre ekipe të Mbrojtjes nuk e
13 kishin përmbushur plotësisht atë çfarë ishte parashikuar në
14 urdhrin tuaj. Po ashtu ka pasur shumë diskutime të tjera të
15 lidhur me procedurën në vitin e parë të Trupit, të gjykimit që
16 kanë marrë shumë kohë të konsiderueshme.

17 Disa prej tyre kanë të bëjmë me procedurat e zbatueshme,
18 ndërsa disa prej tyre nuk kanë të bëjnë me të. Për shembull,
19 ka pasur një diskutim të kohëve të fundit për deklaratë të
20 dëshmitarit që janë bërë shumë herë më përpara në diskutime të
21 tilla.

22 Por kjo për të thënë që duke i marrë të gjitha së bashku
23 këto gjatë dhjetë muajve të parë të gjykimit ZPS-ja ka
24 përdorur 100 orë të marrjeve në pyetje kryesisht prej saj të
25 dëshmitarëve. Edhe një herë, neve mesatarisht kemi rreth 10

1 orë faktike, dy ditë seance në marrjen të drejtpërdrejtë të
2 pyetjeve të dëshmitarëve për mua dhe kjo nuk është parashikuar
3 siç duhet.

4 Pra mendoj që kjo duhet të merret parasysh sa i takon se
5 sa e qëndrueshme ose se sa e realizueshme është data e synuar
6 e përfundimit të paraqitjes së çështjes nga Prokuroria.

7 Dhe për përcaktimin e datës eventuale kur t'i bjerë
8 radha.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni fjalën
10 ju Gjykatësi Mettraux.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam disa pyetje lidhur me
12 ju.

13 Është një gjë që të japësh përgjigje lidhur me një koment
14 që u bë nga znj. O'Reilly, përkatësisht që në disa aspekte ju
15 nuk e keni ndjekur tamam paraqitjen e çështjes tuaj siç e
16 kishin parashikuar, domethënë, një dëshmitar në një vend, një
17 dëshmitar që ka të bëjë me zinxhirin e komandës e kështu me
18 radhë. Domethënë, ndryshime në paraqitjen e lëndës tuaj.

19 A keni menduar për mundësinë e konsolidimit e thelbit ose
20 substancës së çështjes tuaj pak më tepër që nga ana tjetër
21 mund të ndihmojë më shumë ekipet e Mbrojtjes, sepse kjo ishte
22 ideja kryesore, ndërhyrjes së znj. O'Reilly. Dhe a mund të
23 jeni më preciz sa i takon incidenteve konkrete ose vendeve
24 konkrete ose personave konkretë, çështjeve konkrete për të
25 cilat nevojiten më shumë të dhëna ose prova.

1 Është e vërtetë ajo çfarë thotë znj. O'Reilly që është e
2 vështirë për zonjën, për Mbrojtjen, për znj. O'Reilly dhe
3 ekipet e tjera të Mbrojtjes, por është e vështirë edhe për ne,
4 për Trupin Gjykses për t'ju ndjekur. Kështu që ndoshta kjo do
5 të ishte një prej sugjerimeve që mund të jepni juve për të
6 përshpejtuar paraqitjen e lëndës tuaj dhe për të harmonizuar
7 më shumë ose për t'i dhënë më të qarta specifikimet për palët.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se sjell shumë prova për
9 vende të caktuara mund të na çojë pak në vështirësi në atë se
10 çfarë mund të ndodhë, për shembull, më vonë në çështje. Për
11 shembull, në qoftë se bëjmë grupimin e dëshmitarëve mbi
12 vendndodhjet ne mbase mund të jetë e pamundur që të
13 planifikojmë persona të rinj më pas.

14 Kështu që ndoshta ne duke pasur disa pushime mund të na
15 ndihmojnë gjatë këtij viti të parë që të kemi më shumë
16 informacion për vendet e krimit në mënyrë të tillë që të kemi
17 të sigurt që nuk do të na duhet që të thërrasim dëshmitarë të
18 tjerë mbështetur në grupimin.

19 Pa diskutim që kur bëjmë planifikimin e dëshmitarëve dhe
20 sigurisht që domethënë duhet të jemi më të kujdesshëm në vitin
21 në vijim. Pra, për ne është shumë e rëndësishme që të bëjmë
22 planifikimin e dëshmitarëve që të jenë plotësisht të
23 përgatitur që merren në pyetje në mënyrë efikase.

24 Në këtë nivel edhe ne e ndjejmë këtë pjesë që duhej të
25 harmonizohej më tepër lëndën tonë dhe që sigurisht, domethënë,

1 mund ta plotësojë këtë informacion edhe me përgjigjet që do të
2 japë në nënpyetjet ose nënpikat e tjera.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Halling, për ta thënë më
4 troç atë çfarë po thoshte z. Mettraux ishte kjo, a ka ndonjë
5 arsye konkrete se pse nuk mund të thërrisni dëshmitarë kyç më
6 herët? A nuk do ishte më mirë që Trupi Gjykues të dëgjonte
7 dëshmitarët tuaj kryesorë nga fillimi, më në fillim të
8 procesit gjyqësor sesa më vonë?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Po, ka kuptim. Disa prej tyre janë
10 thirrur, por disa prej tyre nuk është se nuk janë thirrur për
11 arsye që varen nga ne.

12 Një prej arsyeve që do doja ta bëja të qartë edhe për
13 procesverbal ishte pengimi i dëshmitarëve në këtë çështje. Kjo
14 ka çuar në shumë efekte shtrembëruese; kjo na ka çuar që t'i
15 sjellim dëshmitarët sipas rendit që nuk dëshironim ose nuk
16 planifikonim përpara; na ka çuar kjo çështje gjithashtu edhe
17 në shmangien ose devijimin e burimeve, përfshirë këtu edhe
18 hapjen e Çështjes 10 dhe Çështjes 11 për pengim të mëtejshëm
19 të dëshmitarëve.

20 Domethënë ka arsye të tjera të cilat nuk varen nga ne që
21 na e kanë bërë të pamundur që ne të kemi një logjikë të
22 caktuar të thërritjes së dëshmitarëve. E kemi thënë edhe në
23 janar dhe do ta them edhe sot që qëllimi kryesor i ynë është
24 që të thërrasim dëshmitarët kryesorë në fillim të çështjes
25 gjyqësore. Disa prej këtyre dëshmitarëve kryesorë i kemi

1 thirrur, disa të tjerë jo për arsye që nuk varen nga ne.
2 Megjithatë, kjo është një gjë të cilën do ta mbajmë parasysh.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mesatarisht,
4 ndoshta matematikën nuk e kam të saktë, por ishte planifikuar
5 që të ishin 600 orë. Domethënë i takon që pak a shumë janë
6 përdorur 7 orë për dëshmitar. Në qoftë se do të bëjmë këtë
7 mesatare e shtatë orëve për dëshmitar është e pamundur që të
8 thërriten 300 [Sipas përkthimit] dëshmitarë brenda afatit
9 kohor që ju keni parashikuar. Sa dëshmitarë ju mendoni se do
10 të thërrisni në sallën e gjyqit?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Numri i mbetur për t'u thërritur
12 është 144 besoj dhe këtu përfshihen gjithashtu edhe
13 dëshmitarët *viva voce* sipas rregullës 154. Numri i saktë që ne
14 synojmë është një numër që nuk mund t'ju japim dot tani.

15 Ne synojmë që të përdorim më me tepër efikasitet kohën që
16 të kemi më shumë kohë në dispozicion që të kemi më shumë
17 seanca. Megjithatë dëshiroj të them që e pranoj plotësisht që
